

GJYKATA E APELIT
PRISHTINË

NË EMËR TË POPULLIT

Lënda numër: PAKR 266/14

Datë: 26 janar 2016

GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët e EULEX-it, gjyqtari Piotr Bojarczuk si kryetar kolegji dhe gjyqtar raportues, dhe gjyqtari i EULEX-it Roman Raab, me gjyqtarin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Vahid Halili si anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e Dr. Bernd Franke, Zyrtar Ligjor i EULEX-it, si mbajtës i procesverbalit,

në lëndën lidhur me të pandehurit:

- 1. A.K., i lindur me [...], në fshatin [...], shqiptar i Kosovës, emri i babës [...], emri nënës [...], me banim në [...];**

- 2. N.K., me nofkën [...], i lindur me [...]në [...], shqiptar i Kosovës, emri i babës [...], emri i nënës [...], me banim në [...];**

- 3. N.K., me nofkën gjatë luftës [...], i lindur me [...]në [...], shqiptar i Kosovës, emri i babës [...], emri i nënës [...], me banim në [...];**

- 4. B.L., i lindur me [...]në [...], shqiptar i Kosovës, emri i babës [...], emri i nënës [...], me banim në [...];**

5. **F.L., me nofkën [...], i lindur me [...]në [...], shqiptar i Kosovës, emri i babës [...], emri i nënës [...], me banim [...];**
6. **R.M., me nofkën [...], i lindur me [...]në [...], shqiptar i Kosovës, emri i babës [...], emri i nënës [...], me banim në [...];**
7. **N.S., me nofkën [...], i lindur me [...]në [...], shqiptar i Kosovës, emri i babës [...], emri i nënës [...], me banim në [...];**
8. **S.S., me nofkën ‘[...], i lindur me [...]në [...], shqiptar i Kosovës, emri i babës[...], emri i nënës [...], me banim në [...];**
9. **S.S., i lindur me [...]në [...], shqiptar i Kosovës, emri i babës [...], emri i nënës [...], me banim në [...];**
10. **B.S., i lindur me [...]në [...], shqiptar i Kosovës, emri i babës [...]emri i nënës [...], me banim në [...];**

*të akuzuar me Aktakuzën e Zyrës së Prokurorisë Speciale nr. 07/2010 të datës 25 korrik 2011 dhe të konfirmuar me aktvendimin e datës 26 gusht 2011 për kryerjen e një apo më shumë pikave të akuzës të këtyre veprave penale: *Krime Luftë kundër Popullatës Civile*, sipas nenit 22, 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (në tekstin e më tejme “KPRSFJ”), aktualisht e ndëshkueshme me nenin 31, 152 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e më tejme “KPRK”), në kundërshtim me nenin 3 të Konventës së katërt të Gjenevës së datës 12 gusht 1949 dhe neneve 4, 5 (1) të Protokollit Shtesë II dhe *Krime Luftë kundër të Burgosurve të Luftës*, sipas nenit 22, 144 të KPRSFJ-së, aktualisht e ndëshkueshme me nenin 31, 152 të KPRK-së, në kundërshtim me nenin 3 të Konventës së katërt të Gjenevës së datës 12 gusht 1949 dhe neneve 4, 5 (1) të Protokollit Shtesë II, të liruar në instancën e parë nga Gjykata Themelore e Prishtinës me Aktgjykimin P. nr. 766/12, të datës 17 shtator 2013;*

duke vendosur lidhur me ankesën e Prokurorit të PSRK-së, të parashtruar me datë 29 nëntor 2013, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës P. nr. 766/12 të datës 17 shtator 2013;

pasi që u shqyrtuan përgjigjet e parashtruara në emër të të pandehurve **N.K., N.K., N.S., S.S., F.L.** dhe **R.M.**;

dhe propozimi i Prokurorit të Apelit i parashtruar me datë 3 qershor 2014;

pas mbajtjes së seancës publike të Kolegjit të Apelit me datë 1 dhe 2 dhjetor 2015;

pas vendimmarrjes dhe votimit me datë 26 janar 2016;

në përputhje me nenet 409, 410, 411, 415, 417, 420, 421, 423, 424, 426 dhe 427 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e më tejme “KPPPK”);

lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- I. **Ankesa e Prokurorit të PSRK-së refuzohet si i pabazuar.**
- II. **Konfirmohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës nr. P. nr. 766/12 i datës 17 shtator 2013.**

ARSYETIM

I. PRAPAVIJA PROCEDURALE RELEVANTE

Me datë 25 korrik 2011 Prokurori Special i EULEX-it parashtroi Aktakuzën PPS nr. 07/10 duke i akuzuar të pandehurit **A.K., N.K., N.K., B.L., F.L., R.M., N.S., S.S., S.S.**, dhe **B.Sh.** (në tekstin e më tejme, në mënyrë të përbashkët, “të pandehurit”) për krime të cilat supozohet se u kryen nga fillimi i vitit 1999 deri diku kah mesi i qershorit të vitit 1999 kundër civilëve serb dhe shqiptar dhe të burgosurve ushtarak serb të paraburgosur në burgun e kontrolluar nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës (në tekstin e më tejme “UÇK”) në fshatin Kleçkë, Komuna e Lipjanit, në Kosovë.

Pika 2 e akuzës kundër **A.K.** u tërhoq me datë 9 nëntor 2011.

Me datë 21 mars 2012, Gjykata Themelore lëshoi një aktvendim ku gjeti se deklaratat dhe ditarët e dëshmitarit bashkëpunues **A.Z.**, i cili kreu vetëvrasje me datë 28 shtator 2011, ishin të papranueshme.

Me datë 30 mars 2012, Gjykata Themelore e preu procedurën gjyqësore penale dhe lëshoi Aktgjykimin me ç' rast liroi të pandehurit **A.K., B.L., R.M., S.S., S.S.**, dhe **B.S.** nga të gjitha veprat penale.

Me datë 2 May 2012, Gjykata Themelore lëshoi Aktgjykim me ç' rast liroi të pandehurit **N.K., N.K., F.L.**, dhe **N.S.** nga të gjitha veprat penale.

Me datë 20 nëntor 2012, respektivisht me datë 11 dhjetor 2012, Gjykata Supreme anuloi të dy Aktgjykimet si dhe aktvendimin lidhur me pranueshmërinë e dëshmimeve të **A.Z.**, dhe ktheu lëndët kundër të gjithë të dhjetë të pandehurve sërish në Gjykatën Themelore për rigjykim. Lëndët u ribashkuan. Me datë 17 shtator 2013 me Aktgjykimin e kundërshtuar Gjykata Themelore përsëri liroi të gjithë të pandehurit.

Pas seancave publike të shqyrtimit gjyqësore mes muajit prill dhe shtator të vitit 2013, vendimmarrja u bë me datë 16 shtator 2013 dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore u shpall me datë 17 shtator 2013.

Më Aktgjykimin e kundërshtuar, Gjykata Themelore gjeti se nuk ishte dëshmuar që të pandehurit kryen veprat penale për të cilat ngarkoheshin me Aktakuzë, dhe i liroi ata në bazë të 390(3) të KPPP-së. Më në veçanti, Gjykata Themelore gjeti se në vitin 1999 një burg / qendër paraburgimi operonte nga UÇK-ja në fshatin Kleçkë. Gjykata Themelore më tej konstatoi se kushtet e paraburgimit në burgun e Kleçkës vetvetiu nuk përbëjnë trajtim mizor, por se nga individët e përmendur në Aktakuzë, dëshmitari anonim H, vëllai i tij, dhe Sherafedin Ajeti iu ishin nënshtruar trajtimeve të mizore.

Gjykata Themelore po ashtu gjeti se ishte vërtetuar me dëshmi se **D.T., DV., B.C., Z.F., Z.T., N.D.** dhe **V.M.** ishin vrarë në mënyrë të paligjshme, dhe se e vetmja dëshmi për identitetin e kryesve të këtyre krimeve është dëshmia e **A.Z.** Sa i përket **A.A.**, Gjykata Themelore gjeti se e vetmja dëshmi lidhur me vrasjen e tij të supozuar të paligjshme është ajo e **A.Z.** Gjykata Themelore deklaroi se trupi nuk u gjet dhe se zyrtarisht **A.A.** është i zhdukur.

Gjykata Themelore gjeti se deklaratat e **A.Z.** dhe ditarët përbënin dëshmi të pranueshme, ashtu siç kishte përcaktuar Gjykata Supreme. Megjithatë, Gjykata Themelore konstatoi që **A.Z.** nuk ishte dëshmitar i besueshëm dhe se kështu nuk do ishte e sigurt për të u mbështetur në dëshminë e tij në përcaktimin e fajësisë së të pandehurve. Gjykata Themelore shtoi se në çdo rast, madje

edhe po qe se trupi gjykues të kishte ardhur në përfundim që ai ishte dëshmitar i besueshëm, nuk do të mund të i gjente të pandehurit fajtorë vetëm në bazë të dëshmisë së tij si dëshmitar bashkëpunues sipas nenit 157 (4) të KPPP-së, dhe se nuk dëshmi vërtetuese lidhur me identitetin e kryesve të veprës të vrasjeve të paligjshme në burgun e Kleçkës.

Prokurori i EULEX-it lajmëroi me datë 23 shtator 2013 se ai do të kundërshtonte Aktgjykimin e kundërshtuar.

Aktgjykimi me shkrim i është dorëzuar Prokurorit të EULEX-it me datë 18 nëntor 2013. Ankesa e tij, e datës 28 nëntor 2013, u parashtrua me datë 29 nëntor 2013.

Me datë 16 dhjetor 2013 avokati mbrojtës Florin Vertopi dhe Xhafer Maliqi në emër të të pandehurit **N.K.** parashtrroi përgjigje. Me datë 20 dhjetor 2013 avokati mbrojtës Mahmut Halimi parashtrroi përgjigje në emër të të pandehurit **N.K.** Me datë 23 dhjetor 2013 avokati mbrojtës Bajram Tmava parashtrroi përgjigje të datës 21 dhjetor 2013 në emër të të pandehurit **N.S.** Me datë 26 dhjetor 2013 avokati mbrojtës **M.S.** parashtrroi përgjigje në emër të të pandehurit **S.S.** Me datë 31 dhjetor 2013 avokati mbrojtës Karim A.A. Khan, Tahir Rrecaj, dhe Tomë Gashi parashtrroi një përgjigje të përbashkët në emër të të pandehurit **F.L.** Në fund, me datë 3 janar 2014 avokati mbrojtës **H.M.** parashtrroi një përgjigje të datës 31 janar 2013 në emër të të pandehurit **R.M.**

Lënda u transferua në Gjykatën e Apelit për të vendosur lidhur me ankesën me datë 14 maj 2014. Me datë 19 maj 2014 u caktua një kolegji i apelit. Me datë 3 qershor 2014, Prokurori i Apelit nga EULEX-i parashtrroi propozimin e tij të datës 30 maj 2014.

Me datë 9 korrik 2014 një kolegji i Gjykatës së Apelit mbajti një seancë publike. Në aktvendimin e datës 26 gusht 2014 Gjykata e Apelit njoftoi se do mbante një seancë dëgjimore për të dëgjuar dëshmitë e shqyrtuara paraprakisht nga ana e Gjykatës Themelore në bazë të 411 (2) dhe nenit 412 të KPPP-së, kështu që u ftuan tetë dëshmitarë për të u paraqitur me datë 17, 18, 23 dhe 25 shtator 2014.

Me datë 17 shtator 2014 Gjykata e Apelit mbajti seancën e parë dëgjimore dhe një dëshmitar u dëgjua.

Me datë 18 shtator 2014, avokati mbrojtës Karim Khan në emër të të pandehurit **F.L.**, dhe avokati mbrojtës i dytë Florin Vërtopi në emër të të pandehurit **N.K.**, parashtruan propozimin ku kërkohet përjashtimi i bankës së apelit.

Me datë 30 shtator 2014 Kryetari i Gjykatës së Apelit pranoi kërkesën për përjashtim në bazë të nenit 40 (3) dhe nenit 42 të KPPP-së, dhe vendosi që një kolegji me një përbërje tjetër do të caktohej për të vendosur lidhur me ankesën. Me datë 24 prill 2015 një kolegji i apelit u caktua për këtë lëndë.

Seanca e kolegjit të Gjykatës së Apelit u mbajt me datë 1 dhe 2 dhjetor 2015 në praninë e të gjithë të pandehurve, avokatëve të tyre mbrojtës dhe Prokuroren e Apelit Anca Stan.

Kolegji i apelit morri vendim dhe votoj me datën 26 janar 2016.

PARASHTRESAT E PALËVE.

A. Ankesa e Prokurorit të PSRK-së.

Prokurori i PSRK-së Maurizio SALUSTRO me datë 29 nëntor 2013 parashtroi ankesë në Gjykatën Themelore për shkak të:

Shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale;
Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Të gjitha bazat lidhen me dëshmitarin bashkëpunues **A.Z.** Së pari, sa i përket **pretendimit të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale**, Prokurori i SPRK-së mbron qëndrimin e vetë se Gjykata Themelore gaboi: (i) në nxjerrjen e përfundimeve jo të favorshme për faktin që **A.Z.** nuk ishte në dispozicion në gjykim, domethënë në konstatimin që mbrojtja nuk pati një mundësi të plotë që ta merrte atë në pyetje nga ana e kundërt. Ai deklaroi se Gjykata Supreme gjykoj lidhur me këtë çështje dhe vendosi në të kundërtën, dhe se do të arrinte të hiqte vendimin e domethënies së saj se deklaratat e dëshmitarit të ndjerë mund të pranoheshin në dëshmi; (ii) në vendimin që standardi i vërtetimit të kërkuar ishte “dëshmi e pavarur e cila përfshin të akuzuarit në kryerjen e veprës” kur dihet që disa vendime paraprake nga Gjykata Themelore e Prishtinës janë mbështetur në të vërtetuarit që nuk implikojnë të akuzuarit dhe po ashtu që neni 157 (4) KPPP-së nuk përcakton një kusht të tillë; dhe (iii) në përvetësimin e një metode të palogjikshme për vlerësimin e dëshmisë pasi që përqendrohet në ekzistimin e vërtetimit në vend që së pari të vlerësoj besueshmërinë së vetë **A.Z.** Lidhur me këtë pikën e fundit, Prokurori i PSRK-së pohon se Gjykata Themelore iu qas një leximi të përzgjedhur, e përqendruar në kundërthëniet e pretenduara të deklaratave të **A.Z.** duke injoruar sqarimet që ai siguronte, dhe asnjëherë nuk i vlerësoj dëshmitë si një tërësi.

Së dyti, Prokurori i PSRK-së argumenton se Gjykata themelore doli me një **vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike** kur erdhi në përfundim që dëshmia e **A.Z.** nuk ishte e besueshme. Lidhur me këtë, ai debaton se Gjykata Themelore gaboi në konstatimin se: (i) nuk kishte përputhje të mjaftueshme me dëshminë e **A.Z.**; (ii) “ditarët” e tij nuk ishin të besueshëm; (iii) ai gënjeu lidhur me gjendjen e tij shëndetësore dhe për dhënie të deklaratë në KFOR; (iv) dëshmitë e mjekësisë ligjore kundërshtojnë deklaratat e tija lidhur me vrasjen e pesë të burgosurve serb dhe atë të **A.A.**; dhe (v) dëshmia e tij është kundërthënëse sa i përket vrasjes së dy oficerëve të policisë serbe.

Të një rëndësie domethënëse, Prokurori i PSRK-së qëndron ndaj pohimit se ekziston një numër i madhi i të provuarit të përgjithshëm, në veçanti dokumentet e pavarura zyrtare të UÇK-së, që kanë të bëjnë me ekzistimin e burgut të Kleçkës, pranisë së të burgosurve, rolit të **A.Z.** si roje, faktit që njerëz u vranë, datave të pranimit dhe lirimit të të burgosurve etj. Ai po ashtu pohon se po ashtu ekziston një përputhshmëri e posaçme sa i përket vrasjes së pesë serbëve oficer të ushtrisë, trupat e të cilëve janë gjetur në varrin masiv të treguar nga ana e **A.Z.**, vrasja e njërit nga ta me kosë e cila po ashtu është gjetur në varr, vrasjen e dy serbëve oficer të policisë trupat e të cilëve po ashtu janë gjetur në lokacionin e treguar nga ana e **A.Z.**, prania e emrave të këtyre viktimave në ditarë, torturimi i dëshmitarit anonim H si dhe vrasja e vëllait të tij. Prokurori më në fund pohon se po ashtu ekziston vërtetimi sa i përket përfshirjes së të pandehurve në burgun e Kleçkës pasi që dëshmitarët dëshmuan të kenë parë **N.K., N.K., R.M., A.K., F.L.**, dhe të tjerët në Kleçkë gjatë luftës.

Lidhur me ditarët e **A.Z.** në veçanti, Prokurori i PSRK-së thekson se asnjëherë nuk ishte çështje e tij apo dëshmia e dëshmitarit bashkëpunues që **A.Z.** i shkroi vetëm të ashtu-quajturat “ditarë”. Sipas Prokurorit, asnjë pikë e vetme e akuzës në Aktakuzë nuk është e bazuar në ndonjë shënim të ditarit. Ai më tej pohon se **A.Z.** asnjëherë nuk ka thënë se të gjitha shënimet në ditarë janë të njëkohshme me ngjarjet. Prokurori sqaron se mes dokumenteve që i janë dhënë hetuesve nga **A.Z.**, do të thotë dokumentet /001 deri në /036, **A.Z.** ishte marr vetëm në pyetje në thellësi lidhur me “ditarë të luftës” të etiketuar /011 to /014, të cilat janë të vetmet për të cilat ai ndonjëherë e pranoi autorësinë. Është vetëm për këto shënime të veçanta për të cilat **A.Z.** bëri me dije se askush nuk e di për ato dhe se askush nuk kishte pasur asnjë qasje në to. Prandaj, qëndrimi i Prokurorit të PSRK-së është se Gjykata Themelore për të diskredituar gjithë ditarin, gaboi duke nxjerr fragmente nga konteksti i deponimit të **A.Z.**, duke shtrembëruar dëshmimin e tij, dhe gabimisht duke nxjerr përfundime të përgjithshme nga to.

Titulli “ditari” nuk përkon me realitetin pasi që mes këtyre dokumenteve ka shumë faqe të humbura, për të cilat **A.Z.** asnjëherë nuk e pranoi autorësinë dhe për të cilat ai asnjëherë nuk u

morr në pyetje. Prokurori i PSRK-së përkujton që eksperti i grafologjisë, Profesori **B.** konstatoi që ditarët /011 dhe /012 tërësisht ishin të shkruara nga **A.Z.**, me përjashtim të nënshkrimit të **I.Q.** në faqen 4 të ditarit /011, dhe se metodologjia e pranuar nga dëshmitari ekspert i mbrojtjes Dr. **H.K.** duhej të hedhet poshtë. Prokurori pohon lidhur me këtë se Dr. **K.** nuk është grafolog por është teknik i kriminologjisë dhe se konstatimet e tija nuk janë të mbështetura në prova shkencore. Ai më tej pohon se Gjykata Themelore gabimisht konsideroj se redaktimi i ditarit personal të dikujt barazohej me prishje të dëshmimeve. Në fund, Prokurori i PSRK-së ngrit shqetësimet se përse Gjykata Themelore nuk e thirri Profesor **B.** për të i parashtruar pyetje në vend se të pranonte në mënyrë “pasive” raportin e tij me shkrim. Ai mbron qëndrimin e tij se Gjykata Themelore gaboi duke zëvendësuar veten e me ekspertët Dr. **K.** dhe Professor **B.**, duke u larguar nga konkluzionet e tyre, dhe duke u përqendruar në analizimet e veta vetëm nga dukja e jashtme e shkrimit të dorës pa ndonjë bazë shkencore.

Kur i kthehemi dy periudhave të shtrirjes së **A.Z.** në spital, qëndrimi i Prokurorit të PSRK-së është se Gjykata Themelore gaboi në konstatimin se **A.Z.** gënjeu dhe nuk bëri dallimin mes dy shtrirjeve në spital. Sa i përket shtrirjes në spital në Prizren, ai përkujton që diagnoza e mjekëve Çrregullim Mendor Post-Traumatik ishte tërësisht në përputhje me aksidentin me makinë që kishte pësuar **A.Z.** Ai më tej deklaroi që **A.Z.** asnjëherë nuk tha që shkoi në spital për të mashtruar sigurimin apo për të falsifikuar simptomat e ÇMPT. Sipas pikëpamjes së Prokurorit, marrja e certifikatës mjekësore për të kërkuar kompensimin financiar është një procedure tërësisht ligjore e cila nuk duhet të rrënoj besueshmërinë e **A.Z.**, dhe se pranimi i dëshmitarit bashkëpunues se ai donte ta vriste **F.L.** për më tepër tregon sinqeritetin e tij.

Sa i përket shtrirjes në spital në Prishtinë, Prokurori i PSRK-së sqaron se **A.Z.**, siç e thoshte edhe vetë vazhdimisht, ishte detyruar të shkonte në spital nga ana e **F.L.** në mënyrë që të diskreditohej besueshmëria e tij si dëshmitar dhe se, si pjesë e planit, ai duhej të shtirej se ai ishte i sëmur mental. Ai pohon se këto fakte mbështeten në prova dhe se gabimisht ishin vlerësuar nga Gjykata Themelore.

Prokurori i PSRK-së më tej argumenton se Gjykata Themelore gaboi në vlerësimin negativ të besueshmërisë së **A.Z.** kur deklaroi se ai ishte një “*gënjeshtar i manipuluar*” sepse, sipas Gjykatës Themelore, “*ai i bindi tre psikiatër se ishte i sëmur mental e që ai nuk ishte*”, dhe se ai gënjeu mjekët në spitalin e Prishtinës “*që të zhvlerësonte një deklaratë që në fakt nuk e kishte bërë asnjëherë*”.

Prokurori i PSRK-së vë në pah që dëshmia e **A.Z.** se ai nuk ka dhënë deklaratë zyrtarisht me shkrim përputhet me letrën e KFOR-it e datës 3 shtator 2013, si nga dy shënimet e ndryshme të ditarit të tij (/006 dhe /001), si dhe raportit të policisë të datës 25 nëntor 2006 që vërtetojnë

ekzistimin e një takimi mes UNMIK-ut dhe **A.Z.** Prokurori sqaron se pasi që KFOR-i nuk është agjenci hetimore, kjo sqaron faktin se përse ata nuk mbajnë shënim se çka thotë një dëshmitar i mundshëm.

Në fund, ai është i mendimit se Gjykata Themelore gaboi në të menduarit se “*shënimet e ditarit të A.Z. pasqyrojnë një njeri që vuan nga sëmundja mentale*” gjersa shënimet relevant po të përkthehet saktësisht në vend të saj tregon se **A.Z.** i tha gruas së vetë se fëmijët nuk duhet ta kuptojnë që ai *nuk* ishte i sëmurë.

Kur i kthehet vrasjes së pesë ushtarëve serb dhe vrasjes së **A.A.**, Prokurori i PSRK-së mban qëndrimin se ka prova të pakontestueshme se pesë trupa u zhvarrosen nga varreza e treguar nga ana e **A.Z.**, se analizat e ADN-së zbuluan se këta ishin pesë ushtarët serb, dy nga ta me duar të lidhura, se emrat e katër vetave nga të pestët e këtyre viktimave paraqiten në shënimin e ditarit si të burgosur në burgun e Kleçkës, se rrobat ushtarake dhe kosa u gjeten në varr, dhe se data e pranimit të tyre në burg në ditar përputhet me dëshmitë e pas vdekjes. Ai më pas ashtu siç duhet i përmend disa kundërthënie të supozuara në deponimin e **A.Z.** sa i përket këtyre vrasjeve.

Sa i përket faktit se **A.Z.** tha se nëntë trupa u varrosen në varr gjersa vetëm katër u gjetën, Prokurori pohon se kjo nuk e zhvlerëson besueshmërinë e dëshmitarit bashkëpunues kur dihet që **A.Z.** nuk kishte njohuri se çka ndodhi në varr pasi që trupat u hodhën aty brenda, se ai asnjëherë nuk tha se ai e mbylli varrin, e as që e ka vëzhguar vazhdimisht këtë vend.

Prokurori i PSRK-së po ashtu thekson se arkeologu ekspert i mjekësisë ligjore **C.C.** dëshmoi se nuk janë vërejtur trazime të hershme brenda gjashtë muajve të parë. Ai më tej parashtroi se ka tregues të fort se disa trupa mund të jenë larguar.

Përkundër deklarimit të Gjykatës Themelore, ai sqaroi se **A.Z.** se ai asnjëherë nuk ka dëshmuar se varri në fjalë ishte trazuar në vitin 2002, pasi që **A.Z.** i referohej një varri tjetër.

Sa i përket radhitjes sipas së cilës u gjeten trupat në varr e që nuk përputhet me shpjegimin e **A.Z.**, Prokurori rikujton se dëshmitari ekspert **C.C.** deklaroi se “*po qe se trupat janë larguar para se të mbuloheshin do të jetë shumë e vështir të thuhet se ka kishte më shumë trupa aty*”. Përkundër konstatimit të Gjykatës Themelore, **A.Z.** nuk dëshmoi se pas çdo viktime u varrosen trupat por se u mbuluan me të njëjtin dhe.

Përpos kësaj, kur **A.Z.** deklaroi se ishin vra katër serb 20 ditë para se të vritej **A.A.** në kundërshtim me dëshmitë, Prokurori saktëson se në të vërtetë **A.Z.** iu referohej dy grupeve të ndryshme me nga katër serb, dhe se ai pranoi se nuk ishte i sigurt për datat dhe identitetin e dy

grupeve të serbëve. Ai mbron qëndrimin e tij se kundërthënia e dukshme lehtë për të u sqaruar nga fakti që **A.Z.** bëri gabim sa i përket datës “20 ditë para vrasjes së **A.A.**”.

Sa i përket kundërthënies së dukshme mes deklaratës së **A.Z.** ku përfshinë **A.K.** në dy ngjarje dhe alibisë së **A.K.**, qëndrimi i Prokurorit është se përfshirja e tij e supozuar ishte e paktë dhe se ka mundësi që **A.Z.** bëri gabim.

Sa i përket faktit që **A.Z.** dëshmoi që vetëm një i burgosur ishte vra me kosë kur dëshmia e mjekësisë ligjore vërtetoi se ishin dy të burgosur, Prokurori i PSRK-së thekson se **A.Z.** asnjëherë nuk tha që ai pa me sy ekzekutimin e grupi prej katër serbëve.

Lidhur me faktin që **A.Z.** së pari tha se ai nuk e pa vrasjen e dy serbëve, oficerin e policisë **V.M.** dhe **N.D.** ndërsa ai më vonë pranoi se ai personalisht i vrau ata, Prokurori i PSRK-së vë në pah se dëshmitari bashkëpunues sqaroi mosdashjen e tij fillestare për të pranuar përgjegjësin e vetë, për arsyet të cilat janë lehtë të kuptueshme. Ai shtoi se dëshmitë e mjekësisë ligjore janë në pajtueshmëri me shpjegimin e **A.Z.** se ai shtiu në viktima disa herë. Prokurori më tej thekson se dëshmia e tij përputhet me elemente të pavarura siç është zhvarrosja e trupave nga vendi të cilin ai e bëri me dije, përmendjen e emrave të viktimave në ditarin e tij, raportet e autopsisë, si dhe dëshmia e dëshmitarit U.

Përpos kësaj, Prokurori i PSRK-së deklaron se Gjykata Themelore po ashtu gabo i në konstatimet e saja lidhur me: (i) dëshminë e **A.Z.** lidhur me **S.D.** dhe **B.K.**; (ii) faktin që atij i janë treguar deklaratat e TPNJ-së nga **F.L.**; (iii) dëshmia e tij mbi pagesat e supozuara nga **F.L.**; (iv) kërcënimet që ai mori nga **F.L.**; dhe (v) faktin që ai pranoi të ketë gënjyer hetuesit e TPNJ-së.

Më posaçërisht, sa i përket **S.D.**, derisa Prokurori pranon që **A.Z.** ishte i paqartë sa i përket identitetit të **P.U.**, e që është nofka e **S.D.**, ai përkujton se bashkëpunuesit më të ngushtë të **S.D.** gjatë luftës dëshmuar se ata e njihnin atë me emrin e tij të vërtetë, dhe se nuk e dinin që ai kishte nofkë, dhe se nuk njihnin ndonjë **P.U.**

Lidhur me deklaratat e TPNJ-së, derisa u vërtetua nga Gjykata Themelore se **F.L.** dhe **I.M.** asnjëherë nuk dhanë deklaratë në TPNJ-së, Prokurori i PSRK-së nënvizon se **A.Z.** dëshmoi se ai vetëm lexoi pjesë nga deklarata e **H.B.**, dhe se përgjigjet që Gjykata Themelore i mori nga TPNJ-a nuk e përmendin **H.B.** Ai më tej deklaron se **A.Z.** mund të i jetë dukur si “deklaratë” dokumentet të cilat në fakt mund të kenë qenë memorandume të mbrojtjes apo procesverbale të shqyrtimit fillestar.

Dhe në fund, Prokurori i PSRK-së nënvizon se po të kishte dashur që **A.Z.** të hakmerrej ndaj **F.L.** duke sjell akuza të rreme kundër tij, ai nuk do ta inkriminonte veten e tij dhe se nuk do ta implikonte **F.L.** në një mënyrë kaq të kufizuar.

Prokurori i propozon Gjykatës së Apelit që të pranoj si dëshmi dy vendime gjyqësore të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, një raport oficeri të UNMIK-ut të gjetur rishtazi, të datës 25 nëntor 2006, një raport oficeri të UNMIK-ut të gjetur rishtazi, të datës 19 nëntor 2013, dhe po ashtu fjalën përfundimtare të Prokurorit.

Për këto arsye, Prokurori i PSRK-së propozon që Gjykata e Apelit të mbaj një seancë dëgjimore për të pranuar dëshmi, të kthej Aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe të dënoj të gjithë të pandehurit për pikat e akuzës të përcaktuara në Aktakuzë, apo të anuloj Aktgjykimin e kundërshtuar dhe ta kthej lëndën në Gjykatën Themelore për rigjykim.

B. Përgjigjet e F.L.

Në një përgjigje të përbashkët ndaj ankesës së parashtruar nga Prokurori i PSRK-së, **Avokati mbrojtës Karim A.A. Khan, Tahir Rrecaj, dhe Tomë Gashi** në emër të **F.L.** nënvizojnë se Aktgjykimi i datës 17 shtator 2013 është hera e dytë që i pandehuri lirohet në mënyrë unanime nga një trup gjykues i EULEX-it lidhur me pikat aktuale të akuzës. Lirimi i parë u anulua nga Gjykata Supreme me Aktgjykimin e datës 20 nëntor 2012, me ç' rast arsyetimi u përkufizua në çështjen e pranimit të ditarëve dhe deklaratave të dëshmitarit bashkëpunues **A.Z.** Avokatët mbrojtës deklarojnë se është e qartë nga ky Aktgjykim se gjetjet faktike të trupit gjykues fillestar u lanë të paprekura, dhe nuk u anuluan nga Gjykata Supreme. Më tej, ata vazhdojnë në mënyrë të hollësishme me përshkrim të detyrave ligjore dhe etike të imponuara nga palët. Lidhur me këtë, ata mbajnë qëndrimin se Prokurori i PSRK-së nuk paraqiti në mënyrë të drejtë dhe të saktë ankesën e tij, në mënyrë të sinqertë dhe korrekte në Gjykatën e Apelit, se ai keq-prezantoi faktet, dhe se me qëllim nuk zbuloi faktet që ai e dinte se ishin të vërteta në shkelje të kodit të sjelljes së vetë profesionale.

Posaçërisht, avokatët mbrojtës pohojnë se ishte mbrojtja ajo e cila këmbënguli gjatë gjykimit se ditarët e **A.Z.** duhej të i nënshtroheshin vlerësimit të krim teknikës/forensikes dhe se Prokurori i PSRK-së këmbëngulte me kokëfortësi se kjo nuk ishte e nevojshme, dhe reagoi gjatë gjykimit vetëm atëherë kur mbrojtja përmendi dëshmitë për të ngrit dyshimin sa i përket besueshmërisë së ditarëve në fjalë. Ngjashëm, Prokurori i PSRK-së refuzoi shqetësimet e mbrojtës sa i përket gjendjes shëndetësore mentale të **A.Z.** Është e qartë se ishte trupi gjykues dhe jo Prokurori i PSRK-së ai i cili kërkoi sigurimin e dëshmisë lidhur me gjendjen shëndetësore mendore të **A.Z.**,

dhe se a kishin dhënë a jo **F.L.**, **H.B.** dhe **I.M.** deklarata në TPNJ, dhe se a kishte dhënë a jo **A.Z.** deklaratë në KFOR, dhe çështjeve lidhur me forensiken të këtij rasti.

Avokatët mbrojtës pastaj përshkruan në mënyrë të hollësishme standardet e shqyrtimit të ankesës të përcaktuar me nenet 402, 403 dhe 405 të KPPP-së, dhe gjeti se ankesa e Prokurorit të PSRK-së përbëhet nga një përsëritje monotone e argumenteve të cilat janë të pasakta dhe të cilat si tërësi apo veç e veç nuk përmbushin kushtet e parapara të këtyre neneve. Lidhur me këtë, avokatët mbrojtës tërheqin vëmendjen në veçanti sa i përket standardeve të përcaktuara dhe të qartësuara në jurisprudencën e TPNJ-së, ku nënvizohet se palët në ankesë duhet të përkufizojnë argumentet e tyre në gabimet ligjore të cilat e bëjnë të pavlefshëm Aktgjykimin e trupit gjykues dhe gabimeve faktike të cilat shpijnë në mos arritje të drejtësisë, që do të thotë, që zhvlerëson vendimin e trupit gjykues. Ata pohojnë se Prokurori i PSRK-së nuk e bëri këtë gjë. Sa i përket gabimeve të supozuara të fakteve, avokatët mbrojtës po ashtu vënë në pah faktin se Dhoma e Apelit e TPNJ-a vetëm zëvendëson gjetjet e saja kur asnjë gjykues i arsyeshëm i faktit nuk ia ka dalë të arrij vendimin fillestar. Avokatët mbrojtës parashtrojnë se Gjykata Themelore tërësisht dhe me të vërtet vërtetoi faktet në rastin e këtushëm sipas nenit 7 (1) të KPPP-së. Përderisa Prokurori i PSRK-së mban barrën e provës, ai nuk argumentoi në mënyrë të duhur se si ndonjë gabim i supozuar “ndikoj apo ka mundur të ndikonte në nxjerrjen e një Aktgjykimi të duhur dhe ligjor”, apo të demonstroj se ekziston një gjendje e dyshimit të konsiderueshëm sa i përket saktësisë së vërtetimit të fakteve, ashtu siç do të kërkohej në mënyrë që të anulohet vendimi dhe të caktohet një gjykim i ri.

Sa i përket mos pranisë së **A.Z.** në gjykim dhe pretendimeve të Prokurorit të PSRK-së se Gjykata Themelore gaboi në bazë të nenit 403 (2.1), nenit 368 (1.1), dhe nenit 387 (2) të KPPP-së, avokatët mbrojtës tërheqin vëmendjen se Gjykata nuk bëri asnjë gabim. Shikimi i të dëshmimeve në tërësi, Gjykata Themelore në mënyrë të drejt vlerësoj se **A.Z.** nuk ishte dëshmitar i besueshëm, e që vështir se është një bazë për ankesë, përveç se thjesht një mosmarrëveshje e Prokurorit të PSRK-së me vlerësimin e dëshmimeve të Gjykatës Themelore, dhe faktit që pranohet se vetëvrasja e **A.Z.** ia mohoi Gjykatës Themelore mundësin për të i parashtruar atij pyetje plotësuese.

Kur është fjala për pretendimet e Prokurorit të PSRK-së se Gjykata Themelore zbatoi standarde të gabueshme ligjore lidhur me çështjen e të vërtetuarit në kundërshtim me nenin 403 (2.1) dhe nenit 157 (4) të KPPP-së, avokatët mbrojtës pohojnë se zbatimi i ligjit nga Gjykata Themelore ligjërisht është i drejt dhe se nuk ka bërë asnjë gabim. Përkundër parashtrësës së Prokurorit të PSRK-së se Gjykata Themelore nuk përmendi se cilat mund të ishin dëshmi të vërtetuara, mbrojtja gjen se janë shqyrtuar të gjitha dëshmitë e lëndës në mënyrë të përpiktë dhe ka vlerësuar që Prokurorit i PSRK-së nuk ka e nxjerr barrën e tij për të dëshmuar këtë lëndë kundër **F.L.**

përtej dyshimit të bazuar. Avokatët mbrojtës refuzojnë aludimet e Prokurorit të PSRK-së me lëndët tjera nga Gjykata Themelore të Prishtinës pasi që parimi *stare decisis* nuk vlen dhe se ai nuk i ka ngrit këto raste me trupin gjykues gjatë gjykimit fillestar apo në rigjykim. Në veçanti, ata theksojnë se Gjykata Themelore në rastin aktual ka vu re një numër të mospërputhshesh në dëshminë e **A.Z.** dhe se nuk e konsideron atë të besueshme pasi që dëshmia e tij në fakt është kundërshtuar me dëshmi të tjera.

Avokatët mbrojtës vënë re se Prokurorit i PSRK-së mbron qëndrimin se natyra e vërtetimit të paraparë nuk është i përshkruar me nenin 157 (4) të KPPP-së e as diku tjetër në ligj. Ata pohojnë që aty ku ka boshllëqe në ligjin e shkruar dhe në dispozitat e KPPP-së, do të zbatohet jurisprudenca ekzistuese lidhur me kushtet për përputhshmërinë. Avokatët mbrojtës i referohen në lidhje me këtë vendimit *Al-Khawaja dhe Tahery ndaj Mbretërisë së Bashkuar* të lëshuar nga Dhoma e Madhe e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut duke theksuar se sa më e posaçme të jetë një dëshmi aq më e madhe është nevoja për të u siguruar që besueshmëria e saj është dëshmuar. Sipas mbrojtjes, argumenti i Prokurorit të PSRK-së se Gjykata Themelore gaboi kur dha interpretimin e vetë për standardet ligjore të parapara me sipas nenit 157 (4) dhe në konstatimi se “është ligj i rëndomtë që dëshmitë në të vërtetuar duhet të jenë dëshmi të pavarura që implikojnë të akuzuarin në kryerje të veprës” është i gabuar dhe duhet të refuzohet.

Avokatët mbrojtës parashtrojnë se Gjykata Themelore ka zbatuar si duhet parimet ligjore të vërtetimit bazuar në jurisprudencën e vendosur dhe autoritetin më të lartë. Ata i referohen rastit *R v Baskerville* i cili konsideron se “*provat në vërtetim duhet të jenë dëshmi të pavarura të cilat prekin të akuzuarin duke e lidhur ose duke tentuar që ta lidhin atë me krimin. Me fjalë të tjera, duhet të jetë dëshmi e cila e implikon atë, që do të thotë, që konfirmon në një masë të veçantë jo vetëm dëshminë se krimi është kryer, por se gjithashtu që i burgosuri e kreu atë*”. Mbrojtja konstaton se pretendimi i Prokurorit të PSRK-së se vendimi i trupit gjykues është një "rrotullim-U në krahasim me ligjin aktual të rastit në Kosovë" është pa merita ligjore dhe thekson se përderisa gjetja e mbetjeve mortore mund të mbështes çështjen e Prokurorisë se krimet janë kryer, nuk përputhet me dëshminë e dhënë nga **A.Z.** në lidhje me identitetin e kryerësve të këtyre krimeve.

Avokatët mbrojtës pohojnë se të dy rastet mbi të cilat u mbështet Prokurori i PSRK-së, që do të thotë vendimet e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës PN. 371/2010 kundër **F.G.** e datës 23 nëntor 2011 dhe PN.592/11 kundër **S.A.** e datës 17 dhjetor 2011, nuk janë të zbatueshme në këtë instancë për shkak të këtyre arsyeve: në rastin e **F.G.**, dëshmitari bashkëpunues, **N.B.**, u konstatua se ishte i besueshëm dhe se trupi gjykues u bind që mospërputhjet ishin të vogla për nga natyra, ndryshe nga mospërputhjet në deklaratat e **A.Z.** dhe atyre të dëshmitarëve tjerë të

Prokurorisë. Në rastin e **S.A.**, dëshmitari bashkëpunues, **N.B.**, u paraqit në gjykatë dhe u konstatua se ishte i besueshëm, dhe gjykata konstatoi që deklaratat e tij ishte e hollësishme, e kuptueshme, dhe e vërtetë, ndryshe nga rasti aktual ku Gjykata Themelore e gjeti dëshminë e **A.Z.** jo të besueshme. Gjykata Themelore më pas gjeti që **N.B.** ishte në gjendje të sqaronte mospërputhjet të deponimit të tij në mënyrë të besueshme, përderisa në rastin aktual kundërthëniet nuk u zgjidhen për shkak të mungesës së **A.Z.** në gjykim.

Avokatët mbrojtës lidhur me këtë i referohen Shtojcës 1 bashkëngjitur në përgjigje, e cila përmban një listë të mospërputhjeve dhe kundërthënieve thelbësore të supozuara mes dëshmisë së **A.Z.** dhe dëshmive tjera të Prokurorisë.

Sipas avokatëve mbrojtës, në kohën kur mbrojtja e mori në pyetje **A.Z.** në korrik të vitit 2011, dhe përkundër shumë kërkesave të mbrojtjes, Prokurori i PSRK-së nuk kishte bërë asnjë përpjekje për të siguruar: (i) ndonjë dëshmi lidhur me shkrimin e dorës të ditarëve siç pretendohet me autorësi të **A.Z.**; (ii) ndonjë dëshmi të pavarur lidhur me mirëqenien psikologjike dhe shëndetin mendor të **A.Z.** në kohën kur janë shënuar deklaratat dhe në kohën kur supozohet se janë shkruar këta ditarë; (iii) asnjë hetim nuk është bërë lidhur me kërkimet në KFOR lidhur me atë se a ka dhënë në të vërtetë apo jo deklaratë **A.Z.**; dhe (iv) nuk është bërë asnjë kërkim në TPNJ-ë për të vërtetuar se a kishin dhënë a jo në fakt deklaratat **F.L.**, **H.B.**, dhe **I.M.** në TPNJ-ë ashtu siç pretendohet nga ana e **A.Z.** Ishte Gjykata Themelore ajo që bëri këto hapa hetimor me propozim të vetin, dhe jo Prokurori i PSRK-së.

Lidhur me vlerësimin e dëshmive, sipas pikëpamjes të avokatëve mbrojtës, Gjykata Themelore, në përputhshmëri me nenin 387 (1) të KPPP-së, plotësisht dhe drejt vërtetoi faktet dhe vlerësoi secilën provë veç e veç dhe në lidhje me dëshmitë tjera, dhe bëri një vendim të arsyeshëm ashtu siç përcaktohet me nenin 387 (2) të KPPP-së. Avokatët mbrojtës deklarojnë se leximi i drejtë i Aktgjykimit nuk zbulon asnjë gabim në ligj apo të faktit.

Lidhur me mjaftueshmërinë e vërtetimit në dispozicion, avokatët mbrojtës kujtojnë standardin e provës të zbatuar në gabimet pretenduara të faktit dhe thekson se Prokurori i PSRK-së ka dështuar posaçërisht për të përmbushur barrën e të argumentuarit. Sipas mbrojtjes, vlen të përmendet se Gjykata Themelore nuk e përjashtoi asnjë dëshmi të paraqitur nga Prokurori i PSRK-së, dhe vetëm pas vlerësimit të pavarur dhe të paanshme të të gjitha atyre dëshmive dhe dëgjimit të parashtrësive nga palët nxori aktgjykimin e saj.

Sa i përket besueshmërisë së ditarëve të **A.Z.**, qëndrimi i avokatëve mbrojtës është se gjetjet e Gjykatës Themelore janë të arsyetuara mirë dhe të bazuar në prova. Ata më tej bëjnë me dije se

një respekt duhet të i jepet trupit gjykues për vlerësimin e provave, e cila është e ngarkuar me përgjegjësinë kryesore për të bërë gjetjet faktike.

Avokatët mbrojtës vënë në dukje se përfaqësimi i Prokurorit të PSRK-së se "provat e krimeve vijnë krejtësisht nga kujtesa dhe dëshmia e **Z.**, jo nga ditarët", është plotësisht e gabuar dhe mashtruese, dhe kujton se vetë **A.Z.** pranoi gjatë marrje në pyetje në mënyrë të tërthortë se pa ditarë ai do të mbante mend. Avokatët mbrojtës theksojnë se në asnjëherë Prokurori i PSRK-së nuk bëri dallim në mes të ditarëve, shënimeve dhe shënimeve personale të **A.Z.** Ata vejnë në pah për pranimin e Prokurorit të PSRK-së se ai nuk i kërkoi **A.Z.** që të konfirmonte apo të mohonte nëse ai shkroi tërësinë e ditarëve, përderisa ai e kishte për obligim që të paraqiste rastin e tij në mënyrë të qartë. Ata më tej përshkruajnë se për herë të parë, në ankesë, Prokurori i PSRK-së është deklaruar se ditarët mund të burojnë nga dikush tjetër dhe jo **A.Z.**, ndërsa ai hodhi poshtë shqetësimet e mbrojtjes lidhur me autorësinë ditarëve gjatë marrjes në pyetje të **A.Z.** në korrik 2011. Ata në fund bëjnë të ditur se argumentet tjera të Prokurorit të PSRK-së janë jashtë të qenit cilësor dhe thjesht të dalin në kundërshtim me gjetjet e Gjykatës Themelore.

Sa i përket sëmundjes psikike të **A.Z.**, mbrojtja paraqet se Prokurori i PSRK-së nuk ka paraqitur se kishte vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të fakteve. Sa i përket përkthimit tjetër të propozuar nga ana Prokurorit të PSRK-së lidhur me atë se çka i tha **A.Z.** gruas së tij para se ai të pranohej në spital, ata mbajnë qëndrimin se ky argument nuk është paraqitur në gjykim dhe se është dashur që të ngrihej në kohën e duhur. Përveç kësaj, ata vënë në pah faktin se Prokurori i PSRK-së nuk foli lidhur me dëshminë e vetë dëshmitarit Y sa i përket shëndetit mendor të burrit të saj. Mbrojtja paraqet se Prokurori i PSRK-së posaçërisht keq prezantoi deponimin e **A.Z.** sa i përket arsyeve të pranimit të tij në spitalin e psikiatrisë, dhe ata nënvizojnë që **A.Z.** në mënyrë kontradiktore përmendi se ai e pranoi vetë: (i) që deklaratat e tija në KFOR të paraqiteshin së koti; (ii) ashtu që ai të mund të përfitonte nga kërkesa e sigurimit; dhe (iii) se do të kishte mbrojtje për vrasjen e **F.L.**

Lidhur me raportin policor të UNMIK-ut të paraqitur nga Prokurori i PSRK-së si provë e re, mbrojtja gjen se Prokurori i PSRK-së nuk u përpoq që ta siguronte këtë provë në gjykimin fillestar apo në rigjykim. Në të vërtetë, ishte gjykata Themelore ajo që kontaktoi KFOR-in në mënyrë që të vërtetonte se a kishte dhënë apo jo deklaratë **A.Z.** në KFOR.

Mbrojtësit kundërshtojnë futjen e çfarëdo prove të re në këtë fazë të vonë të procedurës gjyqësore, dhe thonë se Prokurori i PSRK-së nuk ka treguar arsye të fortë dhe që të argumentoi se këto prova nuk ishte të mundshme përmes ushtrimit të kujdesit të arsyeshëm. Ata kujtojnë se e drejta për të paraqitur prova të reja duhet të interpretohet dhe zbatohet në mënyrë të kufizuar për të siguruar që e drejta e një gjykimi të shpejtë, pa vonesa të panevojshme respektohet si duhet.

Në çdo rast, qëndrimi i tyre është se Prokurori i PSRK-së nuk paraqiti asnjë provë në lidhje me zinxhirin e kujdestarisë ose vërtetësinë e dokumenteve të supozuara, dhe se siç pranon edhe vetë Prokurori i PSRK-së, raporti policor i UNMIK-ut i datës 25 nëntor 2006 nuk është i nënshkruar, nuk është biseduar me oficerin në fjalë dhe se raporti nuk ekziston si format i kopjes në letër në arkivat e UNMIK-ut. Dhe as nuk shënim të raportit aktual në “EULEX WCIU Zy Find Library/Bibliotekën e NjHKL-së të EULEX-it”.

Për më tepër, avokatët mbrojtës pohojnë se nuk ka asnjë analizë teknike apo të pavarur për prova për të verifikuar: çfarë materiali elektronik është dorëzuar nga UNMIK-u gjatë periudhës kalimtare, kur filloi procesi i dorëzimit pranimit në tetor të vitit 2008, në çfarë rrethanash u krijua fillimisht, si dhe nga ana e kujt është marrë ky material, ku ishte ruajtur ai material, kush kishte qasje në të, pse mungon në arkivat në letër dhe pse nuk është i pranishëm në Bibliotekë. Përveç kësaj, qëndrimi i tyre është se informacioni është i pamjaftueshëm dhe joadekuat që të merret diskutohet ashtu si duhet. Sido që të jetë, mbrojtja thekson se nuk mund të pohohet se vendimi i Gjykatës Themelore që nuk e gjeti **A.Z.** të besueshëm u bazua vetëm ose kryesisht në mungesë të çfarëdo prove nga KFOR-i për të mbështetur shpjegimin që ai e dha.

Lidhur me deklaratën e **A.Z.** sa i përket vrasjes së pesë ushtarëve serb dhe vrasjes së **A.A.**, avokatët mbrojtës parashtrorin se argumentet e paraqitura nga Prokurori i PSRK-së thjesht karakterizojnë një mospajtim të Gjykatës Themelore. Ata janë të mendimit hipoteza alternative e propozuar nga Prokurori i PSRK-së nergut u mor parasysh dhe u refuzua nga ana e Gjykatës Themelore. Ata janë të mendimit se kjo alternativë ligjërish është jo e rëndësishme sepse është trupi gjykues – dhe jo Prokuroria – ajo e cila ka mandatin që të vlerësoj në mënyrë të pavarur dhe të paanshme provat.

Sa i përket dy oficerëve të policisë serbe gjoja të vrarë nga **A.Z.**, mbrojtja gjen se nuk është bërë asnjë gabim faktik. Ata theksojnë se hipoteza alternative e Prokurorit të PSRK-së është e pamjaftueshme për të zhvendosur me maturi gjetjet e konsideruara nga Gjykata Themelore, dhe se ai nuk ka vërtetuar që asnjë gjykues i arsyeshëm i fakteve mund të ketë ardhur në vendimet që i përmban Aktgjykimi i kundërshtuar.

Mbrojtja parashtron se ankesa e parashtruar nga Prokurori i PSRK-së është kryesisht i bazuar në spekulime të pabazuara, në hipoteza të menduara dhe të refuzuara, si dhe në prova të paqëndrueshme. Ata më tej nënvizojnë se ankesa kryesisht është e heshtur sa i përket provave të paraqitura nga mbrojtja, dhe se nuk është përmendur fare lidhur me provën që vërteton se **F.L.** nuk kishte asnjë përgjegjësi komanduese apo përgjegjësi tjetër mbi burgun e Kleçkës.

Mbrojtja konstaton se ankesa e Prokurorit të PSRK-së nuk është meritore dhe se duhet hidhet poshtë në plotësi.

C. Përgjigjja e N.K.

Në përgjigjen e tij ndaj ankesës së parashtruar nga ana e Prokurorit të PSRK-së **avokati mbrojtës i Mahmut Halimi** në emër të **N.K.** gjen se ankesa është parashtruar vetëm sa i përket të pandehurit **F.L.** i cili është personi kryesor në secilin paragraf të vetëm të ankesës. Avokati mbrojtës është i mendimit se kur një ankesë parashtrohet kundër një Aktgjykimi që ka të bëjë me shumë individ, ankuesi duhet të siguroj baza për secilin të akuzuar dhe se duhet të përmenden provat materiale në mënyrë që të vërtetohen akuzat. Ai parashtron se Gjykata Themelore ka lexuar të gjitha deklaratat e dëshmitarit **A.Z.** hollësisht në përputhshmëri me nenin 387 të KPPP-së, dhe ka vlerësuar këto dëshmi në kuptim të provave tjera, çka shpiti në konstatimin se këto deklarata janë shumë të paqarta për të mbështetur vendim fajësues. Ai më tej deklaroi se pretendimet e Prokurorit të PSRK-së lidhur me mundësin e mbrojtjes për ta marr në pyetje këtë dëshmitar nuk mund të jenë në asnjë mënyrë temë e nenit 157 (4) të KPPP-së, sepse dispozitivi është i qartë dhe i saktë, dhe se këto janë dy çështje të ndryshme siç vlerësohet nga Gjykata Themelore.

Mbrojtësi thekson se arsyetimi i aktgjykimit të kundërshtuar është shumë e qartë dhe i detajuar në lidhje me mospërputhjet në mes të deklaratave të **A.Z.** dhe dëshmive të tjera, siç janë ditarët, deklaratat e dëshmitarëve të tjerë dhe prova të tjera materiale, që do të thotë raportet e zhvarrosjes. Duke qenë kështu, ai pretendon se askush nuk mund të ketë ardhur në përfundim se deklaratat e **A.Z.** është dashur të konsiderohen si të besueshme. Pretendimet e Prokurorit të PSRK-së në faqet 7 dhe 8 të ankesës nuk përbëjnë shkelje esenciale të procedurës penale nga neni 403 (1.12) në lidhje me paragrafin (2.1) të KPPP-së.

Sa i përket pretendimeve të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, mbrojtësi pohon se prokurori më shumë e udhëzon Gjykatën sa i përket mënyrës se si duhet të vlerësohen provat. Më saktë, ai pretendon se Gjykata Themelore ka bërë një vlerësim të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike që nuk lë vend për mendim alternativ. Në këtë drejtim, ai vë në dukje pjesën e aktgjykimit të kundërshtuar që kanë të bëjnë me deklaratat e **A.Z.** në lidhje me kohën e vrasjeve të pretenduara, radhitjen se si janë gjetur eshtrat, dhe përjashtimin e mundësisë që varret ishin të prekura. Mbrojtësi deklaroi se gjetjet e Gjykatës Themelore që kanë të bëjnë me grafologji dhe ekspertizë neuropsikiatrike janë gjithëpërfshirëse dhe të qarta në këtë drejtim.

Ai pretendon se Gjykata Themelore gjithashtu dha arsye të plotë në lidhje me gjendjen mendore të **A.Z.** Më konkretisht, mbrojtësi mendon se gjetjet e Gjykatës Themelore në lidhje me faktin se **N.K.** dyshohet se kishte një informator të KFOR-it dhe ia përcillte informatat grupit të **F.L.**, dhe faktin se shtrimi në spitalin psikiatrik i **A.Z.** nuk lë asnjë hapësirë për një mendim të ndryshëm. Për më tepër, ai thekson se **A.Z.** i dha dy versione të të njëjtave ngjarje në lidhje me përfshirjen

apo mos përfshirjen e **N.K.** në transportimin e tij nga Prizreni në spitalin psikiatrik në Prishtinë, duke e bërë të pamundur për të dalë në një përfundim të duhur.

Avokati mbrojtës përfundon se kërkesat e nënvizuara në ankesën në fjalë janë të pabazuara dhe ligësisht të paqëndrueshme dhe se Prokurori i PSRK-së thjesht përpiket të detyroj apo të udhëzoj Gjykatën e Apelit për mënyrën se si ajo duhet të veprojnë në këtë rast. Ai në fund argumenton se propozimi i Prokurorit që Gjykata e Apelit të mbaj seancë dëgjimore për të pranuar prova është i pa bazuar.

Avokati mbrojtës propozon që të refuzohet ankesa e Prokurorit të PSRK-së si e pabazuar dhe të konfirmohet Aktgjykimi i ankimuar.

D. Përgjigjja e **N.K.**

Avokati mbrojtës Florin Vertopi dhe Xhafer Maliqi në emër të **N.K.** parashtruan një përgjigje të përbashkët ndaj ankesës së parashtruar nga ana e Prokurorit të PSRK-së. Ata qëndrojnë para asaj se Gjykata Themelore i shqyrtoi në mënyrë të duhur të gjitha deklaratat e **A.Z.** në përputhshmëri me procedurën e përcaktuar sipas nenit 368 të KPPP-së. Ata rikujtojnë se Prokurori, me rastin e përmirësimit të Aktakuzës, vetë e pranoi që **A.Z.** mund të kishte sqaruar kundërshtimet gjatë gjykimit por se kjo nuk ishte më e mundshme pasi që ai më nuk ishte i gjallë. Ata më tej deklarojnë se mungesa e **A.Z.** gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është i vetmi faktor që u morë parasysh me rastin e vlerësimit të besueshmërisë së tij. Më saktë, dëshmia e tij u morë si jo e besueshme për shkak të shumë kundërthënive. Mbrojtja po ashtu argumenton se Prokurori gabimisht u thirr në nenin 147 (4) të KPPP-së si e vlerësoi Gjykata Themelore se dëshmia e **A.Z.** në radhë të parë nuk ishte e besueshme.

Kur është fjala për pretendimin e gjoja vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, avokatët mbrojtës parashtrojnë se Prokurori i PSRK-së nuk tregoj për ndonjë dëshmi konkrete e cila është shpërfillur nga Gjykata Themelore e që do të kishte çuar në një rezultat të ndryshëm në qoftë se ajo ishte marrë në konsideratë. Ata argumentojnë se Gjykata Themelore ka vlerësuar siç duhet provat nëpërmjet një arsytim të plotë dhe të detajuar dhe nuk gaboj kur e gjeti **A.Z.** jo të sigurt. Si ilustrim, ata nxjerrin në pah kundërshtimet në dëshminë e **A.Z.** në lidhje me vrasjen e katër të burgosurve serbë. Ata më tej paraqesin se kallëzimet penale të paraqitura nga **N.K.** kundërshtojnë dëshminë e **A.Z.**, dhe gjithashtu konfirmojnë deklaratat e dëshmitarit **S.D.** në lidhje me punën juridike të **N.K.** në cilësinë e anëtarit të UÇK-së.

Për sa i përket ekspertit të grafologjisë, Professor **B.**, ata pretendojnë se ishte në përgjegjësi të Prokurorit të kërkojë kontroll të drejtpërdrejtë të ekspertëve nga ana e Trupit Gjykses, të cilën gjë ai nuk e bëri. Për këtë arsye, prokurori i PSRK-së nuk mund të fajësoj Gjykatën Themelore për mos thirrjen e dëshmitarit ekspert. Sa i përket gjendjes psikiatrik të **A.Z.**, ata kujtojnë se Gjykata Themelore e pranoi mendimin e dëshmitarëve ekspert Dr. **L.** dhe Dr. **R.**, të cilët deklaruan se ata nuk mund të përjashtojë mundësinë që **A.Z.** gënjeu. Sipas pikëpamjeve së tyre, Gjykata Themelore gjeti në mënyrë të duhur se kjo dëmtoi në masë të madhe besueshmërinë e **A.Z.**

Mbrojtja po ashtu nënvizon se dokumentet që Prokurori i PSRK-së kërkon që të pranohen si dëshmi nuk i plotësojnë kushtet sipas nenit 412 (1) të KPPP-së, dhe duhet të konsiderohen si të papranueshme. Ata theksojnë se, siç u pranua nga prokurori, raporti i policit datës 25 nëntor 2006 madje as nuk është i nënshkruar.

Për këto arsye, mbrojtja i propozon kolegjit të apelit që të refuzoj ankesën e Prokurorit të PSRK-së në tërësi dhe të konfirmoj Aktgjykimin e kundërshtuar.

E. Përgjigjja e N.S.

Avokati mbrojtës Bajram Tmava, në emër të **N.S.** dorëzoi përgjigjen e tij ndaj ankesës së parashtruar nga Prokurori i PSRK-së. Ai pretendon se Prokurori i PSRK-së është dashur të dalloj cilësimin e **A.Z.** si të dyshuar apo si dëshmitar bashkëpunues kur ai dha deklaratat e tija. Avokati mbrojtës pohon se prokurori kryesisht përsërit argumentet që ai ngrinte në gjyq. Ai përkujton se Gjykata Themelore konstatoi se mbrojtjes iu mohua mundësia për të marr në pyetje tërthorazi **A.Z.** Mbrojtësi iu referohet të gjitha argumenteve të tij të bëra gjatë fjalës së tij përfundimtare. Në këtë drejtim, ai pretendon se asnjë nga provat e paraqitura në gjyq vërteton përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se **N.S.** kryer veprat penale për të cilat ai akuzohet në aktakuzë. Së fundi, sa i përket dokumenteve që Prokurori i PSRK-së kërkon të jenë pranuar në dëshmi, ai argumenton se aktgjykimet nuk mund të trajtohet si dëshmi kur dihet që **A.Z.** nuk dëshmoj në këto raste dhe se të dyshuarit nuk kanë të bëjnë me çështjen në fjalë.

Avokati mbrojtës mbrojtja propozon që Gjykata e Apelit të refuzoj ankesën e Prokurorit të PSRK-së si të pabazuar dhe të konfirmoj Aktgjykimin e kundërshtuar.

F. Përgjigjja e S.S.

Avokati mbrojtës Mexhit Syla në emër të **S.S.** dorëzoi përgjigjen e tij ndaj ankesës së parashtruar nga Prokurori i PSRK-së. Mbrojtësi pohon se Prokurori i PSRK-së nuk arrin të ngrejë rrethana të reja në ankesën e tij dhe se ai thjesht përsërit parashtresat e bëra gjatë gjykimit. Ai thekson se ajo kurrë nuk ka qenë pjesë e lëndës së Prokurorisë në aktakuzë, e as nuk është vërtetuar me dëshmi, se **S.S.** kishte ndonjë autoritet apo se ka mbajtur ndonjë pozitë të lartë në qendrën e burgimit të Kleçkës. Ai shton se dëshmitari **U.K.** asnjëherë nuk ka dëshmuar për këtë fakt, e as nuk ka bërë diçka se ai e pa **S.S.** duke rrahur të burgosurit. Në këtë drejtim, mbrojtësi thekson se **U.K.** dëshmoi se ai gjithashtu e ka pa **S.S.** në vende të tjera gjatë luftës, dhe se nuk kishte asgjë më shumë se mundësisë që ai ishte në Kleçkë në vitin 1999. Ai gjithashtu kujton se Gjykata themelore drejtë konstatoi se kushtet e ndalimit në Kleçkë nuk përbëjnë trajtim mizor.

Mbrojtësi pajtohet me konstatimet e Gjykatës Themelore në lidhje me mungesën e besueshmërisë së dëshmive të **A.Z.** Ai më tej rikujton se **S.S.** nuk është përmendur në ndonjë nga të ashtuquajturat ditarë të **A.Z.**, përveç sa i përket kohërave së luftës.

Prandaj avokati mbrojtës i propozon kolegjit të apelit që të refuzoj ankesën e Prokurorit të PSRK-së në tërësi si të pabazuar dhe të konfirmoj Aktgjykimin e kundërshtuar.

G. Përgjigjja e R.M.

Avokati mbrojtës Haxhi Millaku në emër të **R.M.** dorëzoi përgjigjen e tij ndaj ankesës së parashtruar nga Prokurori i PSRK-së se e kishte marrë atë me datë 10 dhjetor 2013. Ai i referohet udhëzimeve të supozuara të dhëna nga Gjykata e Apelit lidhur me afatin për parashtrimin e përgjigjes. Ai pretendon se Prokurori i PSRK-së është dashur që të dalloj cilësinë e **A.Z.** si të dyshuar apo si dëshmitar bashkëpunues. Avokati mbrojtës pretendon se prokurori kryesisht përsërit argumentet që ai i ngriu në gjyq. Ai kujton se u konstatua se mbrojtjes iu mohua mundësia e marrjes në pyetje **A.Z.** në mënyrë të tërthortë. Ai nënvizon se qëndron në tërësi prapa parashtresave të tija të paraqitura në fjalën e tij përfundimtare të datës 9 shtator 2013. Ai thekson në veçanti se dëshmitë nga dëshmitarët e tjerë zbulojnë mospërputhje me lidhje me dëshmitë e dëshmitarit X dhe aktet e ndërmarra nga i pandehuri siç pretendohet në aktakuzë. As dëshmitë dhe as provat materiale të dhëna nga dëshmitarët gjatë shqyrtimit kryesor nuk kanë vërtetuar në mënyrë të qartë dhe përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri **R.M.** ka kryer veprat penale të përcaktuara si në aktakuzë. Për më tepër, avokati mbrojtës bë vërejtje se Prokurori i PSRK-së i referohet disa aktgjykimeve bashkangjitur ankesës. Sipas tij, këto aktgjykime nuk mund të merren si dëshmi duke qenë se dëshmitari X nuk dëshmoi në këto raste dhe se të dyshuarit nuk

kanë të bëjnë me çështjen në fjalë. Qëndrimi i mbrojtjes tashmë është konfirmuar nga Trupi Gjykyes. Prandaj, ai mbron qëndrimin se është e panevojshme që të bëhet një tjetër vlerësim i ri.

Avokati mbrojtës propozon që të refuzohet ankesa e Prokurorit të PSRK-së si të pabazuar dhe të konfirmoj Aktgjykimin e kundërshtuar në tërësi.

H. Mocioni i Prokurorit Shtetëror i Apelit.

Prokurori i Apelit Kari Lamberg me datë 3 qershor 2014 parashtroi mocionin ku kërkonte nga Gjykata e Apelit që të pranohet ankesën e Prokurorit të PSRK-së dhe të ndryshoj Aktgjykimin e kundërshtuar siç kërkohet, ose, si alternativ, ta kthejë në Gjykatën Themelore për rigjykim.

Posaçërisht, Prokurori i Apelit pohon se **F.L.** ishte kreu i Policisë Ushtarake të UÇK-së në zonën e dhe kishte kontroll mbi burgun e Kleçkë / Kleçkë. Në këtë drejtim, ai pretendon se dëshmia e **S.D.** është e pabesueshme në lidhje me pozitën e **F.L.** dhe ekzistencën e vrasjeve dhe akteve të torturës në burg. Ai pohon se **F.L.** mban përgjegjësi të lartë për veprat penale të kryera nga vartësit e tij në burgun e Kleçkës.

Në lidhje me dëshminë e **A.Z.**, Prokurori i Apelit rikujton se Gjykata Supreme ka konfirmuar pranueshmërinë e deklaratave të tij dhe "ditarin" e tij. Ai pohon se Gjykata Themelore gaboi kur kërkon dëshmi "të pavarura" vërtetuese me dëshminë e një dëshmitari bashkëpunues, duke treguar një precedent që mbështetet në "dëshmi mbështetëse dhe indikative". Ai argumenton se në rastin në fjalë zbulimet e mjekësisë ligjore si dhe të dëshmitarëve të tjerë dhanë dëshmi të qëndrueshme.

Prokurori i Apelit thekson se Gjykata Themelore mori një qëndrim shumë negativ ndaj deklaratave të **A.Z.** dhe se vuri peshë në pika të vogla, duke mos përfillur çështje objektive dhe të rëndësishme. Ai më tej thotë se ka prova të pa kontestueshme diskutueshme se njerëzit janë torturuar dhe vlarë në burgun e kontrolluar të UÇK-së në Kleçkë.

Ai në fund parashtron se deklaratat e **A.Z.** shumë përputhen me gjetjet e detajuara të hetuesve të mjekësisë ligjore.

GJETJET E KOLEGJIT TË APELIT.

Ligji Procedural në Fuqi në këtë Lëndë.

Me datë 1 janar 2013, në Kosovë hyri në fuqi një ligj i ri procedural - Kodi i Procedurës Penale, Ligji nr. 04 / L-123. Ky Kod shfuqizoi ish Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës. Neni 545 i Kodit aktual të Procedurës Penale përcakton se që të vendoset se a të përdoret a jo Kodi aktual i procedurës penale do të bazohet në bazë të datës së ngritjes së aktakuzës. Veprat të cilat ndodhën para hyrjes së fuqi të këtij Kodi do t'i nënshtrohen Kodit aktual, nëse procedura penale për hetimin dhe ndjekjen penale e asaj vepre ka filluar pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi.

Me datë 25 korrik 2011 prokurori special i EULEX-it parashtroi aktakuzën PPS nr. 07/10 duke akuzuar të pandehurit **A.K., N.K., N.K., B.L., F.L., R.M., N.S., S.S., S.S.** dhe **B.S.** për krimet që pretendohet të jenë kryer nga fillimi i vitit 1999 deri në mesin e qershorit të vitit 1999 kundër popullatës civile serbe dhe shqiptare dhe të burgosurve të armatës serbe të ndaluar në burgun e fshatit Kleçkë. Kështu pra, Aktakuza është ngritur para hyrjes në fuqi të Kodit aktual të Procedurës Penale. Në bazë të nenit 545 të Kodit aktual të Procedurës Penale ligji procedural i zbatueshëm me këtë rast është Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës i UNMIK-ut, sepse gjykim për këtë lëndë ka filluar para hyrjes në fuqi të Kodit aktual. Gjykata e Apelit në mënyrë të duhur zhvilloi procedurën në përputhshmëri me Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës.

B. Kompetencat eKolegjit.

Në përputhje me nenin 121, paragrafi 1 të KPPP-së, kolegji ka shqyrtuar kompetencat e veta, dhe pasi që nuk është ngritur asnjë kundërshtim zyrtar nga palët kolegji bënë vetëm komentet në vijim. Në bazë të Ligjit mbi Gjykatat dhe Ligjit mbi Kompetencat, Ndarjen dhe Përzgjedhjen e Lëndëve për Gjyqtarët dhe Prokurorët e EULEX-it në Kosovë – Ligji nr. 03/L-053 siç është përmirësuar me Ligjin nr. 04/L-273 dhe i sqaruar nëpërmjet Marrëveshjes mes Kryesuesit të EULEX-it në Kosovë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës të datës 18 qershor 2014, kolegji konstaton se EULEX-i ka kompetencat për këtë lëndë dhe se kolegji është kompetent për të vendosur lidhur me çështjen përkatëse në përbërje të dy gjyqtarëve të EULEX-it dhe një gjyqtari të Kosovës.

Përmes letrës së tij të datës 24 prill 2014, Kryetari i Gjyqtarëve të EULEX-it, Malcolm Simmons, ia caktoi në mënyrë të drejtë këtë lëndë penale gjyqtarit të EULEX-it Piotr Bojarczuk si kryetar i kolegjit për të zhvilluar procedurën gjyqësore të apelit. Kompetencat e këtij kolegji se

dhe përbërja e tij nuk është kundërshtuar dhe se është pranuar nga të gjithë të pandehurit, avokatët mbrojtës dhe Prokurori i shtetit.

C. Pranueshmëria e Ankesës dhe e Përgjigjeve.

Ankesa e parashtruar nga ana e Prokurorit të PSRK-së është e pranueshme.

Në bazë të nenit 398 (1) të KPPP-së, personat e autorizuar mund të parashtrorin ankesë kundër një Aktgjykimi brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur ata marrin një ekzemplarë të atij Aktgjykimi. Aktgjykimi i kundërshtuar është shpallur me datë 17 shtator 2013 dhe i është dorëzuar Prokurorit të PSRK-së me datë 18 nëntor 2013. The Prokurori parashtrorin ankesën e tij, të datës 28 nëntor 2013, me datë 29 nëntor 2013. Kështu pra, ankesa u parashtrua brenda afatit prej 15-ditëve në pajtim me nenin 398 (1) të KPPP-së. Përveç kësaj, Prokurori është person i autorizuar në bazë të nenit 398 (1), nenit 399 (2) të KPPP-së; ankesa përmban të gjitha të dhënat siç parashihet me ligj në pajtim me nenin 401 *et seq* të KPPP-së. Kështu pra, ankesa është e pranueshme.

Sa i përket përgjigjeve, Gjykata e Apelit rikujton se në bazë të nenit 408 të KPPPK, palët, pasi të kenë marrë një kopje të ankesës, mund të paraqesin përgjigje në ankesë në afat prej tetë ditësh nga dita e marrjes së kësaj kopjeje.

Megjithatë, kolegji merr parasysh udhëzimet shitesë të Gjykatës Themelore dhënë mbrojtjes përmes emailit të datës 12 dhjetor 2013. Sipas këtyre udhëzimeve mbrojtja mund të paraqesë përgjigje deri "në përfundim të orarit të punës" me datë 31 dhjetor 2013, e cila përsëri do të merret nga Gjykata e Apelit si ankesë e parashtruar në mënyrë të duhur dhe në kohë, edhe po qe se afati prej tetë ditësh kishte skaduar.

Duke pasur parasysh se data 31 dhjetor 2013, bie përtej periudhës tetë ditësh të parashikuar sipas KPPP-së për të paraqitur përgjigje dhe është në favor të të pandehurve, kolegji do ta konsiderojë këtë datë si afat të vlefshëm. Prandaj, kolegji i apelit konstaton se përgjigjet e paraqitura në emër të të pandehurve **N.K.**, **N.K.**, **N.S.**, **S.S.** dhe **F.L.** janë në kohë të duhur dhe të pranueshme, pavarësisht nga fakti se disa përgjigje janë paraqitur pas afatit tetë ditësh të paraparë me nenin 408 të KPPP-së.

Megjithatë, kolegji vë në dukje se përgjigja e parashtruar në emër të **R.M.** është e vonuar. I pandehuri ka marrë ankesën e Prokurorit të PSRK-së me datë 14 dhjetor 2013. Avokati i tij mbrojtës ka marrë ankesën me datë 10 dhjetor 2013. Ndërsa përgjigja është e datës 31 dhjetor

2013 dhe vë në dukje se është parashtruar në këtë datë në përputhje me udhëzimet e Gjykatës, data e dërgimit siç vërtetohet nga data e vulës në zarf del të jetë data 3 janar 2014, pra më vonë se sa afati i datës 31 dhjetor 2013.

Neni 94 (3) i KPPP-së parashikon që kur një deklaratë dërgohet me postë, data e postimit ose dërgimit konsiderohet si ditë e dorëzimit për personin të cilit i është dërguar. Për këtë arsye duhet të kihet parasysh se mbrojtja dorëzoi përgjigjen përmes shërbimit postar pas datës 31 dhjetor 2013, dhe për këtë arsye nuk është parashtruar në mënyrë dhe në kohë të duhur. Në bazë të nenit 94 (3) të KPPP-së, prandaj Gjykata e Apelit e konsideron këtë përgjigje si të vonuar.

D. Vërtetimi i Gjendjes Faktike.

Prokurori i PSRK-së pohon se Gjykata Themelore erdhi në **vërtetim të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike** kur konstatoi se dëshmia e **A.Z.** nuk ishte e besueshme. Në këtë drejtim, ai mbron qëndrimin e tij se Gjykata Themelore gaboi në gjetjen se: (i) nuk ka pasur përputhshmëri të mjaftueshme për dëshmitë e **A.Z.**; (ii) "ditarët" e tij nuk ishin të besueshëm; (iii) ai gënjeu në lidhje me gjendjen e tij shëndetësore dhe se kishte dhënë një deklaratë në KFOR-it; (iv) dëshmitë e mjekësisë-ligjore vënë në kundërshtim deklaratat e tij në lidhje me vrasjen e pesë të burgosurve serbë dhe vrasjen e **A.A.**; dhe se (v) dëshmia e tij është kundërtënëse në lidhje me vrasjen e dy policëve serbë.

Para se të vlerësonte vlefshmërinë e argumenteve të paraqitura nga Prokurori lidhur me të pretenduarit për vërtetimi të gabueshëm ose jo të plotë të fakteve, kolegji rithekson standardin e shqyrtimit lidhur me gjetjet faktike të bëra nga kolegji shqyrtues.

Të marrësh konceptin ligjor të nenit 366 LPP-së dhe juridiksionin paraprak, nuk është e mjaftueshme për një ankues që të paraqes vetëm të pretenduarit e një vërtetimi të gabuar ose jo të plotë të fakteve nga trupi gjykues. Për më tepër, siç parashihet me KPPP-në që përcaktimi i gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike të ketë të bëjë me një "fakt material", ankuesi duhet të vërtetoj po ashtu se përcaktimi i gabuar ose jo i plotë i gjendjes faktike në të vërtetë ka të bëjë me një fakt material, pra është vendimtar për vendimin e arritur.¹

Për më tepër, është parim i përgjithshëm i procedurave të apelit që Gjykata e Apelit u jap një vlerësim të kufizuar sa i përket gjetjeve të faktit të arritura nga trupi gjykues, sepse është trupi gjykues ai të vlerëson më së miri dëshmitë. Gjykata Supreme e Kosovës vazhdimisht përkujton

¹ Shih po ashtu B. Petric, në: Komentaret e neneve të Ligjit të Procedurës Penale të Jugosllavisë, botimi i 2-të viti 1986, neni 366, para. I. 3.

se duhet të "lëshojmë pe ndaj vlerësimit të bërë nga ana e trupit gjykues për besueshmërinë e dëshmitarëve në gjykim që paraqitën personalisht para tyre dhe të cilët kanë dëshmuar personalisht para tyre. Nuk është e në rregull që Gjykata Supreme e Kosovës të nëpërkëmbë vlerësimin e trupit gjykues për besueshmërinë e këtyre dëshmitarëve nëse nuk ka një bazë të shëndoshë për ta bërë një gjë të tillë." Standardi të cilin e zbatoi Gjykata Supreme ishte "që të mos prish gjetjet e gjykatës së shkallës së parë, përveç nëse provat mbi të cilat u mbështet gjykimi i gjykatës nuk kanë mundur që të pranoheshin nga një gjykatë e arsyeshme e vërtetë, ose kur vlerësimi i saj ka qenë tërësisht i gabuar"(Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZi 84/2009, 3 dhjetor 2009, paragrafi 35;. Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZi 2/2012, 24 shtator 2012 para. 30).

Në përgjithësi, Gjykata e Apelit vëren se Gjykata Themelore analizon në detaje në aktgjykimin e kundërshtuar dëshmitë e shqyrtuara gjatë shqyrtimit gjyqësor. Kolegji shqyrtoi analizën e hollësishme të besueshmërisë së **A.Z.** si dëshmitarë bashkëpunues X, deklaratimet e tij dhe ditarët e tij siç janë përcaktuar veçanërisht në paragrafët 66 deri 136 të aktgjyimit të kundërshtuar (numërimi i faqeve sipas versionit në gjuhën angleze). Sipas mendimit të kolegjit, Gjykata Themelore ka marrë në përgjithësi përfundime logjike në vlerësimin e provave dhe kolegji konstaton se në përgjithësi nuk ka kundërthënje në qëndrimin e Gjykatës Themelore. Kolegji gjithashtu ka shqyrtuar provat në përputhje me dispozitat e KPPP-së. Pas këtij vlerësimi të kujdesshëm, kolegji është kryesisht plotësisht i bindur nga konstatimet dhe arsyetimi i Gjykatës Themelore. Kolegji konstaton se nuk ka prova të mjaftueshme për të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se të pandehurit janë fajtorë për kryerjen e *Krimit të Luftës kundër Popullatës Civile*, sipas Neneve 22, 142 të KPRSFJ-së, aktualisht e ndëshkueshme sipas Neneve 31, 152 të KPRK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të datës 12 gushtit 1949 dhe neneve 4, 5 (1) të Protokollit Shtesë II dhe *Krime Luftë kundër Robërve të Luftës*, sipas neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, aktualisht e ndëshkueshme sipas neneve 31, 152 të KPRK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të datës 12 gushtit 1949 dhe neneve 4, 5 (1) të Protokollit Shtesë II për vrasjet, rrahjet dhe trajtimet çnjerëzore kundër të burgosurve serbë dhe shqiptarë të luftës dhe civilëve të burgosur në qendrën e paraburgimit që ndodhej në Kleçkë.

Kolegji, prandaj, nuk e sheh të nevojshme që të përsërisë analizën e plotë të detajuar të Gjykatës Themelore, por do të shqyrtojë vetëm pikat në vijim.

(1) Standardi ligjor i vërtetimit sipas nenit 157 (4) të KPPPK-së

Prokurori parashtroi se Gjykata Themelore ka përdorur një standard jo të saktë të vërtetimit kur ka ardhur në përfundim se edhe nëse trupi gjykues e ka shpallur **A.Z.** të jetë dëshmitar i besueshëm kjo në vetvete nuk do ta siguronte mbështetjen e kërkuar me ligj (fq. 136 numërtimi në versionin në anglisht). Prokurori i referohet nenit 157 (4) të KPPPK-së dhe konsideron se provat e dhëna nga dëshmitari bashkëpunues *per se* nuk janë të mjaftueshme për të mbështetur një aktvendim për përgjegjësi penale. Natyra e mbështetjes së kërkuar nuk është përshkruar nga neni 157 (4) apo diku tjetër në ligj. Pasi që ligjvënësi nuk ka dhënë ndonjë indikacion, në këtë aspekt kolegji është i lirë të vendosë sipas rasteve veç e veç (diskrecioni ligjor) se çfarë mund të jenë provat vërtetuese. Mungesa e çfarëdo lloji të indikacionit nga ligjvënësi i jep gjyqtarit të drejtën ligjore të detyrës për të identifikuar shkallën e nevojshme të të provuarit.

Prokuroria gjen se Gjykata Themelore nuk iu është adresuar fare problemit vendimtar. Në vend të kësaj gjykata ka bërë deklaratën se “...është ligj i zakonshëm që provat e vërtetuara duhet të jenë të pavarura, të cilat e implikojnë të akuzuarin në kryerjen e veprës penale..”. Gjykata e mori si të mirëqenë se në secilin dhe në çdo rast ku ka një dëshmitar bashkëpunues, mbështetja relevante duhet të lidhet me identitetin e kryesve të veprave penale dhe përfshirjen e tyre në veprën penale. Megjithatë, prokuroria beson se në mungesë të një parametri të caktuar me ligj, nuk ka vend për një standard të tillë të pandryshueshëm. Me fjalë të tjera, çfarëdo elementi që sipas mendimit të gjyqtarit mbështet besueshmërinë tanimë të vërtetuar të dëshmitarit bashkëpunues, mund të jetë i mjaftueshëm për të përmbushur kushtin ligjor për dënim. Po të kishte dashur ligjvënësi që ta detyronte gjyqtarin për një standard të posaçëm, ai do ta kishte thënë këtë. Konstatimi se madje edhe nëse **A.Z.** do të ishte konsideruar si dëshmitar i besueshëm “...kjo në vetvete nuk do të siguronte mbështetjen e kërkuar me ligj (fq. 136)...”, qartazi është një gabim kryesor në tërë arsyetimin.

Kolegji i apelit pajtohet me prokurorin dhe gjen se Gjykata Themelore ka gabuar në zbatimin e standardit të gabuar për vërtetim, që do të thotë në konstatimin se vërtetimi sa i përket identitetit të kryesve të veprave penale është kërkuar që të hyjë në dënim në bazë të provave të një dëshmitari anonim apo dëshmitari bashkëpunues sipas neneve përkatësisht nenit 157 (3) dhe (4) të KPPPK-së.

Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj pati qëndrimin se vërtetimi i identitetit kërkohet për mbështetjen e provave të dhëna nga dëshmitari bashkëpunues. Në faqe 68 (numërtimi në anglisht) të aktgjykimit të kundërshtuar të Gjykatës Themelore thuhet se:

“Gjetja e mbetjeve mortore në apo afër fshatit Kleçkë mund të mbështesë rastin e prokurorisë se krimet janë kryer. Në mungesë të provave tjera, gjetja e mbetjeve nuk vërteton se nga kush janë kryer ato krime apo, në fakt, kur dhe ku janë kryer ato krime. Gjetja e mbetjeve mortore nuk vërteton dëshminë e A.Z. në lidhje me identitetin e kryesve të atyre krimeve.”

Nga kjo është e qartë se Gjykata Themelore ka gjetur se vërtetimi i identitetit të kryesve të veprave penale duket të jetë kërkesë e domosdoshme për të caktuar dënimin bazuar në dëshminë e dëshmitarit bashkëpunues sipas nenit 157 (4) të KPPK-së.

Megjithatë, kolegji konstaton se një kusht i tillë në kuptimin e plotë të fjalës nuk kërkohet me ligj. Neni 157 (4) i KPPK-së lexon si në vijim: *“Gjykata nuk duhet të shpallë fajtor asnjë person bazuar vetëm në dëshminë e dhënë nga dëshmitari bashkëpunues.”* Duke pasur parasysh formulimin e kësaj dispozite Gjykata e Apelit është e mendimit se ligji nuk kërkon vërtetimin e identitetit. Përkundrazi është e arsyeshme të supozojmë se jo vetëm vërtetimi i identitetit, por çdo lloj vërtetimi konsiderohet si i mjaftueshëm nga ligjvënësi. Nuk ka arsye ligjore për të interpretuar në mënyrë rigorozë dispozitën, që do të thotë se vërtetimi i identitetit kërkohet gjithnjë. Një interpretim i tillë nuk mbështetet nga formulimi i ligjit. Përveç kësaj, gjithashtu nuk ka nevojë për një shkurtime teleologjik të dispozitës. Kuptimi dhe qëllimi i nenit 157 (4) të KPPK-së është të parandalojë dënimin e një kryerësi duke u bazuar vetëm në deklaratën e një dëshmitari të vetëm bashkëpunues. Vetëm dëshmia e dëshmitarit bashkëpunues kurrë nuk duhet konsideruar si e mjaftueshme për një dënim. Arsyeja për këtë është se madje edhe nëse dëshmitari bashkëpunues konsiderohet mjaft i besueshëm dhe që meriton besim, ai nuk mund të arrijë atë nivel të besimit që një dëshmitar i rregullt mund të arrijë. Për këtë arsye, dëshmia e tij duhet të mbështetet nga një lloj provash konfirmuese. Në të kundërtën, kërkesa e dy apo e më shumë dëshmime tjera mbi identitetin do të komprometonte zbatimin efektiv të ligjit. Prandaj, Gjykata e Apelit, në interpretim të nenit 157 (4) të KPPK-së, konstaton se është i mjaftueshëm çdo lloj i provës vërtetuese, por sërish të gjitha duhet të jenë të besueshme dhe të vërtetuara përtej dyshimit të bazuar.

Ky qëndrim mbështetet nga jurisprudenca e Gjykatës Supreme të Kosovës, që ka deklaruar qartazi se:

... Interpretimi se duhet të ketë së paku vërtetim të identitetit të kryesve nuk mbështetet me ligj.²

Në aktvendimin e saj të rastit *Sadik Abazi et al.* Gjykata Supreme e Kosovës vëren:

² Gjykata Supreme e Kosovës, Aktvendim, 11 dhjetor 2012, para. 78.

Në lidhje me çështjen nëse duhet të ketë pasur prova të tjera, në veçanti mbi identitetin e kryesve të veprave penale. Do të thotë, nuk ka dëshmitarë të tjerë përveç dëshmitarit bashkëpunues, i cili i ka identifikuar kryesit e veprave penale.³

Në paragrafin 4.12, Gjykata Supreme thekson se neni 157 (4) i KPPPK-së nuk përcakton ndonjë rregull të mëtejme për të përcaktuar se çfarë lloj provash konfirmuese kërkohen, ose për çfarë elemente apo fakte në lidhje me veprën penale. Prandaj, Gjykata Supreme konsideron se kjo pyetje, nëse janë paraqitur prova të mjaftueshme provuese, duhet të vlerësohet në secilin rast veçmas. Duke vepruar kështu, gjykata duhet të marrë parasysh të gjitha provat e paraqitura në këtë rast dhe besueshmërinë e asaj prove. Prandaj, varësisht nga rasti, nëse dëshmia e dëshmitarit bashkëpunues konsiderohet të jetë fuqishëm e besueshme dhe e meriton besimin, dhe dëshmia në disa pjesë vërtetohet nga prova tjera, nuk do të jetë e nevojshme që të kërkohen prova shtesë për të gjitha faktet tjera relevante, për shembull mbi identitetin e kryesit.⁴

Përfundimisht, Gjykata Supreme ka vënë re:

Gjykata e Qarkut ka studiuar në mënyrë gjithëpërfshirëse besueshmërinë e dëshmitarit bashkëpunues dhe e ka gjetur dëshminë e tij si që e meriton besimin, të besueshme dhe bindëse. Dëshmitari bashkëpunues i ka njohur më parë kryesit e veprave penale dhe Gjykata e Qarkut nuk ka gjetur ndonjë pasiguri në dëshminë e tij mbi identitetin e kryesve të tjerë. Ka prova të tjera të cilat Gjykata e Qarkut i ka gjetur si të përputhshme me disa pjesë të ngjarjeve të përshkruara në dëshminë e dëshmitarit bashkëpunues. Gjykata Supreme pajtohet me Gjykatën e Apelit se të pandehurit nuk janë gjetur fajtorë bazuar vetëm në dëshminë e dhënë nga dëshmitari bashkëpunues. Fakti se asnjë provë tjetër nuk ka vërtetuar drejtpërdrejtë identitetin e kryesve nuk do të thotë se të pandehurit janë gjetur fajtorë bazuar vetëm në dëshminë e dëshmitarit bashkëpunues.⁵

Gjithashtu, Gjykata e Apelit vëren jurisprudencën e Gjykatës së Apelit të TPNR dhe TPNJ që mbështet qëndrimin e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme.

TPNR në aktgjykimin e kundërshtuar *Ndahimana* ka deklaruar:

Sipas mendimit të Gjykatës së Apelit, konstatimi se dëshmia e një dëshmitari nuk është mjaftueshëm e besueshme apo e qëndrueshme për t'u mbështetur vetëm në të dhe prandaj ka nevojë që të vërtetohet, nuk arrin në konstatimin se dëshmitarit nuk duhet t'i besohet fare, por thjesht paraqet miratimin e një qasjeje të kujdesshme nga trupi gjykues në vlerësimin e provave.

³ Gjykata Supreme e Kosovës, Aktvendim, 3 shtator 2014, para. 4.11.

⁴ Gjykata Supreme e Kosovës, Aktvendim, 3 shtator 2014, para. 4.12.

⁵ Gjykata Supreme e Kosovës, Aktvendim, 3 shtator 2014, para. 4.13.

*Në mungesë të ndonjë konstatimi të kundërt, vendimi i trupi gjykues që përfundimisht të mbështetet në prova kumulative të dëshmitarëve, dëshmia e të cilëve kërkon përputhshmëri, pasqyron përcaktimin e trupit gjykues, marrë në tërësi, provat ishin mjaftueshëm të besueshme dhe të mbështetshme.*⁶

Në aktgjykimin e kundërshtuar *Munyakazi*, TPNR ka deklaruar:

*Gjykata e Apelit më tej ri sjell se të provuarit mund të ekzistojë madje edhe kur disa detaje ndryshojnë në mes dëshmimeve, me kusht që asnjë dëshmi e besueshme të mos përshkruajë faktet në fjalë në atë mënyrë që nuk është kompatible me përshkrimin e dhënë në një dëshmi tjetër të besueshme.*⁷ [...] *Të provuarit nuk kërkon që dëshmitë e dëshmitarëve të jenë identike në çdo aspekt. Përkundrazi, çështja kryesore është nëse dy apo më shumë dëshmi të besueshme janë jokompatible.*⁸

TPNJ në aktgjykimin e kundërshtuar *Haradinaj et al.* deklaroi:

*Trupi gjykues mund të caktojë një dënim në bazë të një dëshmitari të vetëm, megjithëse prova e tillë duhet të vlerësohet me kujdesin e duhur dhe duhet të kihet kujdes për të mbrojtur kundër ushtrimit të një motivi themelor nga ana e dëshmitarit.*⁹ [...] *Gjykata e Apelit ri sjell se trupi gjykues ka të drejtë të mbështetet në provat e një dëshmitari të vetëm gjatë konstatimit të tij. Dëshmia e një dëshmitari të vetëm mund të pranohet pa nevojën e të provuarit, madje edhe nëse ka të bëjë me një fakt material.*¹⁰

Në aktgjykimin e kundërshtuar *Popovic*, TPNJ ka deklaruar:

*Trupi gjykues duhet të marrë parasysh faktorët relevant mbi bazën e rast pas rastit, përfshirë sjelljen e dëshmitarit në gjykatë; rolin e tij në ngjarjet në fjalë; besueshmërinë dhe qartësinë e dëshmisë së tij; nëse ka kundërthënie apo mospërputhje në deklaratat e tij të njëpasnjëshme apo në mes të dëshmisë tij dhe provave të tjera.*¹¹

Jurisprudenca në këtë çështje e bënë të qartë se nëse dëshmia e dëshmitarit ka nevojë për përputhshmëri, duhet të aprovohet një qasje e kujdesshme nga trupi gjykues gjatë vlerësimit të provave. Të provuarit duhet të shqyrtohet mbi bazën e rast pas rastit. Qëllimi i provave të

⁶ TPNR, *Grégoire Ndahimana v. Prokurori, Aktgjykimi i kundërshtuar*, 16 dhjetor 2013, para. 45.

⁷ TPNR, *Prokurori v. Yussuf Munyakazi, Aktgjykimi i kundërshtuar*, 28 shtator 2011, para. 71.

⁸ TPNR, *Prokurori v. Yussuf Munyakazi, Aktgjykimi i kundërshtuar*, 28 shtator 2011, para. 103.

⁹ TPNJ, *Prokurori v. Ramush Haradinaj et al., Aktgjykimi i kundërshtuar*, 19 korrik 2010, para 145.

¹⁰ TPNJ, *Prokurori v. Ramush Haradinaj et al., Aktgjykimi i kundërshtuar*, 19 korrik 2010, para 219.

¹¹ TPNJ, *Prokurori v. Vujadin Popovic et al., Aktgjykimi i kundërshtuar*, 30 janar 2015, para. 132.

vërtetuara është të përcaktohet nëse dëshmia e dëshmitarit bashkëpunues, pra prova, ishte mjaftueshëm e besueshme dhe e qëndrueshme apo jo.

Duke pasur parasysh atë që u tha më lart, Gjykata e Apelit konstaton se vërtetimi i identitetit nuk kërkohet me ligj. Çdo lloj vërtetimi mund të jetë i mjaftueshëm dhe kjo duhet të shqyrtohet mbi bazën e rast pas rastit. Kolegji i Apelit prandaj është i mendimit se trupi gjykues ka gabuar kur ka konstatuar se të vërtetuarit ishte i nevojshëm për identitetin e kryesve dhe pajtohet me prokurorinë në këtë drejtim. Si rezultat ligjor i këtij gabimi Gjykata Themelore nuk ka vlerësuar provat në tërësi. Kjo siguron bazën ligjore për kolegjin e apelit për të shqyrtuar provat e paraqitura në gjykim.

(2) Pranueshmëria e deklaratave dhe ditarëve të A.Z.

Kolegji vëren se pyetja nëse deklaratat dhe ditarët e **A.Z.** janë të pranueshëm, tanimë është vendosur nga Gjykata Supreme. Gjykata Themelore, në një aktvendim të veçantë, fillimisht i ka shpallur të papranueshme deklaratat dhe ditarët e **A.Z.** Gjykata Supreme në aktvendimet e saj të datës 20 nëntor 2012 dhe 11 dhjetor 2012 i ka shpallur deklaratat dhe ditarët plotësisht të pranueshëm dhe ka deklaruar se Gjykata Themelore ka bërë një gabim ligjor kur ka spekuluar se edhe pse provat e **A.Z.** ishin të besueshme nuk ka mbështetje të mjaftueshme. Prandaj, Gjykatës Themelore nuk duhet t'i lejohet që të bëjë parashikime hipotetike mbi përfundimin. Gjykata Supreme ka vërejtur:

Në njërën anë deklarimi i një numri të madh të provave si të papranueshme dhe në të njëjtën kohë parashikimi se edhe në qoftë se ato do të ishin pranuar rezultati përsëri do të ishte i njëjtë, gjykata jo vetëm që shkel nenin 405 të KPPPK-së, por tregon gjithashtu një opinion të paramenduar më parë se vazhdimi i procedurës së provave do të ishte i kotë në këtë rast. Një qëndrim i tillë vë në dyshim serioz paanshmërinë e trupit gjykues [si duke u përpjekur për të bindur se çdo vazhdim i procedurës së provave do të ishte i kotë në çfarëdo rasti].¹²

Gjykata e Apelit vëren se në aktgjykimin në fjalë trupi gjykues ka konsideruar deklaratat dhe ditarët e **A.Z.** si prova të pranueshme. Megjithatë, absolutisht saktë kolegji vëren se duhet të bëhet një dallim në mes të pranueshmërisë dhe besueshmërisë së provave. Përderisa pranueshmëria e provave të **A.Z.** nuk është më një çështje, pesha dhe masa në të cilën trupi gjykues mund të mbështesë dëshminë e tij në përcaktimin e çështjeve mbi të cilat ai ka dhënë dëshmi. Kolegji i shkallës së parë ka vërejtur saktë se besueshmëria e provave nuk është

¹² Gjykata Supreme e Kosovës, Aktvendim, 11 dhjetor 2012, para. 77.

vlerësuar nga Gjykata Supreme. Prandaj, Gjykata e Apelit së pari është dashur të vlerësojë dhe vlerësoi besueshmërinë e deklaratave të **A.Z.** dhe ditarrëve të tij më parë, së dyti, duke vlerësuar provat si dhe provat konfirmuese në lidhje me përgjegjësinë penale të të pandehurve.

(3) Besueshmëria dhe kredibiliteti i dëshmitarit bashkëpunues **A.Z.**

Në aktgjykimin e saj, Gjykata Themelore konstatoi dëshmitarin bashkëpunues **A.Z.** të jetë i pabesueshëm dhe i pasigurt kur ka konkluduar:

*“... Në aspekte të shumta materiale, të cilave ju referohet këtu, dëshmia e dhënë nga **A.Z.** nuk është vetëm kontradiktore, por kundërshtohet ndjeshëm nga prova të tjera. Mospërputhjet dhe kontradiktat e gjetura nga gjykata nuk janë mospërputhje që mund të jenë produkt i një kujtese të ndershme, por të papërsosur, vëzhgimit apo rindërtimit të ngjarjeve, për të cilën ai dha prova.”¹³ “*

Gjykata e Apelit kujton se trupi gjykues në përgjithësi ka një diskrecion të gjerë për të marrë në konsideratë të gjithë faktorët relevant në përcaktimin e peshës për të ia bashkëngjitur dëshmisë së cilitdo dëshmitar. Është në diskrecionin e çdo gjyqtari të vetëm dhe Kolegji për të vlerësuar provat në tërësi, pa shpjeguar vendimin e tij në detaje.¹⁴

Më tej, Gjykata e Apelit vëren se një gjyqtar ka të drejtën të mbështetet në prova të cilat janë dhënë nga një dëshmitar bashkëpunues. Megjithatë, kur peshon vlerën provuese të provave të tilla, gjyqtari është i detyruar të konsiderojë me kujdes tërësinë e rrethanave në të cilat është tenderuar.

Për më tepër, Gjykata e Apelit rikujton se mospërputhjet e vogla zakonisht ndodhin në dëshminë e dëshmitarëve, pa e bërë të besueshme.¹⁵ Kolegji i Apelit rikujton se një gjykatës është i detyruar të "artikulojë me kujdes faktorët mbi të cilat mbështetet në mbështetje të identifikimit të të akuzuarit dhe të adresojë në mënyrë adekuate ndonjë faktor të rëndësishëm që ndikon negativisht në besueshmërinë e provave të identifikimit”.¹⁶

¹³ Gjykata Themelore në Prishtinë, Aktgjykimi, 17 shtator 2013, fq. 135 (faqet në anglisht).

¹⁴ ICTY, *Prokurori kundër Milan Lukić dhe Sredoje Lukić*, Aktgjykimi i ankimuar, 4 dhjetor 2012, fq. 5; ICTY, *Prokurori kundër Kvočka et al.*, Aktgjykimi i ankimuar, 28 shkurt 2005, para. 23, që i referohet *Čelebići* aktgjykimi i ankimuar, paragraf 481, 498; ICTY, *Prokurori kundër Zoran Kupreškić et al.*, Aktgjykimi i ankimuar, 23 tetor 2001, para. 32.

¹⁵ ICTY, *Prokurori kundër Milan Lukić dhe Sredoje Lukić*, Aktgjykimi i ankimuar, 4 dhjetor 2012, fq. 5; ICTY, *Prokurori kundër Ramush Haradinaj et al.* Aktgjykimi i ankimuar, 19 July 2010, para. 134.

¹⁶ ICTY, *Prokurori kundër Milan Lukić dhe Sredoje Lukić*, Aktgjykimi i ankimuar, 4 dhjetor 2012, po aty; ICTY, *Prokurori kundër Zoran Kupreškić et al.*, Aktgjykimi i ankimuar, 23 tetor 2001, par. 39.

Në këtë rast, besueshmëria dhe kredibiliteti i dëshmitarit bashkëpunues **A.Z.** është vendimtar për rezultatin e rastit për shkak të faktit se Aktakuza, si dhe aktgjykimi, bazohen kryesisht në dëshminë e tij. Në kuadrin e asaj që u tha më sipër, Gjykata e Apelit vëren se së pari duhet të adresuar çështjen nëse dëshmitari bashkëpunues **A.Z.** është i besueshëm dhe besnik. Në hapin e dytë, Paneli duhet të vlerësojë se nëse ka apo nuk ka ndonjë pjesë të provave me një kredibilitet të veçantë, e në të cilën Paneli mund të mbështetet.

Bazuar në këto vërejtje të përgjithshme, Gjykata e Apelit i ka vlerësuar në tërësi deklaratat e **A.Z.** dhe e konstaton atë të mos jetë as i besueshëm e as kredibil. Duke pasur parasysh sa u tha më sipër, duhet thënë se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i saktë dhe në përgjithësi i arsyetuar siq duhet.

Paneli i Gjykatës së Apelit e bazon vendimin e saj në arsyet e mëposhtme kryesore:

(3.1) Hospitalizimi / Të dhënat Psikiatrike të A.Z.

Historia psikiatrike dhe Hospitalizimi i **A.Z.** janë të rëndësishme pasi që ato tregojnë nëse ai mund të vlerësohet në përgjithësi si i besueshëm dhe kredibil.

A.Z. qe hospitalizuar për herë të parë në spitalin psikiatrik në Prizren nga data 15 dhjetor 2005 e deri me 4 janar 2006 me diagnozën përfundimtare si në vijim: *çrregullimi post-traumatik*, PTSP (F.43) dhe *cephalea post traumatike* (S09). Trupi Gjykues i është referuar të dhënave klinike dhe theksohet se **A.Z.** u pranua për shkak të dhimbjeve të kokës dhe çrregullimeve të tjera të cilat kanë qenë të vazhdueshme për tre javë pas një aksidenti në trafikun rrugor. Ai u "lirua me përmirësimin e gjendjes" dhe i qe përshkruar *Fluoxetine*, që është një ilaç që përdoret si trajtim kundër depresionit.

A.Z. ishte pranuar për trajtim në një rast të dytë në mes të datës 30 nëntor 2006 dhe 19 janar 2007 në Prishtinë. Ai u shtrua në spital për pak kohë në Prizren dhe më pas transferohet me ambulancë në Prishtinë, ku ai u pranua në repartin psikiatrik "A". Ai u transferua në kujdesin psikiatrik intensiv, dhe më pas ai u transferua përsëri në repartin "A" me datë 11/12/2006. Fleta lëshuese nga spitali e jepte diagnozën si në vijim *shqetësime akute, episode psikotike*, F23.8, ICD-10 e cila e përshkruan "çdo çrregullim tjetër të përcaktuar akut, psikotik, për të cilat nuk ka asnjë dëshmi të shkakut organik dhe që nuk e justifikon klasifikimin për F23.0-F23.3." Ai u trajtua me *Haldol* (antipsikotik), *Lorazepam* (hipnotik), dhe *Largactil* (antipsikotik) dhe përshkrimi i gjendjes së tij përfshinte; *pagjumësi, sjellje të çorganizuar, duke ndjekur idetë që kishin filluar para një muaji, si ndërjegje e konservuar, pamje e çorientuar e jashtme, ai duket i*

hutar, në ankth, kontakti verbal me vështirësi, jep përgjigje të pamjaftueshme brenda kontekstit të çështjes, raporti i papërshtatshëm emocional, ai nuk e di se si për të përshkruar gjendjen e tij, jep një perceptim të iluzioneve në të dëgjuar, të menduarit të çrregulluar me prezantimin e ideve iluzore për ndjekje dhe persekutim, ide të vetëvrasjes, të gjykuarit dhe memoria i janë të prekura, nuk është në dijeni të gjendjes së tij.¹⁷

Dy ekspertë, Dr. **L.** (i angazhuar nga Gjykata) dhe Dr. **R.** (i angazhuar nga Prokuroria), e kanë analizuar dokumentacionin mjekësor dhe provat e tjera në dispozicion dhe kanë dhënë dëshmi në lidhje me çështjen se nëse dokumentacioni mjekësor në dispozicion tregon ose jo se **A.Z.** ishte i prekur nga ndonjë problem mendor që ka mundur ta dëmtojë aftësinë e tij për të kujtuar dhe raportet e fakteve që datojnë që nga viti 1998/99.

- Dr. **L.** arriti në përfundimin se provat psikiatrike nuk kanë treguar asgjë që mund të ketë ndikuar në besueshmërinë e dëshmisë së **A.Z.** Nuk duhet kushtuar rëndësi gjendjes mendore të **A.Z.** në vlerësimin e kredibilitetit të tij (f. 84, 85).
- Dr. **R.** arriti në përfundimin se "nuk ka prova të sëmundjes së shëndetit mendor në përgjithësi, dhe, në veçanti, nuk ka prova për një gjendje që mund të prodhojë ndonjë dëmtim të rëndësishëm në ngjarjet e kujtuara të së kaluarës" (faqe 86).

Dr. Latham dhe Dr. Ramacciotti u pajtuan se ata nuk mund të përjashtojnë mundësinë se **A.Z.** thjesht ka gënjyer kur ai dha dëshmi.

Bazuar kryesisht në dëshminë e dhënë gjatë marrjes në pyetje dhe në provat e ekspertëve të parashikuar, Gjykata Themelore ka gjetur se është e mundur që **A.Z.** nuk ishte i sëmurë mendor në vitet 2005 dhe 2006, por se ai vetëm ka pretenduar të ketë simptomat e një sëmundjeje psikiatrike. Trupi Gjykues ka konstatuar se nëse apo jo **A.Z.** kishte një sëmundje mendore në vitet 2005 dhe 2006. Kur ai dha dëshmi në vitin 2009 dhe 2010, ai nuk kishte një çrregullim të njohur psikiatrik që mund të kenë ndikuar në aftësinë e tij për të dhënë dëshmi të saktë për ngjarjet në vitin 1999. Me fjalë të tjera, nuk ka indikacione se **A.Z.** ishte i sëmurë mendor në vitin 2009 dhe 2010. Më tej, trupi gjykues nuk gjeti prova se ai vuante nga ndonjë sëmundje psikiatrike, para vitit 2005.

Megjithatë, Paneli konkludoj se kur **A.Z.** dha dëshmi, ai tha se ai pretendonte ti ketë simptomat e një sëmundjeje psikiatrike në mënyrë që: (a) për të fryrë dëmet e pretenduara pas një aksidenti të

¹⁷ Gjykata Themelore në Prishtinë, Aktgjykimi i datës 17 shtator 2013, fq. 79 (faqet në Anglisht).

trafikut rrugor: (b) për të e siguruar veten me një mbrojtje të pjesshme për vrasjen e **F.L.**; (c) për të e diskredituar një deklaratë që ai tha se e kishte dhënë në KFOR.¹⁸

Në fund të fundit, Gjykata e Apelit ndan mendimin e konkluzionit të trupit gjykues se historia psikiatrike e **A.Z.** nuk ishte një çështje vendimtare në këtë rast. Edhe nëse mjekët që e kanë trajtuar **A.Z.** dhe ekspertët të cilët i kanë shqyrtuar raportet e tyre kishin rënë dakord se ai vuante nga psikozat të cilat potencialisht mund të kenë ndikuar në aftësinë e tij për të kujtuar me saktësi ngjarjet e mëparshme, kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht se dëshmia e tij nuk ishte e saktë. Trupi Gjykues ka konsideruar me një interes më të madh a) faktin se **A.Z.** mund të ketë imagjinuar ndonjë sëmundje dhe madje edhe më të madhe, dhe b) mospërputhjet e shumta faktike në dëshminë e tij.¹⁹

Prokurori pohon se analizat e gjykatës në lidhje me gjendjen mendore të **Z.** dhe "gënjeshtrat", janë plotësisht të gabuara, kanë ndikuar në vlerësimin e përgjithshëm të gjendjes faktike, dhe për këtë arsye e kanë njollosur tërë aktgjykimin. Nuk ka gënjeshtra. **Z.** kurrë nuk ka thënë gënjeshtra tek stafi i spitalit të Prizrenit për ndonjë gjë. Ai e tha të vërtetën kur tha se ai shkoi në KFOR. Ai e tha të vërtetën kur ai tha se ai u takua me hetuesit e UNMIK-ut. Ai e tha të vërtetën kur tha "pa dëshmi" ("asnjë deklaratë"), sepse nuk ka pasur deklaratë zyrtare të regjistruar nga UNMIK-u. Ai foli të vërtetën kur tha se ai thjesht u shti i sëmurë në Prishtinë, për shkak se dy ekspertë psikiatrik kanë konfirmuar se me të vërtetë ai nuk ishte i sëmurë mendërisht. Ai foli të vërtetën kur tha se kjo ishte e gjitha pjesë e planit të **L.**, për shkak se kjo është konfirmuar nga dy dëshmitarë të tjerë.²⁰

Gjykata e Apelit plotësisht pajtohet me Gjykatën Themelore dhe konstaton se nuk ka prova të mjaftueshme që provojnë se **A.Z.** ishte i sëmurë mendor gjatë hopsitalizimit të tij. Megjithatë, Paneli konkludon se në vitin 2006, **A.Z.** ka pretenduar të ketë simptomat e një sëmundje psikiatrike. Përfundimi është i bazuar në deklaratën gjatë marrjes në pyetje së cilës ai ju nënshtrua më 7 korrik 2011. Ku ai deklaroi:

*P. ... pranimi i 1-rë në spital ishte për të përgatitur mbrojtjen tuaj për vrasjen e **F.L.** apo të prodhojë një kërkesë për sigurimin. A është ashtu?*

*AZ. E para? Që të dyja janë të vërteta.*²¹

¹⁸ Gjykata Themelore në Prishtinë, aktgjykim, 17 shtator 2013, fq. 88 (faqet në Anglisht).

¹⁹ Gjykata Themelore në Prishtinë, aktgjykim, 17 shtator 2013, ibid.

²⁰ PSRK, ankesë, fq. 27.

²¹ PSRK, *Procesverbal nga dëshmitari bashkëpunues, Seanca Dëgjimore në Hetim, A.Z.*, 7 korrik 2011, fq. 35, pika 470.

A.Z. deklaroi se Hospitalizimi i dytë ishte "për të hedhur poshtë deklaratën time që dhashë tek KFOR-i"²².

Për më tepër, Gjykata e Apelit vëren se **A.Z.** u intervistua më 10 mars 2010. Ai dha dëshmi:

P. Në faqen 20 ju shkruat: "Isha në spitalin psikiatrik në Prizren, jo për tu rikuperuar, por për të marrë një vulë që unë jam i sëmurë si një justifikim, në rast se unë do e kisha vrarë F. Unë i kam thënë mjekut X.D., Shef i Departamentit të Psikiatrisë dhe mjekut të dhomës B.B. se unë jam në rrezik nga F.L. dhe banda e tij. "A mund të e shpjegoni më mirë?"

AZ. Është e vërtetë se menjëherë pas aksidentit me makinë që më ka ndodhur mua në Carralevë, unë isha aq i zemëruar që për shumë kohë e kam edhe konsideruar që ta vras F.. Unë kam qenë vazhdimisht nën kërcënime nga grupi i F.. Ai e kishte bërë jetën time të mjerë. Plus një mik i imi, Enveri nga Seniku (ai është një infermier në spital) më kishte këshilluar mua se nëse unë do shkoja në spital psikiatrik unë mund të merrja një certifikatë të sëmundjes dhe do merrja një kompensim më të lartë për aksidentin tim"²³.

Gjykata e Apelit konstaton se arsyet e hospitalizimit të dhëna nga **A.Z.** në mënyrë të qartë e kanë minuar besueshmërinë e tij. Ai e ka imagjinuar një sëmundje, si përgatitje për një kërkesë të kompensimit dhe për të diskredituar deklaratën e dhënë tek KFOR-i dhe UNMIK-u. Sjellja e tij jo e besueshme në lidhje me hospitalizimin, e ka zvogëluar besueshmërinë e tij. Kjo nuk është provuar nga ekspertët se ai kishte çrregullime psikiatrike, dhe ai nuk ishte i sëmurë mendor, por ne nuk mund të konsiderojmë se ai ishte në gjendje të mirë psikologjike në këtë kohë. Ai e konfirmoi gjatë marrjes në pyetje të tërthortë në vitin 2011 se në vitin 2006 ai kishte pretenduar të kenë simptomat e një sëmundje psikiatrike në mënyrë që ai: a) të rris një kërkesë për dëmet pas një aksidenti të trafikut rrugor; (b) për të ia siguruar vetes një mbrojtje të pjesshme për vrasjen e **F.L.**; (C) për të diskredituar një deklaratë që ai tha se e kishte dhënë në KFOR. Pranimi i tij se ka gënjer në vitin 2006 përfundimisht e ka zvogëluar besueshmërinë e tij, dhe vlerësimi i panelit të Shkallës së Parë në këtë pikë është absolutisht i saktë. Kur ne kemi një person i cili haptazi pranon në vitin 2011 se ai ka gënjer në vitin 2006 dhe ka pretenduar të jetë i sëmurë, atëherë kjo nuk mund të përdoret më si një provë e besueshmërisë së tij. Një deklaratë e tillë ul kredibilitetin e tij në vend të përcaktimit të së njëjtës.

²² PSRK, *Procesverbal nga dëshmitari bashkëpunues, Seanca Dëgjimore në Hetim, A.Z.*, 7 korrik 2011, fq. 35, pika 469.

²³ PSRK, *Procesverbal nga Seanca dëgjimore e të dyshuarit në një hetim, A.Z.*, 10 Mars 2010, fq. 7.

Në këtë pikë Kolegji i Apelit duhet të theksojë në mënyrë të hapur se Prokuroria ka bërë një gabim të dukshëm për të mos e siguruar praninë e psikologut në momentin e marrjes në pyetje të **A.Z.** (e cila në mënyrë korrekte është theksuar nga avokatët mbrojtës të **F.L.** në përgjigjen e tyre për ankesë). Ky dëshmitar ishte një person i cili, sipas përshkrimit mjekësor, vuante nga: pagjumësia, sjellja e çorganizuar, i çorientuar, në pamje të jashtme ai duket i hutuar i shqetësuar, kontakte verbale me vështirësi, jep përgjigje të pamjaftueshme brenda kontekstit të çështjes, raport i pamjaftueshme emocional... (Edhe në qoftë se ne nuk e kemi deklaratën se ky person është i sëmurë mentalisht, do të ishte jashtëzakonisht e dobishme për Gjykatën që të ketë pasur një vlerësim nga një psikolog i cili do të kishte qenë i pranishëm gjatë marrjes së tij në pyetje). Ky mendim do të i kishte ofruar gjykatës një përshkrim psikologjik në lidhje me reagimin e personit të pyetur, një përshkrim të gjendjes së tij të ndjenjave, sjelljes së tij, zërin e tij etj, e cila, nga ana tjetër, do të e kishte mbështetur Gjykatën në vlerësimin e besueshmërisë së dëshmitarit në të gjitha aspektet e dëshmisë së tij. Pasi që kjo nuk është bërë, Gjykata vetëm mund të e bazojë vlerësimin e saj vetëm në regjistrimin e këtyre dëshmive dhe deklaratave. Gjykata e Apelit është e mendimit se Kolegji i Shkallës së Parë ka vlerësuar dhe e ka arsyetuar gjendjen e tij mendore, kështu që edhe në qoftë se Prokuroria do e paraqesë të sajën, dhe duke e kundërshtuar interpretimin e kësaj çështjeje, ajo nuk është e mjaftueshme për të kundërshtuar arsyetimin e Panelit të Gjykatës Themelore.

(3.2) Deklarata e A.Z.'t për ta vrarë F.L.

Gjykata e Apelit konstaton se **A.Z.** nuk është i besueshëm pasi ai kishte motive personale për **F.L.** që të ndëshkohej. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje më 7 korrik 2011 **A.Z.** ka dhënë këto përgjigje:

P. Ju i keni thënë PP-së kur jeni pyetur “përse keni ardhur në EULEX”. Ju keni thënë “për ta thënë të vërtetën”. E mbani në mend ta keni thënë këtë?

AZ. Po.

P. Në qoftë se kjo është arsyeja që ju erdhët për ta dhënë versionin tuaj, kur ju lindi kjo dëshirë e re për ta treguar të vërtetën?

AZ. Nga momenti që kam hequr dorë nga ideja për ta vrarë **F.**, unë e kam dorëzuar armën time, unë ishta i paarmatosur dhe pasi gjithmonë kam menduar për të arritur një fund me anë të një marrëveshjeje.²⁴

Gjatë marrjes në pyetje në mënyrë të tërthortë të bërë nga Karim Khan për përfshirjen e pretenduar të **F.L.**, **A.Z.** u përgjigj:

P. Pra, herën e parë që shkuat në spital ishte për të përgatitur një mbrojtje për vrasjen e **L.**, a është ashtu?

AZ. Po.

P. Dhe ju thatë që keni tentuar shumë here për ta vrarë **F.L.**?

AZ. Nuk kam tentuar. Kam menduar për këtë gjë.

P. Unë jam duke shikuar në faqen 8 të intervistës të datës 10 mars 2010. PP lexon një nga deklaratat tuaja të mëparshme. PP është duke u përpjekur për të gjetur të vërtetën. Ai lexon se ju thatë që "Unë gjithashtu u përpoqa disa herë për të shkuar dhe për të vrarë **F.**". Kjo është ajo që keni shkruar, a është ashtu?

AZ. Kam menduar për këtë gjë.

Q. Ne do të vijmë tek mendimet tuaja më vonë. Unë tani jam duke thënë atë që shkruat: "Unë gjithashtu u përpoqa disa herë për të shkuar dhe për ta vrarë **F.**". A është kështu?

AZ. Çka është shkruar aty, është aty. Unë nuk e mohoj, por ishte gabimi im. Në qoftë se unë të kisha dashur për ta vrarë unë do e kisha bërë atë gjë.

Q. Ne po flasim për ditarin tuaj. Ju e pranoni se keni shkruar "Unë gjithashtu u përpoqa disa herë për të shkuar dhe për ta vrarë **F.**" në ditarin tuaj?

AZ. Unë e pranoj të kem shkruar çdo gjë që kam shkruar, por unë kurrë nuk u përpoqa që ta vrisja.²⁵

Me 10 mars 2010, **A.Z.** është intervistuar dhe ka dhënë përgjigjet si në vijim:

²⁴ PSRK-ja, procesverbal i dëshmitarit bashkëpunues, Seanca dëgjimore në një hetim, **A.Z.**, 7 korrik 2011, f. 24, pika 327 dhe 328.

²⁵ PSRK-ja, procesverbal i dëshmitarit bashkëpunues, Seanca dëgjimore në një hetim, **A.Z.**, 7 korrik 2011, fq. 22, pikat 302-307.

P. ... në faqen 20 ju shkruat: "Isha në spitalin psikiatrik në Prizren jo që të rikuperohem, por për të marrë një vulë që unë jam i sëmurë si një justifikim, në rast se unë do e vras **F.** I thashë mjekut Xhemajl Dana, Shef i Departamentit të Psikiatrisë dhe mjekut të dhomës **B.B.** se unë jam në rrezik nga **F.L.** dhe banda e tij. "A mund ta shpjegoni më mirë?"

AZ. Është e vërtetë se menjëherë pas aksidentit me makinë që më ka ndodhur mua në Carralevë, isha aq i zemëruar që për shumë kohë edhe e kam konsideruar që ta vras **F.** Unë kam qenë vazhdimisht nën kërcënime nga grupi i **F.**. Ai e kishte bërë jetën time të mjerë.

Plus një mik i imi, **E.** nga Seniku (ai është një infermier në spital) më kishte këshilluar mua se nëse unë do shkoja në spital psikiatrik unë mund të merrja një certifikatë të sëmundjes dhe do merrja një kompensim më të lartë për aksidentin tim.

AZ. Megjithatë, unë më vonë e rishqyrtova qëllimin tim dhe vendosa për të shkuar në vend të kësaj tek KFOR-i, të dorëzoja armën time, dhe të ua tregoja atyre tregimin tim duke e raportuar **F.** dhe grupin e tij.

P. Në faqen 30 ju keni shkruar "Unë gjithashtu u përpoqa disa herë për të shkuar dhe për ta vrarë **F.**". A jeni përpjekur ju në të vërtetë për ta vrarë atë?"

AZ. Jo, ajo ishte vetëm një ide, por unë kurrë nuk kam filluar të planifikoj vrasjen e mundshme.²⁶

Pas një vlerësimi të kujdesshëm të provave, Gjykata e Apelit konstaton se **A.Z.** nuk është i besueshëm pasi që ai kërkoi hakmarrje dhe më pas ka pastruar ndërgjegjen e tij. Ai pranoi që ka pasur synimin për të vrarë **F.L.** Kjo do të thotë se ai kishte motive të qarta për të falsifikuar dëshmitë e tij dhe për të diskredituar të pandehurit dhe posaçërisht **F.L.** Nëse dikush mendon vrasjen e një personi tjetër dhe e deklaron atë, një person i tillë mund të dëshmojë lehtësisht rrejshëm kundër atij personi (armikun e tij të dyshuar) vetëm për të e ngarkuar atë dhe për ta parë atë të dënuar penalisht. Sipas mendimit të Kolegjit të Apelit ky vlerësim i Gjykatës së shkallës së parë është i saktë, dhe ajo është e bazuar në pjesë të tjera të provave të mbledhura në dosjen e lëndës. Përfshin raportin e **A.Z.** të aksidentit të tij me makinë, ku nuk ka asnjë gjurmë fare në përfshirjen e **L.**, por **A.Z.** vazhdimisht ka pohuar se **L.** ishte organizatori i kësaj ngjarje.

²⁶ PSRK-ja, procesverbal i dëshmitarit bashkëpunues, Seanca dëgjimore në një hetim, **A.Z.**, 10 mars 2010, fq. 7 dhe 8.

(3.3) Aksidentet automobilistike.

A.Z. dha dëshmi për aksidentet e trafikut rrugor për të cilat ai pohoi se ishin orkestruar nga **F.L.**, në mënyrë për ta heshtur atë. Në veçanti, këto aksidente janë si vijon: gjatë marrjes në pyetje në mënyrë të tërthortë të **A.Z.** me 7 korrik 2011 ku ai dëshmoi se në vitin 2005 vajza e tij ishte e përfshirë në një aksident me makinë, ai pranoi se pas atij aksidenti, dhe për shkak se ai mendonte se ishte bërë qëllimisht, ai u shpërngul nga shtëpia e tij. Ai ishte i bindur se vajza e tij kishte qenë në shënjestër me qëllim dhe se **F.L.** fshihej pas aksidentit.²⁷

Për më tepër, **A.Z.** ishte i përfshirë në aksidentet si në vijim:

Më 24 nëntor 2005, **A.Z.** ishte duke e vozitur veturën e tij në Shtime, kur ai u përplas me një automjet tjetër të drejtuar nga **S.F.** Policia arriti në vendin e ngjarjes, dhe sipas raportit të policisë, shoferi pala e tretë, ishte përgjegjës për aksidentin me makinë.

Më 28 tetor 2006, **A.Z.** ishte duke e vozitur veturën e tij në Prizren, kur ai kishte një përplasje me një automjet tjetër. Policia arriti në vendin e ngjarjes. Policia e mbajti **A.Z.** përgjegjës për aksidentin.

Më 3 tetor 2007 **A.Z.** kishte edhe një aksident tjetër me makinë kur ngiste automjetin e tij në Komoran. Ai kishte një përplasje me një automjet që vozitej nga **B.S.** Policia arriti në vendin e ngjarjes. Raporti i policisë shihej se mbante palën e tretë përgjegjëse për aksidentin me makinë.

A.Z. u pyet në lidhje me një aksident të mëtejshëm, kur automjeti i tij u godit nga një kamion.

Ai besonte se **F.L.** ishte pas të gjitha këtyre aksidenteve me qëllim për ta kërcënuar dhe heshtur atë. Megjithatë, ai pranoi se në dy raste, drejtuesit e automjeteve kishin pritur për ardhjen e policisë. Ata kishin folur me Policinë, të cilët i kishin regjistruar të dhënat e tyre personale.

Gjykata Themelore në mënyrë shumë të saktë ka arritur në përfundimin se nuk kishte prova se **F.L.** apo ndonjë nga të pandehurit ishin të përfshirë në ose përgjegjës për aksidentet.

Gjykata e Apelit konstaton se është provuar që **A.Z.** ishte i përfshirë në një numër të aksidenteve rrugore. Megjithatë, nuk ka dëshmi se **F.L.**, ose një nga të pandehurit ishin të përfshirë në ose përgjegjës për këto aksidente. Paneli thekson se në bazë të raporteve të Policisë në të gjitha rastet, ngasësit e makinës d.m.th. pala e tretë, i kanë shkaktuar këto aksidente (përpos një). Në të gjitha rastet, shoferi do të thotë pala e tretë, ka pritur për ardhjen e Policisë dhe ka bashkëpunuar. Nuk ka të ngjarë që pala e tretë, ngasësi i makinës, ta ketë shkaktuar qëllimisht aksidentin dhe

²⁷ PSRK-ja, procesverbal i dëshmitarit bashkëpunues, Seanca dëgjimore në një hetim, **A.Z.**, 7 korrik 2011, faqe18.

pastaj të bashkëpunojë me Policinë. Kryerësi i cili ishte udhëzuar nga të akuzuarit për të përfshirë **A.Z.** në një aksident me makinë do të e kishte braktisur vendin në mënyrë të fshehur. Por, nuk ndodhi kështu. Duket se **A.Z.** vërtetë ka besuar dhe, çka është më e rëndësishme, haptazi deklaroi se **F.L.** ishte pas aksidenteve rrugore. Megjithatë, ne jemi të vetëdijshëm se, në të paktën një rast, më 28 tetor 2006, policia u shfaq për ta konstatuar **A.Z.** përgjegjës për aksidentin. Si rezultat i kësaj, kjo patjetër e zvogëlon besueshmërinë e tij. Ky ishte një supozim personal apo përshtypje, por gjithashtu është dëshmi se ai kishte gënjyer dhe se ai ishte i gatshëm për të fajësuar **L.** për çdo gabim me të cilën ai u përball.

(3.4) Deklaratat në KFOR/UNMIK.

Prokurori parashtroi se Gjykata Themelore i ka dhënë një rëndësi vendimtare tre faktorëve të mëposhtëm:

- Një shënim në ditar bërë nga **A.Z.** më 24 nëntor 2006 ku i referohet kontakteve të tija me KFOR-in dhe UN-in; e njëjta hyrje thotë "Pa dëshmi" përkthehet fjalë për fjalë si "pa dëshmi / prova"; vetëm interpretimi logjik i kësaj fjalisë, është se ai nuk ka dhënë një deklaratë - me shkrim ose me gojë. Në përfundim, ditari i vetë **Z.** e kundërshton dëshminë e tij më vonë se ai kishte zbuluar gjithçka dhe kjo ishte arsyeja për hospitalizimin e tij më vonë;
- KFOR konfirmoi se **A.Z.** kurrë nuk kishte dhënë ndonjë deklaratë gjatë periudhës 24-30 nëntor 2006;
- Edhe UNMIK-u dhe ICTY konfirmuan se **A.Z.** nuk kishte dhënë asnjë deklaratë gjatë periudhës përkatëse.

Gjykata vazhdon me arsyetimin e saj si më poshtë: "*... në qoftë se **Z.** ka dhënë një deklaratë me gojë, (A)*" është e pamundur që ai do të e kishte shtruar veten në një spital psikiatrik në mënyrë për të e diskredituar atë. Ai thjeshtë do e kishte mohuar... ". (B) Hetuesit për krime lufte do të e dokumentonin në një farë mënyre përmbajtjen e deklaratës.²⁸

Sipas Prokurorisë **A.Z.** ka dhënë dëshmi në rastet që; a) ai e paralajmëroi **F.L.** për qëllimin e tij për të raportuar "gjithçka" tek KFOR-i; b) menjëherë pas kësaj, ai me të vërtetë shkoi tek KFOR-i në Prizren; c) aty, ai e dorëzoi armën e tij dhe një granatë dore; d) ai i tha KFOR-it në lidhje me krimet e luftës të kryera nga **F.L.** dhe të tjerët; e) në atë pikë KFOR e dërgoi atë në UNMIK; f)

²⁸ PSRK, Ankesë, faqe 24.

disa ditë më vonë, ai u takua me **F.L., Z.** u shtrua në spital dhe u vendos për të diskredituar deklaratën e tij.

Prokurori i referohet një letre të datës 03/09/2013 në të cilën KFOR-i konfirmoi pikërisht atë që e tha **A.Z.** Domethënë se më 24 nëntor 2006 **Z.** vizitoi KFOR-in në Prizren, ai u dorëzoi një armë zjarri, ai e informoi KFOR-in se ai kishte një granatë dore, dhe u dorëzua më vonë tek njësia për krime lufte në Prishtinë. Në të vërtetë, dëshmia e **Z.** është vërtetuar plotësisht nga letra e përmendur më lartë e KFOR-it e datës 03/09/2013, e cila raporton pikërisht të njëjtën sekuençë të ngjarjeve të transmetuar nga **Z.**

Prokurori pohon se në fakt Gjykata Themelore plotësisht dështoi që ti rindërtoj ngjarjet. Gjykata mendon se në shënimin në ditar "nuk ka dëshmi" tregon se **Z.** nuk ka dhënë ndonjë deklaratë tek KFOR-i dhe se e gjithë historia nuk është e besueshme. Kjo do të konfirmohet nga informacionet e marra nga KFOR-i dhe UNMIK-u, se nuk ka gjurmë të një deklarate të dhënë nga **Z.** KFOR-i nuk është agjenci hetimore dhe për këtë arsye nuk merr ndonjë të dhënë në lidhje me deklaratat. Prandaj, **Z.** i është dorëzuar UNMIK-ut. Fakti që, sipas UNMIK-ut nuk ka të dhëna për një deklaratë vetëm tregon se dëshmitari nuk ka dhënë një deklaratë zyrtare me shkrim.

Në këtë kontekst, Prokuroria i referohet një raporti të panënshkruar të policisë të datës 25/11/2006 e cila dëshmon takimin në mes të UNMIK-ut dhe **Z.** Sipas Prokurorisë raporti përputhet pikërisht me atë që është transmetuar nga vetë **Z.** Sipas raportit të policisë së UNMIK-ut:

- **Z.** është transferuar nga KFOR-i në UNMIK në ora 23:55 me datë 24 nëntor 2006;
- **Z.** ka deklaruar më herët atë ditë, para se të shkojë tek KFOR-i, ai e kishte thirrur **L.** dhe e kishte informuar atë se ai do të shkonte në KFOR dhe do tu tregonte atyre "gjithçka";
- **Z.** vërtetë shkoi në KFOR dhe dha një deklaratë me gojë;
- KFOR-i e përcolli **Z.** tek hetuesit për krime lufte në Prishtinë;
- UNMIK-u propozoi për të e regjistruar deklaratën e tij në një diktograf;
- **Z.** nuk pranoi të japë një deklaratë në këtë mënyrë, duke thënë se ai donte për të dhënë një deklaratë publike;
- Në fund, asnjë deklaratë nuk është regjistruar.

Një hetues i UNMIK-ut i quajtur Sasha e ka kontaktuar **Z.** për një takim vijues. Ata ranë dakord të takohen, por kurrë nuk u takuan për shkak të faktit se **Z.** shkoi në spitalin psikiatrik para se takimi të mund të bëhej. Raporti i UNMIK-ut tregon se Gjykata Themelore gaboi kur dha konkludimin se ai e shpiku të gjithë historinë. Përkundrazi, raporti tregon se **Z.** e ka thënë të vërtetën.

Në lidhje me shtrimin në spital, Gjykata Themelore është marrë me deklaratën e KFOR-it në faqet 120-123 të aktgjykimit të kundërshtuar. Trupi Gjykues theksoi se kur **Z.** u intervistua nga policia më 16 dhe 17 korrik 2007, ai iu referua në mënyrë të përsëritur deklaratës që ai tha se e kishte dhënë në KFOR, siq duket në vitin 2006. Ai iu referua deklaratës së tij të KFOR-it në raste të tjera, duke përfshirë 16 mars 2010 dhe 7 korrik 2011. Në secilin rast ai deklaroi se kishte treguar të vërtetën.

Në deklaratën e tij të dhënë në polici më 16 korrik 2007, **Z.** tha se **F.L.** e kishte pyetur atë se sa para ai donte për të e "tërheqë deklaratën e dhënë në KFOR". Gjatë intervistës më 16 mars 2010, ai tha se ai i tha **F.L.** se ai "donte të shkonte tek KFOR-it në mënyrë që ti "raportoje ata". Ai tha se **F.L.** ka insistuar që ata të takohen për të e diskutuar "çështjen". Ai tha se gjatë atij takimi **F.L.** i tha atij se ai duhej që të shkonte në spital psikiatrik, duke thënë se kjo ishte e vetmja mënyrë për të diskredituar historinë që ai ia tha KFOR-it. Ai tha se është "dashur" të shkojë në spital një ditë pas takimit.

Gjykata Themelore e përcaktoi konkludimin e vet në faktin se **A.Z.** kurrë nuk ka dhënë një deklaratë në KFOR dhe kishte gënjyer (f. 120-123). Përveç kësaj, në faqen 133, në aktgjykimin e saj, Gjykata Themelore konkludoj se **A.Z.** kishte gënjyer kur ai dëshmoi se ai ia kishte thënë KFOR-it "historinë e plotë". Gjykata Themelore ka konstatuar se ai kurrë nuk e kishte dhënë një deklaratë në KFOR.

Para së gjithash, Gjykata e Apelit vëren se provat e paraqitura rishtazi - Raporti i UNMIK-ut i datës 25/11/2006 - refuzohet si provë pasi që nuk është treguar apo dhënë një arsye e fortë në lidhje me faktin se pse këto dokumente nuk janë paraqitur në gjykim. Shqyrtimi kryesor "i dytë" ka filluar në prill të vitit 2013 dhe vazhdoi deri në shtator të vitit 2013 - andaj më shumë se 6 muaj. Kjo periudhë kohe ka qenë kohë e mjaftueshme për të paraqitur të gjitha pjesët e provave të cilat janë konsideruar nga palët si të rëndësishme. Prokurori është i detyruar të i japi arsyet se pse ai nuk ishte në gjendje të paraqesë provat në gjykimin e shkallës së parë. Pasi që prokurori ka paraqitur tashmë provat në Gjykatën e Apelit, pa ndonjë arsye të mjaftueshme, Gjykata e Apelit nuk mund ta konsiderojë atë si provë të re.

Në këtë pikë, megjithatë, pa një analizë të detajuar të këtij dokumenti duhet të theksohet se kjo dëshmi është e një rëndësie të vogël për vlerësimin e përgjithshëm të kredibilitetit të **A.Z.** Ajo që është përcaktuar tashmë, dhe ajo që është konfirmuar nga Gjykata e Shkallës së Parë dhe Prokurorisë në ankesën e saj, është se nuk ka pasur asnjë deklaratë apo dëshmi ("Pa dëshmi"). Kjo do të thotë se **A.Z.** nuk ka paraqitur asnjë deklaratë me gojë ose me shkrim e cila do të mund të përdoret direkt në gjykim nga secila gjykatë (Gjykata e Qarkut apo Gjykata e Apelit). Ajo që ne kemi është konfirmim i tërthortë se më 24 nëntor të vitit 2006 ai e vizitoi KFOR-in në Prizren,

ai ka dorëzuar një armë zjarri, ai e informoi KFOR-in se ai e kishte një granatë dore, dhe ai iu dorëzua më pas njësisë së krimeve të luftës në Prishtinë. Kjo pjesë e deklaratës së tij, mund të konsiderohet si e besueshme, por ajo nuk ka ndryshuar asgjë në lidhje me pasqyrën e përgjithshme të besueshmërisë së tij pasi nuk kemi ndonjë deklaratë apo dëshmi (dokumente të nënshkruara prej tij) që ishin dhënë më parë tek një autoritet zyrtar, dhe e cila mund të përdoret në gjykim, dhe e cila është e lidhur disi me akuzat në aktakuzë.

Gjykata e Apelit dëshiron të theksojë një çështje tjetër që duket se ka kaluar pa u vënë re nga asnjëra prej palëve në këto procedura gjyqësore. Sipas raportit të Policisë së UNMIK-ut, **Z.** nuk pranoi të japë një deklaratë në këtë mënyrë, duke thënë se ai donte për të dhënë një deklaratë publike. Pse e bëri ai këtë? Ai ishte në stacionin e Policisë së UNMIK-ut (një organizatë ndërkombëtare dhe një vend shumë i sigurtë), dhe ai nuk ishte nën presion apo në frikë prej askujt. Ai mund të thoshte gjithçka, por ai nuk ka dashur - ai ishte duke pritur për "një deklaratë publike". A është kjo sjellja e personit të besueshëm, i cili më parë ka deklaruar se është sulmuar dhe frikësuar nga personat (**L.** dhe/ose prej të pandehurve të tjerë) të cilët mund të kenë të drejtë të jenë të pranishëm ose, të paktën, të informuar, në lidhje me këtë veprim ligjor? E vetmja përgjigje e mundshme është "JO". Rezultati i këtij takimi ishte "asnjë deklaratë nuk është regjistruar", që do të thotë se asnjë material provash nuk është mbledhur të cilat do të mund të përdreshin në një gjykim penal. Ky qëndrim i **Z.**, dhe hezitimi i tij për të dhënë një deklaratë tek një autoritet i pavarur ndërkombëtar, patjetër, sipas mendimit të Kolegjit të Apelit, e zvogëlon besueshmërinë e tij. Kjo gjithashtu do të thotë se deklarata e Gjykatës Themelore se **A.Z.** nuk ishte një dëshmitar i besueshëm ose kredibil është e saktë dhe duhet të konfirmohet, pavarësisht gjetjeve të mangëta materiale (trupi gjykues iu qas Zyrës Kryesore të NATO-s në Prishtinë, dhe Shefi i LEGAD u përgjigj se nuk ekziston asnjë raport në bazën e të dhënave të NATO-s, por se KFOR-i në Prizren është një kamp ushtarak gjerman dhe nuk është një kamp i NATO-s).

(3.5) Deklaratat e ICTY-së (Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë).

Gjykata Themelore erdhi në përfundimin se dëshmitari bashkëpunues **A.Z.** kishte gënjyer në lidhje me deklaratat që pretendohet se **F.L.** dhe **I.M.** ja kishin dhënë Tribunalit të Hagës. Trupi Gjykues mendon se **F.L.** dhe **I.M.** nuk kanë dhënë ndonjë deklaratë në ICTY (Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë).²⁹

²⁹ Gjykata Themelore e Prishtinës, Aktgjykim, 17 shtator 2013, fq. 124.

Gjykata e Apelit vë në dukje se kur **A.Z.** ishte marrë në pyetje në mënyrë të tërthortë, më 7 korrik 2011, ai dëshmoi: “Unë vetëm e kam lexuar të **B.**, të gjithë të tjerat ishin aty”.³⁰

Me 17 shkurt 2010 **A.Z.** tha:

*Demiri solli me vete një kopje të deklaratave që **F.**, **B.** dhe **M.** ia kishin dhënë Tribunalit (ICTY). Ai më tha që ti lexoj ato dhe për të përgatitur versionin tim të fakteve në rast se unë arrestohem.*³¹

Gjatë marrjes në pyetje në mënyrë të tërthortë më 7 korrik 2011, **A.Z.** ka dhënë dëshmitë e mëposhtme në përgjigje të pyetjeve të Karim Khan:

P. A i keni lexuar ato deklaratat?

AZ. I kam lexuar.

P. Ato janë marrë nga hetuesit e Tribunalit, janë incizuar?

AZ. Nuk e di. Nuk kam njohuri se kush e ka bërë këtë.

P. Ju i keni parë deklaratat e tuaja apo jo, thotë se në këtë datë, në këtë vend, i cili është i pranishëm, prokurori është këtu, dhe shpesh është një deklaratë se kjo deklaratë e përbërë nga 10 faqe, për shembull është e vërtetë dhe unë e e jap atë duke besuar se është e vërtetë. Ti e di se për çfarë jam duke folur unë, apo jo? Një deklaratë zyrtare ka ardhur 14 herë në këtë prokurori?

AZ. Unë e kuptoj se çfarë jeni duke thënë por unë nuk e kam shikuar rëndësinë e atyre deklaratave.

P. A i keni lexuar deklaratat?

AZ. E Kam lexuar pjesën e saj e cila ka të bëjë me mua, në mënyrë se si të sillem në qoftë se shkoj në Hagë.

P. Le të shkojmë hap pas hapi. Ju thoni se këto ishin deklaratat që këta tre individë ia kanë dhënë Tribunalit, a është e saktë?

AZ. Një sqarim- unë vetëm e kam marrë deklaratën e **H.** të cilën është dashur që ta lexoj.

P. Ju thoni që ju u është thënë që ti lexoni deklaratat, a janë lënë ato me ju?

³⁰ PSRK-ja, procesverbal i dëshmitarit bashkëpunues, Seanca dëgjimore në një hetim, **A.Z.**, 7 korrik 2011, fq. 30.

³¹ fq. 5 A137.

AZ. *Ata i kanë marrë ato.*

P. *Dhe kështu që ju thoni që Demiri i cili u kërcënon ju, vjen në shtëpinë tuaj me tre deklarata dhe thotë që ti lexoni ato? A i keni lexuar që të tria apo nuk i keni lexuar?*

AZ. *Jo. Vetëm të H. 'it.*

P. *A i keni parë ju fizikisht deklaratat e tjera; ju vetëm e keni lexuar atë të B., apo jo?*

AZ. *Unë vetëm e kam lexuar të B. Të gjitha të tjerat kanë qenë aty.*

P. *A jeni ju të vetëdijshëm se F.L., I.M. dhe H.B. nuk kanë dhënë deklarata për Tribunalin e Hagës?*

AZ. *Jo nuk e di.*

P. *Ata nuk kanë pranuar që të intervistohen, a e keni ditur ju këtë gjë?*

AZ. *Nuk e kam ditur.*

P. *Kështu që unë ua paraqes ju edhe një dëshmi se kjo ngjarje është e fabrikuar se nuk ka deklarata të tilla që ekzistojnë. Ju jeni duke trilluar, apo jo Zotëri?*

AZ. *Për mua ato kanë ekzistuar dhe në bazë të kësaj unë e kam dhënë deklaratën time në Tribunalin e Hagës.*³²

Sipas mendimit të Gjykatës së Apelit është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se **H.B.** dha një deklaratë për hetuesit e Tribunalit të Hagës (ICTY). Në Aktgjykimin e Tribunalit, Prokurori kundër **L., B., M.**, Trupi gjykues ju referua një mocioni për të përjashtuar një deklaratë të dhënë nga Haradin Balaj për një hetues me OTP-në gjatë një interviste me datë 17 shkurt 2003.³³

Kolegji gjithashtu thekson se nga Aktgjykimi, është gjithashtu e qartë se i akuzuari **M.** ka parashtruar një njoftim mbi alibinë me datë 1 mars 2005.³⁴ Për më tepër, mbrojtja për **F.L.** ka parashtruar një mocion me datë 5 shtator 2005 për lirimin e përkohshëm të të akuzuarit, në pritje

³² PSRK-ja, procesverbal i dëshmitarit bashkëpunues, Seanca dëgjimore në një hetim, **A.Z.**, 7 korrik 2011, fq. 29 dhe 30.

³³ ICTY (Tribunali), *Prokurori kundër. Limaj, Bala, Musliu*, Aktgjykimi, 30 nëntor 2005, para. 769; Vendimi mbi mocionin e mbrojtjes për të përjashtuar deklaratat e bëra nga Haradin Bala në intervistën e datës 17 shkurt 2003, 17 nëntor 2004.

³⁴ ICTY (Tribunali), *Prokurori kundër. Limaj, Bala, Musliu*, Aktgjykimi, 30 nëntor 2005, para. 770; Njoftim mbi alibinë e **I.M.** dorëzuar në bazë të rregullores 67(A) (i) (a), 1 mars 2005.

të aktgjykimit ose për një periudhë më të shkurtër, ashtu siq trupi gjykues do e shohë të arsyeshme.³⁵

Në përfundim, Gjykata e Apelit konstaton se Gjykata Themelore pjesërisht ka gabuar në vlerësimin negativ të dëshmisë së **A.Z.** se ai i lexoi deklaratat e Balajt para Tribunalit të Hagës, për shkak se **H.B.** ka dhënë një deklaratë në Tribunal (ICTY) dhe sepse **A.Z.** ka konfirmuar se ai e ka lexuar atë deklaratë specifike. Ky gabim, megjithatë, nuk mund të ndryshojë vlerësimin e saktë të Gjykatës së shkallës së parë në lidhje me deklaratat e **M.** dhe **F.L.** të cilat thjesht nuk ekzistojnë. Më 7 korrik 2011 ai shprehimisht dëshmoi: "Unë vetëm e kam lexuar atë të Balës, të gjitha të tjerat ishin aty" dhe me 17 shkurt 2010 ai ka thënë: "... një kopje e deklaratave që **F., B.** dhe **M.** ia kishin dhënë Tribunalit (ICTY) ". Ai nuk ishte duke folur në lidhje me një deklaratë, por në lidhje me deklaratat (shumës), me tregues se këto ishin nga **L.** dhe **M.** Fakti që të dy të akuzuarit nuk pranuan që të japin asnjë deklaratë në Tribunal (ICTY), është një dëshmi se **A.Z.** nuk ishte në gjendje për t'i parë ato dhe se ai kishte thjesht kishte gënjyer në lidhje me këtë çështje. Në përfundim, Kolegji i Ankesave konsideron se **A.Z.**, është pjesërisht jo i besueshëm dhe jo kredibil në lidhje me deklaratat e "Tribunalit".

(3.6) Përfundim rreth kredibilitetit të A.Z.

Në bazë të asaj që u tha më sipër, Gjykata e Apelit plotësisht pajtohet me gjetjet e Gjykatës Themelore dhe konstaton se provat që **A.Z.** i ka dhënë janë të paqëndrueshme dhe ndjeshëm në kundërshtim nga prova të tjera. Prandaj, Gjykata e Apelit ka arsye të forta për të i konsideruar deklaratat e tija si jo të besueshme dhe jo kredibile. Në kuadër të asaj që u tha më lartë, është provuar se **A.Z.** nuk ishte i besueshëm si një dëshmitar dhe i cili ka ofruar shumë fakte të cilat nuk janë konfirmuar nga pjesë të tjera të provave. Kur ai dha dëshmi në periudhën 2009-2011 ai tha gënjeshtër për sa i përket hospitalizimit të tij në vitin 2006. Sëmundja që ai pretendonte ta kishte në vitin 2006, është një argument shumë i fortë për të supozuar se ai nuk është i besueshëm/ është i dyshimtë/i pasigurtë në lidhje me deklaratat që ai i ka dhënë në mes të viteve 2009-2011, si dhe në lidhje me dëshminë e tij në lidhje me aksidentet e makinave, dhe deklaratat e Tribunalit (ICTY) fuqishëm e mbështesin dhe e konfirmojnë këtë lloj arsyetimi. Është e qartë se **A.Z.** kishte motive të tija personale për **F.L.** dhe të pandehurit e tjerë të dënuar, e cila, si pasojë, i bën deklaratat e tij jo të besueshme/ të dyshimta/ të pasigurta.

³⁵ ICTY (Tribunali), Prokurori kundër. Limaj, Bala, Musliu, Aktgjykimi, 30 nëntor 2005, para. 775; Mbrojtja e ka përsëritur mocionin për lirimin e përkohshëm të **F.L.**, 5 shtator 2005.

Gjykata e Apelit nuk është gjykatë e shkallës së parë, kështu që nuk do të e analizojë çdo kontradiktë në mes të versionit të **A.Z.** dhe dëshmive të tjera të Prokurorisë. Kjo është bërë në mënyrë korrekte nga Paneli i Shkallës së Parë si dhe nga avokati mbrojtës në emër të **F.L.** në 14 faqet e fundit të përgjigjes së tyre ndaj Ankesës së Prokurorisë. Duke pasur parasysh si më sipër, Kolegji i Apelit konkludon se **A.Z.** nuk është plotësisht i besueshëm si dëshmitar. Një vlerësim i mëtejshëm i deklaratave të tija është elaboruar në pikat e mëposhtme.

(4) Besueshmëria e Ditarëve të A.Z.

Prokuroria argumenton se Trupi Gjykses ia ka bashkangjitur ditarit, jetën e vet, të pavarur nga dëshmia e autorit të saj, i cili nga pikëpamja e Prokurorit ishte një gabim i qartë. Çfarë **A.Z.** ka shkruar janë shënimet e tija personale. Duke i konsideruar në veçanti, ato kanë një vlerë jashtëzakonisht të ulët provuese. Asnjë akuzë e vetme në aktakuzë nuk është e bazuar tërësisht nga shënimet e ditarit. Provat e krimeve vijnë tërësisht nga kujtesa **Z.** dhe dëshmitë, e jo nga ditarët.

Pavarësisht gjendjes së qartë faktike, Paneli e ka bazuar tërë analizën e saj në atë të cilën ata pa dallim e kanë quajtur "ditar" ose "ditarët" mbi supozime tërësisht të gabuara. Prokuroria thekson se ata kurrë nuk kanë theksuar se shënimet në ditar ishin shkruar nga **A.Z.**

Prokurori vëren se në fazën e hershme të hetimeve **A.Z.** u ka dhënë hetuesve një grumbull të dokumenteve të llojeve të ndryshme, formës dhe natyrës. Ato ishin të etiketuara me numrat 0096/09 /EWC2 /0001 gjer në /036, dhe edhe të shtypura edhe të shkruara me dorë. Policia dhe Prokurori e kanë marrë në pyetje **A.Z.** në lidhje me një pjesë shumë të kufizuar të këtij vëllimi masiv të dokumenteve. Ai iu bë në thëllësi pyetje në lidhje me vetëm dy prej këtyre ditarëve, dhe atë: numrat /011 dhe /012. Ato përmbajnë emrat e të burgosurve të paraburgosur në burgun e Kleçkës. **Z.** pohoi se ai i kishte shkruar ato, dhe një ekspert i pavarur grafologjie ka konfirmuar se kjo ishte e vërtetë. **Z.** kurrë nuk pohoi se ai e shkroi tërësinë e dokumenteve nga /0001 gjer /036. Prokuroria nuk i kërkoi atij që ta konfirmojë apo që ta mohojë këtë, dhe as nuk e kanë kërkuar këtë në aktakuzë, ose në shqyrtim.

Prokurori vë në dukje se Gjykata, në faqen 73 të aktgjykimit (dhe gjetiu) i është referuar kuotës së **A.Z.:** *Unë kam qenë duke marrë shënime, por ato ishin shënimet e mia personale. Askush nuk e dinte se unë isha duke shkruar në ditarët e mi.* Megjithatë, ky citat i referohet ekskluzivisht ditarëve të mbajtur në burgun e Kleçkës/Kleçkë. Kjo nuk mund të aplikohet në ditarët e jetës të shkruara në një periudhë krejtësisht të ndryshme kohore dhe rrethanave ekzistuese. Kur **Z.** flet

për ditarët të cilët ai i kishte fshehur, dhe tek të cilët askush nuk kishte qasje, ai fliste vetëm në lidhje me ditarët /011 dhe 012/.

Prokuroria i referohet ekspertit të grafologjisë Profesorit **B.**, i cili arriti në përfundimin se ditarët /011 dhe /012 janë shkruar tërësisht nga **Z.**, ashtu sic **Z.** edhe vetë pretendonte. Përveç kësaj, faqet e disa "ditarëve të tjerë të luftës" dhe "ditarët e jetës" i janë nënshtruar po ashtu ekspertizës grafologjike. Konstatimi i ekspertit ishte se të gjitha prej tyre janë shkruar nga **Z.**, me një përjashtim të vetëm: Faqja 4 e "ditarit" /003-një shënim i gjatë i shkrimit të dorës "**I.Q.**". **Z.** asnjëherë nuk është marrë në pyetje në lidhje me këtë autorësi, dhe ai kurrë nuk ka thënë se ai e shkroi tërësinë e dokumenteve që ai ua dha hetuesve, duke përfshirë ditarin /003.

Për sa i përket ekspertit të emëruar të dytë, Prokuroria thekson se Dr. **K.** nuk është grafolog, por më tepër një kriminolog i specializuar në hetimet e ngjarjes dhe aktivitete të tjera të mjekësisë ligjore. Pësia e ekspertizës së tij profesionale nuk mund të vihet në të njëjtin nivel me atë të një grafologu profesional të tillë si Profesor **B.** Gjetjet e Dr. **K.** nuk janë aq bindëse sa ato të Profesor **B.**, dhe nuk janë të mbështetura me dëshmi shkencore. Në këtë sfond nuk është e qartë se pse Gjykata ishte e habitur që profesori Bravo nuk i trajtoi gjetjet e ndryshme të Dr. **K.**, por më tepër iu është referuar metodologjisë së miratuar nga ky i fundit. Profesor **B.** rrënjësisht e ka shkatërruar vlerën shkencore të raportit Dr. **K.**, që do të thotë se ai ka treguar se konkluzionet e Dr Kotri` t çfarëdo që ato janë, duhet të hidhen poshtë.

Për Prokurorinë nuk është e qartë se pse Gjykata pastaj gjeti, duke u larguar nga konkluzionet e që të dyve, edhe Dr. **K.** edhe Professor **B.**, se vetëm katër faqe që i atribuohen nga Dr. **K.** një tjetër autori në fakt janë shkruar nga një tjetër autor. Gjykata e ka analizuar pamjen e dorëshkrimit, dhe arriti në përfundimin se katër faqet janë shkruar nga tre autorë të ndryshëm, përveç **Z.** Gjetja e trupit gjykues në këtë pikë është e privuar nga çdo bazë shkencore dhe duhet të hidhet poshtë.

Vetëm një lexim me qëllim të keq i ekspertizës së grafologjisë, e cila krejtësisht e shpërfill kontekstin dhe arsyet se pse ky nënshkrim shfaqet në ditarin e **Z.**, mund të çojë në përfundimin absurd të arritur nga Gjykata, që ditari i **Z.** është një lloj i produktit "kolektiv". Sidoqoftë, Paneli ka supozuar se **Z.** ka thënë se ai i shkroi tërë "ditarët". Ai kurrë nuk e tha këtë gjë. Edhe në qoftë se disa faqe të ditarit (/013) nuk janë shkruar prej tij, kjo nuk do të e kundërshtonte asnjë prej dëshmive e tija.

Në çdo rast, fakti që **Z.** ka mbajtur një ditar për të ndihmuar kujtesën e tij nuk e përjashton mundësinë që ai mund të ketë kërkuar nga të tjerët për të shkruar diçka në të. Trupi Gjykues arriti në përfundimin se i ashtuquajturit ditar i luftës ishte një koleksion i shënimeve në të cilën

persona të tjerë kanë kontribuar. Paneli i përdor konkluzionet e saja të pasakta në lidhje me katër faqet e parëndësishme të ditarit /013 për të diskredituar tërësinë e ditarëve të **Z.**

Megjithatë, Prokuroria parashtron se **Z.** thjesht e ka mbështetur kujtesën e tij me ditarë. Rasti i Prokurorisë është i bazuar në kujtesën e **Z.**, ndoshta ndihmuar nga ditarët, por jo në ditarë *per se*.

Prokurori i referohet kuotës së Gjykatës së Shkallës së Parë: "*... Më tej, fakti që shënimet janë bërë nga persona të tjerë, bie në kundërshtim me thënien e tij se ky ishte një ditar personal në të cilën ai fshehurazi ka regjistruar informacione. Kjo ishte thjesht një gënjeshtër. Në vend të kësaj, ka më shumë të ngjarë se kjo ka qenë një regjistrim i ngjarjeve në qendrën e paraburgimit në të cilin persona të tjerë kanë kontribuar dhe që **A.Z.** e ka mbajtur pas luftës dhe thjesht e adoptuar si e tij.....*"³⁶

Sipas mendimit të Prokurorisë, Gjykata e Shkallës së Parë e arrin kulmin e arsytimit të papajtueshëm duke deklaruar se **Z.** ka thënë që ai në fakt nuk tha asnjëherë (se ai e shkroi të gjithë ditarin /013), dhe duke e aplikuar një metodë të gabuar shkencore (pamjen e dorëshkrimit) në katër faqe (të parëndësishme), dhe duke bërë kështu, Gjykata arrin në një përfundim të gabuar (**Z.** nuk i ka shkruar katër nga faqet e ditarit /013) dhe konkludon *se kjo më shumë ka të ngjarë të jetë një regjistrim i ngjarjeve në qendrën e paraburgimit në të cilën persona të tjerë kanë kontribuar*. Gjykata nuk e shpjegon nëse kjo vlen vetëm për ditarin /013. Në vend të kësaj, ajo vazhdon duke iu referuar "ditarit të luftës" ose "ditarit", pa treguar se cili zbulim i përshtatet cilit dokument.

Në lidhje me "ditarët e jetës" Prokurori konstaton se, në kundërshtim me gjetjet e Gjykatës, **A.Z.** kurrë nuk ka thënë se të gjitha shënimet ishin bashkëkohës të ngjarjeve.

Për më tepër, një nga dy dokumentet që është dorëzuar nga mbrojtja e **L.** në gjykimin e parë, por mbrojtja nuk ka qenë në gjendje të e shpjegojë se nga ku ajo e mori dokumentin. Pra, në këtë moment origjina e dokumentit është ende e panjohur, dhe nuk duhet as të konsiderohet si provë.

Më në fund, Prokurori vë në dukje se ai nuk i ka konsideruar asnjëherë "ditarët", si pjesë e dëshmisë së **Z.** Ditarët janë përdorur si pikënisje e disa pyetjeve. Ato janë bërë një deklaratë e së vërtetës, kur janë përfshirë në deklaratat zyrtare të dhëna nga **Z.** Asnjë akuzë e vetme në aktakuzë nuk është bazuar vetëm në një ditar. Përshkrimi i veprave penale vjen krejtësisht nga kujtesa e **Z.** dhe dëshmitë, dhe jo nga ditarët.

Gjykata Themelore i është referuar vlerësimit të saj dhe raporteve të Profesor Bravos dhe Dr. Kotrit, dhe arrin në përfundimin se kundër sfondit të devijimit të dëshmive të ekspertëve, 0096-

³⁶ Gjykata Themelore në Prishtinë, aktgjykimi, 17 shtator 2013, fq. 76.

09-EWC2-013, faqe 1, 12, 16 dhe 16a dhe bërjes së shënimeve në 0096-09-EWC2-011, faqe 4 në të ashtuquajturit ditarë lufte, në mënyrë të qartë nuk janë shkruar me të njëjtën dorë, meqë shumica e dokumenteve i atribuohen **A.Z.** Trupi Gjykues gjeti se këto dokumente janë bërë nga tre autorë të ndryshëm.³⁷ Përndryshe Trupi Gjykues konstatoi, ndër të tjera, se ditarët /011 dhe /012 janë shkruar nga **A.Z.** Gjykata konstatoi se ishte për t'u habitur se profesori Bravo nuk i ka adresuar këto gjetje në raportin e tij të mëvonshëm. Në vend të kësaj, ai thjesht iu referua metodologjisë së miratuar nga Dr. Kotri gjatë vlerësimit të dokumenteve të tjera.

Për më tepër, Gjykata Themelore erdhi në përfundimin se i ashtuquajturit ditar i luftës ishte një koleksion i shënimeve në të cilat kanë kontribuar persona të tjerë. Trupi Gjykues iu është referuar intervistës së **A.Z.** dhënë në polici më 3 dhjetor 2009, kur ai u pyet pse ai i kishte mbajtur ditarët. E ai u përgjigj: *Vetëm që të i kem ato për të ma ndihmuar kujtesën time, nëse mua do më duhen disa informacione më vonë.* Paneli më pas arriti në përfundimin se disa shënime në ditar nuk janë shkruar nga **A.Z.** Nëse shënimet janë bërë nga persona të tjerë, atëherë është e qartë se ky nuk ishte një ditar personal që **A.Z.** mbante për të ndihmuar kujtesën e tij. Gjykata Themelore në fund arriti në përfundimin se deklarata e tij ishte thjesht një gënjeshtër.³⁸

Trupi gjykues në aktgjykimin e tij iu është referuar më pas shënimeve të ditarit për 15, 18, 21 dhe 26 dhjetor 2006, të shkruara në një fletë të vetme letre dhe të futura në ditar. Në anën tjetër të faqes ishte një hyrje më tej që i referohet pagesave që ai supozon të i kishte marrë nga **L.** Gjykata arriti në përfundimin se hyrja ishte futur më vonë dhe ishte një përpjekje e qartë dhe e vrazhdë për të përshtatur një ngjarje në kronologjinë e shënimeve të mëvonshme të ditarit.

Për më tepër, Paneli i është referuar dy dokumenteve të mëtejshme dhe gjeti se dokumenti i parë daton 29 dhjetor 2010. Dokumenti i dytë është shkruar është e qartë më vonë, sepse ajo i referohet një bisede telefonike me Prokurorin më 6 korrik 2011. Paneli konstatoi se dokumenti i dytë, i mëvonshmi, është një transkriptim i pjesshëm i të parit. Të dy dokumentet përmbajnë një listë të datave kur **A.Z.** ishte intervistuar nga Prokurori. Versioni i parë i dokumentit përmban fjalinë: *Unë kam nënshkruar pa e ditur se çfarë është në të. Kjo nuk më është përkthyer mua.* Ndërsa përmbajtja e dokumentit të mëparshëm është bartur në dokumentin më vonë, ajo fjali e rëndësishme është lënë jashtë. Paneli ngriti një shqetësim të dukshëm nga ana e avokatit mbrojtës se një hyrje në ditar ishte ndryshuar.

Gjykata e Apelit vëren se vlerësimi i Trupi Gjykues i njëkohësisë së ditarëve nuk është i fokusuar fare në "ditarët e luftës", por në të hyrat më të fundit, të cilat nuk janë relevante për akuzat. **A.Z.** nuk është marrë në pyetje mbi to. Për më tepër, Kolegji i Ankesave konstaton se

³⁷ Gjykata Themelore në Prishtinë, aktgjykim, 17 shtator 2013, fq. 75.

³⁸ Gjykata Themelore në Prishtinë, aktgjykim, 17 shtator 2013, fq. 76.

nuk ka asnjë kontradiktë mes dëshmisë së **A.Z.** se ai i shkroi këto ditarë vetë dhe se askush tjetër nuk ka pasur qasje në to, dhe rezultatet e ekspertizës për shkrim dore. Ai u mor në pyetje vetëm në lidhje me ditarët /011 dhe /012. Nënshkrimi i **I.Q.** në faqen 4 të "ditarit /003", shpjegohet lehtë dhe nuk shtrembëron përmbajtjen e ditarit. Përveç kësaj, Gjykata e Apelit vëren se **A.Z.** nuk i është kërkuar për të shpjeguar praninë e nënshkrimit, vetëm nëse atij iu kujtua ky person, dhe faqja e ditarit nuk iu është treguar **A.Z.**

P. A dini dicka më shume për Islam Qadrakun e përmendur në faqen 4 të ditarit 0096-09EWC2/011?

AZ. (...) Islami u lirua më pas dhe unë nuk e di se çfarë ndodhi me të më pas.³⁹

Gjithashtu, edhe gjatë marrjes në pyetje në mënyrë të tërthortë **A.Z.** është marrë në pyetje në lidhje me Qadrakun, por atij kurrë nuk iu tregua ndonjë faqe e ditarit të tij.⁴⁰

Gjykata e Apelit konkludon se **A.Z.** ishte përgjigjur në mënyrë të qartë për shënimet me shkrim, e jo për nënshkrimin. **A.Z.** kurrë nuk ka thënë se ai i shkroi të gjitha. Gjykata Themelore erdhi në një përfundim të gabuar. Prandaj, Gjykata e Apelit thekson se **A.Z.** e ka thënë të vërtetën. Nuk ka gënjeshtër dhe nuk ka kontradikta të dukshme.

Për më tepër, Gjykata e Apelit pajtohet me gjetjet e Prokurorit, citat "... Unë isha duke marrë shënime, por ato ishin shënime të mia personale. Askush nuk e dinte se unë isha duke shkruar në ditarët e mi ..." i referohet ekskluzivisht ditarëve të mbajtur në burgun e Kleçkës. Ajo nuk mund të zbatohet për "ditarët e jetës", të shkruara në një periudhë krejtësisht të ndryshme kohore dhe të vargut të rrethanave. Kur **Z.** flet për ditarët të cilët ai i ka fshehur, në të cilat askush nuk ka pasur qasje, ai është vetëm duke folur në lidhje me ditarët /011 dhe /012. Në këtë sfond, Gjykata e Apelit nuk pajtohet me Gjykatën Themelore kur e bën etiketimin e ditarëve si produkt kolektiv. **Z.** thjesht e ka mbështetur kujtesën e tij me ditarët, të cilat janë ditarët e tij, por gjithashtu përfshijnë disa dokumente me një autorësi të ndryshme.

Për më tepër, Gjykata e Apelit vëren si në vijim. Më 30 nëntor 2009, **A.Z.** është marrë në pyetje në 0096-09-EWC2/011 (15 faqe) dhe 0096-09-EWC2/012 (5 faqe) specifikisht:

P. A mund të jeni i sigurt se asgjë nuk është shtuar në to më vonë?

³⁹ PSRK-ja, procesverbal nga seanca dëgjimore për të dyshuarin në një hetim, **A.Z.**, 11 shkurt 2010, fq. 16.

⁴⁰ Shih po ashtu: PSRK, Procesverbal nga Dëshmitari bashkëpunues, Seanca në një hetim, **A.Z.**, 6 korrik 2011, fq. 17, pyetjet 181-188.

AZ. I kam mbajtur ato të fshehura, në vende të fshehta dhe jam 100% i sigurt se askush nuk ka pasur qasje në ditarët meqë i kam fshehur. Gruaja ime është i vetmi person që ka qenë në dijeni të ditarëve, por edhe ajo nuk e di se çfarë përmbajtja e tyre ishte.

Këta ditarë i kam shkruar në burgun e Kleçkës gjatë kohës kur kam punuar atje si roje. Kur për shembull e sillnin dikë në burg, unë e shënoja emrin e tij në një copë letër në mënyrë të fshehtë dhe më pas e bartja në ditarin tim, kur ndihesha i sigurt për ta bërë këtë.⁴¹

Më 9 shkurt 2010 **A.Z.** ka dëshmuar si në vijim:

Unë mbaja shënime por ato ishin shënime të mia personale. Askush nuk e dinte se unë po shkruaja në ditarët e mi. Kam shkruar çfarëdo që kam mundur. Shënimet e mia nuk janë patjetër të plota. Ngandonjëherë nuk kam mundur të shkruaja.⁴²

Dhe më tej:

Q. Ku saktësisht i keni ruajtur ditarët tuaj?

AZ. I kam mbështjellë në një letër dhe i kam lidhur me një shirit dhe të gjitha ia kam dhënë gruas time. Nuk i kam treguar asaj se çfarë kishte brenda. I kam thanë asaj që letrat e mbështjella t'ia jap gjykatës në rast se do të vritesha ndonjëherë. Ajo fillimisht i kishte vendosur në dollap në kuzhinë dhe më pastaj brenda në dyshek.

Babai im po ashtu e dinte se këta ditarë ekzistonin por ai nuk e dinte se ku i kisha fshehur.⁴³

Në bazë të kësaj, Gjykata e Apelit thekson se trupi gjykues fatkeqësisht ka gabuar në vlerësimin e përgjithshëm të autenticitetit dhe autorësisë së ditarit të **A.Z.**, pasi këtë vlerësim do të duhej ta kishte kryer në mënyrë të veçantë për çdo ditar. Në këtë drejtim, Gjykata e Apelit nxjerr përfundim se ditarët e luftës 0096-09-EWC2/011 (15 faqe) dhe 0096-09-EWC2/012 (5 faqe) në mënyrë specifike janë autentike, të shkruara nga **A.Z.**, dhe se ato përbëjnë prova të besueshme për atë që ato vërtetojnë identitetin e të burgosurve, dhe datat e ndalimit dhe lirimit të burgosurve në fjalë nga Kleçka.

Për më tepër, Gjykata e Apelit nuk e ka të qartë arsyen pse Gjykata Themelore e ka vlerësuar si të çuditshëm faktin se profesor Bravo nuk i ka trajtuar gjetjet e ndryshme të Dr. **K.**, por më tepër

⁴¹ Deklarata e marrjes së dëshmitarit në pyetje, **A.Z.**, 30 nëntor 2009, f. 10.

⁴² PSRK, procesverbal i dëgjimit të dyshuarit në hetim, **A.Z.**, 9 shkurt 2010, f. 22.

⁴³ PSRK, procesverbal i dëgjimit të dyshuarit në hetim, **A.Z.**, 9 shkurt 2010 p. 23; PSRK, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit bashkëpunues në hetim, **A.Z.**, 9 korrik 2011, f. 14, pika 159.

i është referuar metodologjisë së miratuar nga ky i fundit. Professor **B.** e kishte kritikuar vlerën shkencore të raportit të Kotrit. Ai ka thënë se rezultatet e Dr. **K.** nuk kanë ndonjë vlerë provuese dhe për këtë arsye përfundimet e tij duhet të hidhen poshtë. Në këtë kontekst, Gjykata e Apelit gjen se trupi gjykues ka gabuar kur ka konkluduar se dokumentet 0096-09-EWC2-013, faqet 1, 12, 16 dhe 16a, pa dyshim nuk ishin të shkruara me dorën e njëjtë sikur shumica e dokumenteve që kanë të bëjnë me **A.Z.** Në përgjithësi, trupi gjykues është i lirë për mënyrën e vlerësimit të provave. Megjithatë, ka raste të kufizuara në të cilat ekspertiza e një eksperti duhet të shtyhet. Përfundimi i ekspertit të caktuar bazohet në vlerën shkencore dhe metodologji; në këtë rast, gjykatës nuk i lejohet që të marrë një vendim devijues dhe të dalë me vetë përfundimin e saj se dokumentet 0096-09-EWC2-013, faqet 1, 12, 16 dhe 16a pa dyshim nuk ishin të shkruara me dorën e njëjtë.

Megjithatë, në këtë pikë duhet thënë, se këto gabime të gjykatës së shkallës së parë nuk kanë asnjë ndikim në lëshimin e një vendimi të drejtë nga ana e tyre, si dhe mbi vendimin e Gjykatës së Apelit, pasi edhe prokurori madje thotë se: “...**Z.**, thjesht ka mbështetur kujtesën e tij me ane të ditarëve. Pretendimi i prokurorisë është bazuar në kujtesën e **Z.**, me gjasë të ndihmuar nga ditarët, por jo mbi ditarët për se” dhe “... asnjë akuzë nuk bazohet në ditarët ...” Kjo do të thotë se vlerësimi i deklaratave të **A.Z.** është rrënjësor për vendimin përfundimtar, dhe se procesi i vlerësimit të provave është bërë në mënyrë të rregullt.

Për më tepër, Gjykata e Apelit duhet të theksoj se një jurist profesionist duke përdorur në një dokument zyrtar, e cili është një ankesë me siguri, fjalë të tilla si: “... vetëm një lexim i ekspertizës së grafologjisë me qëllim të keq...”, “..... gjykata e shkallës së parë arrin kulmin e arsytimit të papajtueshëm...” nuk e rrisin forcën e argumenteve, përkundrazi, ato mund të shihen si mungesë e tyre.

(5) Pamundësia e marrjes së tërthortë në pyetje e **A.Z.**

Prokuroria pohon se gjykata e shkallës së parë e ka konsideruar mungesën e **Z.** nga gjykimi si faktor që ka ndikuar në besueshmërinë e tij, dhe se kjo në tërësi e zbeh arsytimin e gjykatës.

Prokuroria në ankesën e saj ka përmendur vërejtjen e gjykatës se **A.Z.** nuk kishte mundësi të merrte pjesë në gjykim. Trupit gjykues iu kishte mohuar mundësia që t’i shtroj pyetje shtesë **A.Z.** për të testuar dëshminë e tij. Trupi gjykues nuk kishte asnjë mundësi që t’i bëj atij pyetje tjera, për të vlerësuar sjelljen e tij, për të vlerësuar shkallën e plotë të kapacitetit të tij për të perceptuar, për të kujtuar ose për të komunikuar ngjarjet, për të vlerësuar karakterin e tij për ndershmëri apo

vërtetësinë, ose për të testuar ekzistencën ose mos ekzistencën e një paragjykimi, interesi apo motivimi tjetër.

Gjykata nuk mund të nxjerr asnjë përfundim të kundërt nga fakti i thjeshtë se dëshmitari nuk ishte dëgjuar në gjykim. Duke deklaruar të kundërtën do të thotë *de facto* që t'i hiqet çfarëdo peshe rregullës, se kur dëshmitari vdes deklaratat e tij lexohen si prova. Deklaratat me shkrim të **A.Z.** janë dëshmi, të cilat duhet vlerësuar në mënyrë të ndërgjegjshme ashtu si janë (neni 368 par. 1.1 dhe neni 387 par. 2).

Duke pretenduar se besueshmëria e **Z.** duhet të bazohet në deklaratat e tij me shkrim siç parashihet me ligj, gjykata ka pasur një mundësi të mirë për të forcuar mendimin e saj për besueshmërinë e **A.Z.**, duke i shikuar videot e seancës së marrjes së tij në pyetje të tërthortë. Prokuroria në këtë kontekst gjen se kur dëshmitari nuk është më në dispozicion për pyetje, zbrazëtitrat e mundshme apo kundërthëniet në dëshmi medoemos mbeten të pashpjegueshme.

Prokuroria i referohet deklaratës së gjykatës themelore se avokatët mbrojtës nuk kishin në dispozicion të tyre, në momentin e marrjes në pyetje, deklaratat e bëra nga **A.Z.** më 20 dhe 30 nëntor 2009, dhe duke vazhduar më 3 dhjetor 2009, dhe më pas i referohet aktvendimit të Gjykatës Supreme në të cilin thuhet: “... *ndërsa pranueshmëria e dëshmive të A.Z. nuk është më një çështje, pesha që i takon dëshmisë e tij është*”⁴⁴

Prokuroria parashtron se dëshmia e **Z.**, pas pranimit, ka të njëjtën peshë si dëshmia e ndonjë dëshmitari tjetër bashkëpunues. Asnjë përfundim i kundërt nuk mund të nxirret nga mungesa e marrjes së tërthortë në pyetje gjatë gjykimit. Gjykata Supreme e ka shqyrtuar këtë çështje dhe ka konfirmuar se mbrojtja kishte një mundësi plotësisht të mjaftueshme për të marrë në pyetje të tërthortë **A.Z.** në korrik 2011.

Prokuroria vjen në përfundim se trupi gjykues i dytë duhet të kishte çmuar dhe vlerësuar dëshminë e **Z.** në të njëjtën mënyrë të saktë siç do të kishte vlerësuar dëshminë e secilit dëshmitar bashkëpunues, dhe se pretendimet e tij kanë të njëjtën peshë sikur pretendimet e ndonjë dëshmitari tjetër bashkëpunues. Fakti që ai nuk ishte i pranishëm në gjykim nuk do të thotë se gjykata, vetëm në këtë fakt, duhet ose mund t'i besoj atij më pak. Gjykata e kishte mundësinë ta merrte atë në pyetje në korrik të vitit 2011 për katër ditë, dhe mbrojtja kishte një mundësi të përkryer të përshtatshme për marrjen e tërthortë të tij në pyetje dhe të shfrytëzoj çfarëdo të mete në dëshminë e tij. Në atë rast, mbi 1,000 pyetje janë bërë. Fakti që gjykata ka

⁴⁴ Gjykata Themelore Prishtinë, aktgjykimi, 17 shtator 2013, faqe 68; shih Gjykatën Supreme të Kosovës, aktvendimet e datës 20 nëntor dhe 11 dhjetor 2012.

konsideruar mungesën e **Z.** në gjykim si faktor që ka ndikuar në besueshmërinë e tij e zbehë në tërësi arsyetimin e gjykatës.

Gjykata e Apelit gjen se Gjykata Supreme, në aktvendimin e saj të datës 20 nëntor 2012, e ka trajtuar tashmë kërkesën e gjykatës lidhur me nivelin ligjor të mundësisë për t'iu dhënë mbrojtjes për ta kundërshtuar atë në përputhje me nenin 156 paragrafi 2 të KPPK-së. Gjykata e Qarkut, në aktvendimin e saj mbi “pranueshmërinë e deklaratave të **A.Z.** dhe ditarëve” të datës 21 mars 2012, dhe në vijim po ashtu edhe në aktgjykimin e datës 2 maj 2012, i ka interpretuar standardet ligjore të një “Mundësie për ta kundërshtuar”, siç kërkohet nga neni 156 paragrafi 2 të KPPK-së që të jetë një term ligjor që kërkon të plotësohet me përmbajtje nga ana e gjyqtarit. Për këtë arsye përcaktohen kërkesat të shumta të tjera në lidhje me çështjen, kur një mundësi e tillë i plotëson standardet e nenit 156 paragrafi 2 të KPPK-së. Në veçanti, Gjykata e Qarkut ka shtjelluar idenë se përmbajtja e mundësisë do të varet, në mesin e faktorëve të tjerë, në kompleksitetin e çështjes dhe statusin e dëshmitarit të mundshëm si bashkëkryerës i dyshuar. Prandaj, mbi bazën e secilit rast veç e veç, kërkesat e mundësisë në bazë të nenit 156 paragrafi 2 të KPPK-së do të ishin fleksibile dhe të ndryshme në intensitet. Duke pasur parasysh se nuk dyshohet se ka prova dëshmuese për të gjitha aspektet e trajtuara në deklaratat e **A.Z.**, dhe se ky i fundit ka ndërruar jetë, standardet ligjore të mundësisë *mund të kërkojnë marrjen e tërthortë në pyetje gati po aq të plotë sa edhe që do të ishte në shqyrtimin kryesor.*⁴⁵

Gjykata Supreme ka gjetur se këto kërkesa të tjera, të shtjelluara nga Gjykata e Qarkut, janë kryesisht të pabaza. Për arsye metodologjike, nuk është pajtuar me kërkesën e një *fleksibiliteti të nivelit ligjor të mundësisë* për pranueshmërinë e provave. Fakti që dëshmitari ka vdekur nuk mund të ketë ndonjë rëndësi për mundësinë për ta kundërshtuar, pasi ky është një fakt që ndoshta nuk ka mundur të jetë i njohur paraprakisht nga asnjëra nga palët. Gjykata Supreme ka theksuar se ekziston kuptimi eksplicit i nenit 156 paragrafi 2 të KPPK-së për të siguruar njohuritë e dëshmitarit i cili në një fazë të mëvonshme mund të mos jetë më në dispozicion. Neni 156 par. 2 të KPPK-së, fare nuk kërkon kurrfarë marrje të tërthortë në pyetje, as në bazë të formulimit të tij dhe as që rezulton nga interpretimi i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ).

Gjykata Supreme u pajtua me vlerësimin e Gjykatës së Qarkut në atë masë që shprehja “mundësi”, siç përdoret në nenin 156 paragrafi 2 të KPPK-së, përfshin që mundësia duhet të jetë reale dhe kuptimplotë, duke i mundësuar mbrojtjes përfshirjen në mënyrë thelbësore me provat e dëshmitarit. Koha e përgatitjes duhet të merret parasysh në lidhje me kompleksitetin e çështjes

⁴⁵ Gjykata e Qarkut Prishtinë, aktvendimi mbi pranueshmërinë e deklaratave të **A.Z.** dhe ditarëve, të datës 21 mars 2012, f. 25, nr. 47.

dhe rëndësinë relative dhe statusin e dëshmitarëve. Gjykata Supreme mori parasysh se mbrojtja ishte pajisur me të gjitha dokumentet relevante dhe kishte kohë të mjaftueshme për përgatitje për të planifikuar marrjen në pyetje.

Gjykata Supreme theksoi se kohëzgjatja totale e katër seancave ishte rreth 19 orë, gjatë të cilave të gjithë mbrojtësit ishin të pranishëm dhe kishin mundësinë për të marrë pjesë në pyetje, për të dëgjuar marrjen në pyetje nga kolegët e tyre dhe për të plotësuar marrjen e tyre në pyetje me radhë. Prokurori i PSRK-së nuk ka vendosur kurrfarë kufizimesh rreth pyetjeve që mund të bëheshin, dhe për këtë arsye mbrojtësit dhe të pandehurit ishin të lirë të bënin pyetjet që ata dëshironin, dhe në shumicën e rasteve ata e bënë një gjë të tillë. Në të vërtetë, mbi 1000 (një mijë) pyetje janë bërë, duke përfshirë edhe mbi 500 pyetje nga ana e mbrojtjes për **F.L.**, dhe pyetjet dhe përgjigjet përbejnë rreth 86 faqe transkriptime në versionin anglisht. Seancat ishin gjithashtu të filmuara. Prokurori i PSRK-së ka hequr dorë nga e drejta e tij për të bërë ndonjë pyetje dëshmitarit, duke ia lënë fjalën menjëherë dhe në mënyrë ekskluzive mbrojtjes. Gjykata Supreme ka konstatuar se edhe pse kjo situatë aspak nuk arrin kërkesat e marrjes së tërthortë në pyetje, megjithatë i plotëson kërkesat e një mundësie për ta kundërshtuar, siç parashikohet në nenin 156 paragrafi 2 të KPPK-së.⁴⁶

Gjykata e Apelit pajtohet me Gjykatën Supreme dhe prokurorinë, dhe thekson se edhe gjykata po ashtu dhe mbrojtja e kanë pasur mundësinë ta shohin **A.Z.** gjatë dëshmisë, gjatë marrjes së tërthortë në pyetje nga mbrojtja në korrik 2011 për katër ditë. Mbi 1,000 pyetje janë bërë gjatë seancës.

Në çdo rast, kjo nuk ka asnjë ndikim në vlerësimin e besueshmërisë së **A.Z.** Edhe pse stili i formulimit i përdorur nga Gjykata Themelore mund të jetë jo i duhur, duke pasur parasysh çështjen e pranueshmërisë, kjo nuk përbën më ndonjë problem. Deklaratat nga Gjykata Themelore në lidhje me marrjen e tërthortë në pyetje të **A.Z.** nuk kanë ndikim në vërtetimin përfundimtar të fakteve të rastit, ose në vlerësimin e besueshmërisë së **A.Z.** Një lexim i kujdesshëm i aktgjykimit tregon se kjo nuk ka pasur asnjë ndikim. Është e vërtetë se gjykata ka gabuar kur ka konstatuar se mbrojtjes i ishte mohuar mundësia për ta marrë në pyetje të tërthortë **A.Z.**, por as nuk është e vërtetë se vendimi është bazuar në një supozim të gabuar ligjor dhe i gjithë arsyetimi i gjykatës është i zbehur, siç pretendohet nga prokurori. Ky përfundim mund të ishte arritur vetëm nëse gjykata e shkallës së parë nuk do t'i kishte vlerësuar fare provat materiale dhe do të deklaronte se mbrojtjes i është mohuar mundësia e marrjes së tërthortë në pyetje të **A.Z.**, dhe se ishte shkelur parimi i “barazisë së armëve”. Trupi gjykues i shkallës së parë ka vlerësuar të gjitha pjesët e dëshmive dhe shumë qartë ka shpjeguar pse deklaratat e **Z.**

⁴⁶ Gjykata Supreme e Kosovës, aktvendimi i datës 20 nëntor 2012, f. 20, 24.

nuk janë të besueshme, dhe pamundësia e marrjes së tërthortë në pyetje të **A.Z.** nuk ishte arsyeja e vetme apo vendimtare për këtë (në fakt, ishte më tepër marginale).

Në këtë pikë, Gjykata e Apelit thekson se leximi i kujdesshëm i arsyetimit jep përshtypjen se qëllimi i gjykatës në preken e kësaj çështje ishte pak më ndryshe nga kjo, dhe në të vërtetë stili i formulimit të Gjykatës Themelore mund të jetë çorientues.

Është e vërtetë se mundësia për të marrë në pyetje të tërthortë **A.Z.** nga avokati mbrojtës nuk është problemi, por këtu shfaqet një parim tjetër ligjor - parimi i menjëhershmerisë.

Parimi i menjëhershmerisë është një nga parimet udhëheqëse të procedurës penale të vendeve të BE-së, dhe ofron një direktivë drejtuar gjykatave dhe prokurorëve. Ky parim është i bazuar në dy aspekte: formal dhe substancial. Aspekti formal është kushti që gjykata të takohet personalisht dhe drejtpërdrejt me provat në kohën e gjykimit. Aspektit material kërkon që gjykata të bëjë gjetjet e fakteve në bazë të provave primare, origjinale të cilat vijnë nga burime të drejtpërdrejta.

Duke marrë parasysh këtë përkufizim, Gjykata e Apelit konstaton se Gjykata Themelore donte ta merrte drejtpërdrejt në pyetje **A.Z.**, për shkak të dyshimeve në lidhje me deklaratat e tij. Ekzistenca e këtyre mospërputhjeve dhe pamundësia e sqarimit të tyre, mund të shkaktojë shkeljen e një parimi të rëndësishëm, atë të “*in dubio pro reo*”, i cili patjetër do të shkaktonte prishjen e aktgjykimit. Duke marrë parasysh këtë, Gjykata e Apelit vëren gabimin i cili është bërë nga Gjykata Themelore, por vendos që ky gabim nuk ka ndonjë ndikim rrënjësor në dhënien e vendimit të ligjshëm.

(6) Vrasja e katër ushtarëve serb.

Prokurori pretendon se ka prova të pakontestueshme se pesë trupa u zhvarrosën nga vendndodhja e varrit të treguar nga **A.Z.** Analiza e ADN-së tregoi se këta ishin pesë ushtarë serbë. Sipas ekzaminimit forenzik mjeko-ligjor, dy prej ushtarëve i kishin duart e lidhura, se veshje ushtarake dhe një kosë janë gjetur në varr, dhe se datat e pranimit të tyre në burg në ditat përputhen me provat *ante mortem*. Emrat e katër nga pesë prej këtyre viktimave gjendeshin në shënimet e një ditari si të burgosur në burgun e Kleçkës.

Në lidhje me faktin se **A.Z.** ka thënë se nëntë trupa ishin të varrosur në varr, ndërsa vetëm pesë janë gjetur, prokurori pohon se kjo nuk e cenon besueshmërinë e dëshmitarit bashkëpunues, duke qenë se **A.Z.** nuk kishte dijeni se çfarë kishte ndodhur në varr pasi trupat ishin hedhur në të, se ai

asnjëherë nuk kishte thënë se e kishte mbyllur varrin dhe as që e kishte monitoruar vazhdimisht vendndodhjen e tij.

Prokurori thekson gjithashtu se ekspertja e forenzikes, arkeologia **C.C.** dëshmoi se nuk do të kishte qenë e mundur për të zbuluar gjurmët e ndërhyrjes se hershme të varrit brenda gjashtë muajve të parë. Ajo më tej pohon se ka indikacione të forta se disa trupa mund të ishin larguar. Në kundërshtim me deklaratën e Gjykatës Themelore, ai sqaron se **A.Z.** asnjëherë nuk kishte dëshmuar se ata kishin ndërhyrë në varrin në fjalë në vitin 2002, pasi që **A.Z.** iu kishte referuar një varri tjetër.

Sa i përket renditjes në të cilën trupat janë gjetur në varr, e cila nuk përputhet me rrëfimin e **A.Z.**, prokurori kujton se dëshmitarja eksperte **C.C.** deklaroi se “...nëse trupat ishin larguar para se të mbulohehin, do të ishte shumë e vështirë për të thënë se atje kishte më shumë trupa...”. Në kundërshtim me përfundimin e Gjykatës Themelore, **A.Z.** nuk dëshmoi se pas çdo viktime trupat ishin varrosur, por se ishin mbuluar me pak dhe.

Për më tepër, ndërsa **A.Z.** ka deklaruar se katër serbët janë vranë 20 ditë përpara **A.A.**, në kundërshtim me dëshminë, prokurori saktëson se **A.Z.** në fakt iu ka referuar dy grupeve të ndryshme të katër serbëve, dhe se ai kishte pranuar se nuk ishte i sigurt sa i përket datave dhe identitetet e dy grupeve të serbëve. Ai pretendon se kundërthënia e dukshme shpjegohet lehtë me faktin se **A.Z.** bëri një gabim në lidhje me datën “20 ditë para vrasjes së **A.A.**”.

Sa i përket kundërthënies së dukshme mes deklaratës së **A.Z.** që përfshin **A.K.** në dy ngjarje dhe alibinë e **A.K.**, prokurori pretendon se nuk ka asnjë kundërthënie. Sipas shënimit në ditari, serbët u vranë më 18 prill 1999. Në të njëjtën ditë kur **A.K.** u plagos në Lapushnik, një vend afër Kleçkës. Të dy ngjarjet thjeshtë mund të kenë ndodhur në të njëjtën ditë. Edhe duke supozuar se serbët janë vranë më 18 prill 1999, **A.K.** thjesht mund të ketë qenë i pranishëm në Kleçkë atë ditë, para se të ishte plagosur. Megjithatë, kjo nuk e ulë kredibilitetin e **A.Z.**

Gjykata Themelore i referohet dëshmisë së **A.Z.**, ku ai deklaroi se **A.A.** u vra një ditë pas lirimit të tij. Një shënim i ditarit e regjistron datën e tij të lirimit si 2 prill 1999, që ishte 20 ditë përpara se ai ta kishte parë vrasjen e katër të burgosurve serbë. Duke përshkruar vrasjen e katër të burgosurve serbë, ai tha se ishte rreth 40-50 metra larg. Ai tha se të burgosurit ishin të veshur me uniformë të rregullt të ushtrisë serbe; dy të burgosur i kishin duart e lidhura pas shpine, dhe dy të tjerët ishin të lidhur së bashku me tel. **Z.** ka dëshmuar se **N.K.**, **N.K.** dhe dy persona të tjerë i kanë marrë serbët dhe i çuan poshtë livadhut tek gropa në tokë. Pastaj ai dëgjoi të shtënat e qëlluara nga disa kallashnikovë. “**V.D.**” ishte gjithashtu i pranishëm. Në lidhje me vendin e varrimit, **A.A.** ishte varrosur në “vendin ku 9 persona ishin varrosur”.

Gjykata Themelore ka konkluduar se mbetjet e **D.T.**, **B.C.**, **Ž.F.**, **Ž.T.** dhe **D.V.** ishin gjetur në vendndodhjen KER01, të cilën **A.Z.** e kishte identifikuar si varrin ku gjendeshin trupat e ushtarëve serb, vrasjen e të cilëve ai thotë se e kishte parë 20 ditë para vrasjes së **A.A.** Megjithatë, **D.T.**, **B.C.**, **Z.F.**, **Z.T.** dhe **D.V.** nuk ishin kapur nga njësitë e UÇK-së deri më 11 prill 1999.

A.Z. u pyet në lidhje me një shënim në ditar ku thuhet “**D.T.N.**, **T.S.Z.**, **S.**, **B.S.** dhe **F.P.Z.** u “liruan më 18 prill 1999”. Më vonë kishte dëgjuar se ata të burgosur ishin vrarë. Ai besonte se ata punonin për një kompani të energjisë elektrike, dhe se ata ishin civilë. Të katër të burgosurit serbë, vrasjen e të cilëve e kishte parë dhe trupat e të cilëve kishte ndihmuar të varroseshin në varr nuk ishin civilë. Ata u vranë të veshur në uniformat e tyre ushtarake. Kur ishte intervistuar në vitin 2009, ai deklaroi se vetëm kishte dëgjuar për vrasjen e katër të burgosurve serbë të cilët ishin liruar më 18 prill 1999. Kur ishte dëgjuar më 11 shkurt 2010 ai kishte thënë: “Jam mjaft i sigurt se dy grupe të ndryshme të katër serbëve u sollën në Kleçkë”.

Gjykata Themelore ka konkluduar se dëshmia në lidhje me vrasjen e katër të burgosurve serbë është e paqëndrueshme dhe kontradiktore, dhe kundërshtohet nga dëshmitë e tjera, duke përfshirë provat mjeko-ligjore.

Gjykata e Apelit gjen se në përgjithësi është e qartë nga provat mjeko-ligjore se është kryer gjurmimi i vendndodhjes së varrit KER01, treguar nga **A.Z.** dhe se pesë trupa u nxjerrën nga aty. Nëpërmjet analizave të ADN-së janë identifikuar trupat si **D.T.**, **D.V.**, **B.C.**, **Z.F.** dhe **Z.T.** Veshje ushtarake janë nxjerrë prej varrezës. Për më tepër, ekspertët e forenzikës kanë bërë të ditur se dy trupa i kishin duart e lidhura pas shpine dhe se ishin gjetur ligatura. Emrat e katër nga pesë viktimave serbë të gjetur paraqiten në një nga ditarët e **Z.** si të burgosur në Kleçkë.

Në lidhje me faktin se **A.Z.** kishte dëshmuar se nëntë trupa ishin varrosur në varrezë, ndërsa vetëm pesë janë gjetur, Gjykata e Apelit konstaton se kjo definitivisht minon besueshmërinë e deklaratës së dëshmitarit bashkëpunues. **A.Z.** e kishte përshkruar dhe kishte deklaruar se ai kishte njohuri për varrin, dhe se, ajo që është thënë prej tij, ndryshon nga ajo që është zbuluar. Kolegji i apelit i referohet deklaratës së **Z.** se ai e kishte mbyllur varrin, që do të thotë se ai e dinte se kush është varrosur aty. Më vonë, **Z.** i kishte thënë prokurorit se ai kishte informacion se trupat ishin larguar nga ky lokacion:

AZ: Nuk di asgjë rreth kësaj [...] me duhet t’ua bëj me dije paraprakisht se megjithatë sipas informacionit që unë kam, trupat ishin larguar nga kjo vendndodhje.⁴⁷

⁴⁷ Intervista, 16 mars 2010, page 5.

Trupi gjykues i shkallës së parë ka plotësisht të drejtë në gjetjen dhe përmendjen e mospërputhjeve në këtë deklaratë. Në analizën e ekstraktit sipër, është e mundur vetëm të thuhet se **Z.** nuk dinte asgjë rreth ndërhyrjes në varr, por ai kishte disa njohuri të përgjithshme se: “... sipas informatave që kam trupat ishin nxjerrë nga vendndodhja”. Në këtë pikë, duhet të shtrohet pyetja: sipas çfarë lloji të informacionit?, prej kujt ka ardhur informacioni?, *u nxorën nga vendndodhja* nga kush? Nuk ka asnjë përgjigje për ndonjërin prej këtyre pyetjeve, prandaj mungesa e këtyre pjesëve të informacionit patjetër duhet të interpretohet në dobinë e të pandehurve, e cila gjë është bërë në mënyrë korrekte nga ana e Gjykatës Themelore.

Kolegji i apelit thekson se arkeologia e mjekësisë ligjore znj. **C.** dëshmoi se në qoftë se ishte bërë ndërhyrje në varr në gjashtë muajt e parë, ajo nuk do ta kishte dalluar në rastin e gërmimit të vendndodhjes. Gjurmët e një ndërhyrje të hershme të tillë në varr nuk do të zbuloheshin. Raporti i përgjithshëm nga ana e ekspertës së forenzikes iu është përgjigjur pyetjeve të cilat janë shtruar nga prokuroria për këtë çështje, dhe ata thonë se kjo përgjigje ndryshon në rastin e tyre pasi që ata nuk kanë asnjë dëshmi apo provë të vetme se ndonjë ndërhyrje e tillë kishte ndodhur. Për të pranuar mendimin e prokurorisë në këtë çështje do të ishte pranimi i ngjarjeve bazuar në spekulimin e prokurorisë.

Gjykata e Apelit po ashtu nuk mund të lejojë as spekulime të tilla si, “..... është shumë e mundshme që disa trupa mund të jenë larguar pak kohë më vonë", dhe “.....është shumë e mundshme që pas vrasjeve dhe mbulesës së parë me dhe, kryesit e veprës të kenë vendosur që të ndanin viktimat shqiptare dhe serbe dhe t'i kenë rivarrosur në varre të ndryshme...”. Kjo do të ishte në shkelje flagrante të njërit prej parimeve më të rëndësishëm të kodit të procedurës penale, i cili është “*in dubio pro reo*”. Pas nuk kemi asnjë gjurmë që ngjarje të tilla kanë ndodhur, thjesht ne nuk mund të supozojmë se ata e kryen një gjë të tillë. Sigurisht prokuroria, në mbështetje të aktakuzës, mund të propozojë një interpretim të tillë të fakteve, por mohimi i kësaj nga Gjykata Themelore nuk mund të supozohet të jetë në gabim.

Si përfundim, kolegji i apelit mund të vendosë që, sipas fakteve që janë paraqitur gjatë shqyrtimit kryesor, ekzistojnë kundërthënie dhe mospërputhje thelbësore në dëshminë e **A.Z.** në lidhje me numrin e viktimave të varrosur dhe numrin e mbetjeve të gjetura në varr. Fakti që vetëm pesë trupa janë nxjerrë nga kjo vendndodhje, në vend të nëntë trupave, është një kontradiktë në deklaratën e **Z.** dhe kjo gjithashtu e minon besueshmërinë e tij. Gjetja e vetëm pesë trupave serbë në vend të nëntë trupave siç është deklaruar nga **Z.** nuk vërteton rrëfimin e tij në këtë pikë, dhe besueshmërinë e tij të përgjithshme. Mungesa e katër trupave të tjerë të përmendura nuk mund të shpjegohet në bazë të pjesëve të mbledhura të dëshmive, dhe padyshim e zbehë besueshmërinë e tij.

Për më tepër, Gjykata e Apelit gjen se **A.Z.** ka gabuar lidhur me datën kur kishte thënë se katër ushtarë serbë janë vrarë 20 ditë përpara **A.A.** Nga shënimet e ditarit është vërtetuar se **A.A.** është vrarë më 3 prill 1999. Sipas deklaratës së **A.Z.**, kjo do të nënkuptonte se të burgosurit serbë ishin vrarë rreth datës 14 mars 1999. Megjithatë, shënimet në ditar në mënyrë të qartë tregojnë se UÇK-ja nuk e kishte kapur Dragoljub Tanaskovic, Dragan Vuçetic, Bojan Cvetkovic, Zharko Filipovic dhe Zivota Todorovic para datës 11 prill 1999. Për këtë arsye, datat e dhëna nga **A.Z.** nuk përputhen me provat, dhe është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se ai ka gabuar në lidhje me datën.

Duke iu referuar alibisë së **A.K.**, Gjykata e Apelit konstaton se Gjykata Themelore nuk gabon në asnjë mënyrë, kur përfundon se **A.K.** nuk mund të ketë qenë i pranishëm për të mbuluar trupat, sepse ai ishte i plagosur në të njëjtën ditë kur serbët ishin vrarë. Prandaj, **A.Z.** ka gënjyer dhe dëshmia e tij është e paqëndrueshme dhe kontradiktore. Në këtë pikë, Gjykata Themelore vjen në përfundimin:

*Nëse ai nuk kishte gënjyer për **A.K.**, por thjeshtë kishte gabuar, rezultati përfundimtar është i njëjtë – dëshmia e tij është e pabesueshme.*⁴⁸

Është e qartë nga provat që **A.K.** ishte plagosur në Llapushnik më 18 prill 1999. Është fakt i provuar. Prandaj, kolegji i apelit nuk mund të pajtohet me prokurorin dhe konstaton se, teorikisht, **A.K.** ka mundur të ishte plagosur pas vrasjeve dhe pasi ta kishte ndihmuar **A.Z.**, në mbulimin e kufomave me dhe. Për të përfunduar ndryshe do të ishte pranimi i spekulimeve të cilat nuk kanë mbështetjen e asnjë dëshmi. Sigurisht, është e mundur që ai së pari ta ketë ndihmuar **A.Z.** për t'i varrosur të burgosurit e vrarë dhe më pas të ishte plagosur pak kohë më vonë të njëjtën ditë. Është po aq e mundur sa edhe shumë skenarë të tjerë që mund të propozohen për të shpjeguar këtë aspekt të rastit, por pa prova, thjesht kjo nuk mund të bëhet pa shkelur parimet themelore, të cilën Gjykata e Apelit nuk e bën.

Përveç kësaj, dhe më së shumti me të njëjtin arsyetim, Gjykata e Apelit pajtohet me trupin gjykues se dëshmia e **A.Z.** lidhur me kryesit e vrasjeve nuk është e mbështetshme. **A.Z.** ka dëshmuar se kishte qenë 40-50 metra larg kur dëgjoji të shtënat e kallashnikovëve dhe se të burgosurit ishin të veshur me uniforma të ushtrisë serbe. Ai dëshmoi se e kishte parë **N.K.**, **N.K.** dhe dy të tjerë, si dhe “**V.D.**”. Nuk ka pjesë të tjera të provave, përveç deklaratave të **Z.**, që mbështesin faktin e pranisë së këtyre personave në këtë vend. Është shumë e rëndësishme që edhe nëse **Z.** të kishte dëshmuar se e kishte parë vetëm **N.K.**, **N.K.** dhe dy të tjerë, si dhe “**V.D.**”, ai nuk ka thënë se çfarë saktësisht kishin bërë ata, pasi ai ishte 40-50 metra larg. A mundet vetëm

⁴⁸ Gjykata Themelore në Prishtinë, aktgjykimi, 17 shtator 2013, faqe 132.

kjo deklaratë të jetë bazë për dënimin e çdonjërit? Përgjigja e vetme është “JO”. Ne tashmë kemi vërtetuar dhe shpjeguar se nuk mund të mbështetemi në dëshminë e **A.Z.**, pasi ai nuk është një dëshmitar serioz dhe i besueshëm. Gjykata e Qarkut ka paraqitur shumë argumente ligjore për të thënë se **A.Z.** ka gënjyer në lidhje me **N.K.**, **N.K.**, **V.D.** dhe dy të tjerët. Kolegji i apelit gjithashtu konstaton se **A.Z.** kishte motive të qarta për të vepruar kundër **F.L.**, si dhe të pandehurve të tjerë, dhe kështu kolegji konkludon se **A.Z.** nuk ishte i sinqertë.

(7) Vrasja e ushtarit të pestë serb.

Në lidhje me faktin se **A.Z.** ka dëshmuar se vetëm një i burgosur është vrarë me kosë, kur provat mjeko-ligjore kanë vërtetuar se dy të burgosur ishin vrarë në këtë mënyrë, prokurori parashtroi se **A.Z.** asnjëherë nuk ka thënë se ai e kishte parë me sytë e tij ekzekutimin e grupit të katër serbëve. Sipas prokurorisë, **A.Z.** ka dëshmuar në lidhje me të burgosurin e pestë serb i cili u vra me kosë, dhjetë ditë pas katër të burgosurve serbë eshtrat e të cilëve u gjetën në varrin KER01.

Prokurori konstaton se shënimi i ditarit *per se* nuk është aq i qartë. Emri i pestë përsëritët, që tregon se ka pasur një lloj gabimi në shënimin e ditarit. Data e treguar në ditarin e **Z.** si “lirimi” (18 prill 1999) është shkruar anash faqes, dhe nuk është e qartë se për cilët të burgosur bëhet fjalë. Megjithatë, Gjykata Themelore kishte arritur në përfundimin se dëshmia e **A.Z.** është në kundërshtim me shënimin e ditarit. **A.Z.** ka dhënë dëshmi se **D.T.** nuk u vra më 18 prill 1999, por 10 ditë më vonë. Në një shënim të ditarit thuhet “**D.T.N.**, i sjellë më 11 prill 1999, i liruar më 18 prill 1999”. Ky shënim i ditarit tregon se **D.T.** ishte një nga katër të burgosurit serbë të cilët u qëlluan 10 ditë para se të ishte vrarë i burgosuri i pestë serb nga **N.S.** duke përdorur tehun e kosës.

Prokurori konstaton se gjykata është përqendruar në të gjitha mospërputhjet e supozuara që ka mundur t’i gjente, dhe në mënyrë të paskrupullt i ka ikur çështjes kryesore. **Z.** e ka treguar rrëfimin e pesë të burgosurve serbë. Katër u vranë më përpara, një më pas. Ai flet për mënyrën se si janë vrarë dhe vendin ku janë hedhur trupat e tyre. Ai tha se katër persona janë vrarë me të shtëna armësh dhe një me kosë. Ai ka përmendur datat e përafërta, të cilat janë plotësisht në përputhje me provat *ante mortem*. Dëshmitari i pavarur, **U.K.** gjithashtu kishte parë një grup prej katër serbëve në Kleçkë në të njëjtën periudhë kohore, si dhe e kishte parë **Z.** atje. Të pesë trupat u gjetën. Po ashtu janë gjetur veshje dhe palë ligaturash dhe një kosë gjithashtu. Dy nga viktimat janë vrarë me të, të tjerët nga plagët e shkaktuara me armë zjarri. Emrat e katër prej pesë viktimave u gjetën në ditarët e **Z.** Prandaj, tregimi është koherent dhe i besueshëm. Kjo është vërtetuar nga provat materiale, forenzike dhe dëshmuese.

Prokurori i referohet një kundërthënie tjetër të dëshmisë së **Z.** Gjykata Themelore ka theksuar se sipas **A.Z.**, viktima ishte i veshur me rroba civile, ndërsa sipas raportit të DML-së viktima kishte të veshur rroba të ushtrisë. Megjithatë, Gjykata Themelore ka arritur në një përfundim të gabuar, sepse Raporti i DML-së ka dy kolona: *ante-mortem* dhe *post-mortem*. *Ante-mortem* i viktimit tregon “veshje të ushtrisë”, *post-mortem* tregon “bluzë shumë ngjyrëshe” dhe një “çorapë e gjelbër”. Një gabim i ngjashëm është bërë në lidhje me viktimen e dytë, **D.V.** “Veshje ushtarake” dhe “këpucët ushtarake” i referohen *ante mortem*. Nuk kishte asnjë veshje relevante të shënuar në kolonën e *post-mortem*.

Prokurori parashtron se Gjykata Themelore është përpjekur të lë të kuptohet se dikush i kishte thënë **Z.** çfarë të flasë, dhe iu ka referuar deklaratës së **A.Z.**, në lidhje me përdorimin e kosës dhe telave ligaturë. Ai konstaton se ky lloj i insinuatave të papërgjegjshme nuk duhet shkruar asnjëherë në një aktgjykim, sepse ato nuk mund t'i përkasin arsyetimit gjyqësor sipas definicionit, i cili njihet vetëm kategoritë “dëshmuar/nuk është dëshmuar”. Pjesa tjetër është thjesht spekulim.

Prokuroria kujton se **Z.** asnjëherë nuk ka thënë se ai e kishte parë vrasjen e katër të burgosurve. Ai ka dhënë dëshmi se në fillim e kishte parë një grup prej katër serbëve duke ecur në drejtim të gropës në tokë. Ai nuk e kishte parë vrasjen e tyre. Ai vetëm kishte dëgjuar të shtëna. Disa ditë më vonë, ai e kishte parë vrasjen e një të burgosuri të pestë serb me kosë. Prandaj, ai nuk mund të kishte parë se që të dyja viktimat ishin vrarë me kosë. Si rezultat, nuk ka kundërthënie siç është supozuar nga Gjykata Themelore.

Sipas prokurorisë, Gjykata Themelore ka konkluduar se të paktën dy persona kanë qenë të përfshirë në prerjen e dy viktimave. Megjithatë, **Z.** nuk kishte përmendur përfshirjen e askujt në vrasje, përveç **N.S.** Ai nuk e kishte parë momentin e ekzekutimit të grupit të parë të katër serbëve. Në çdo rast, ai ka thënë se në të dyja rastet ka pasur një grup të kryesve. Përndryshe, do të ishte normale, pas 10 vjetëve të mos i kujtohen saktësisht të gjitha lëvizjet e secilit kryes të veprës.

Prokuroria ka përmbledhur se gjykata i ka dhënë peshë disproporcionale kontradiktave të supozuara të cilat prokurori i ka sqaruar tani. Gjetja e shtatë trupave nuk llogaritet për asgjë. Trupi gjykues në kuptimin e plotë të fjalës i ka kthyer me kokë poshtë rregullat e logjikës së shëndoshë. Vlerësimi i bërë nga trupi gjykues ka çuar pa dyshim në një vlerësim të gabuar të gjendjes faktike dhe mbi kredibilitetin e përgjithshëm të **Z.**

Gjykata Themelore ka konkluduar se dëshmia e **A.Z.** në lidhje me kronologjinë e ngjarjeve dhe identitetin e viktimave kundërshtohet nga shënimet në ditarin e tij dhe provat e tjera. **A.Z.** ka

dëshmuar se më pak se 10 ditë pas vrasjes së katër të burgosurve serbë **N.S.** i kishte kërkuar atij për të gjetur një kosë.

Duke iu referuar të burgosurit të pestë serb, **N.S.** i kishte thënë atij “Unë do ta pres këtë derr”. Ai gjithashtu kishte dëshmuar se **F.L.** e kishte intervistuar këtë serb me të tjerët. Pasi i burgosuri ishte rrahur, **N.S.** kishte bërë titur: “Ma gjeni një kosë dhe unë do ta presë atë”. **A.Z.** ka dëshmuar se e kishte gjetur një teh kose në një shtëpi të djegur. Ai i kishte dhënë tehun **A.K.**, i cili ia kishte dhënë **N.S.**, **N.S.**, **N.K.**, **N.K.** dhe “**V.D.**” të burgosurin serb e dërguan në fushë. I burgosuri ishte i ulur ku **N.S.** filloi ta presë me kosë. Gjykata Themelore konkludon se rrëfimi i tij për të burgosurin e pestë serb të vrarë me tehun e kosës është në përputhje me provat forenzike.

Megjithatë, **A.Z.** ka dëshmuar se më pak se një javë më pas, ai kishte dëgjuar të shtëna armësh dhe i kishte parë trupat e tre shqiptarëve në veshje civile. Kur ishte pyetur në lidhje me tre shqiptarët dhe në qoftë se ka qenë e njëjta gropë ku të katër serbët janë “hedhur”, ai kishte thënë “po”. Kur ishte pyetur në lidhje me sekuencën e vrasjeve “fillimisht **A.A.**, pastaj të katër serbët, pastaj serbi me kosë dhe pastaj tre shqiptarët” ai tha “po”. Kjo përgjigje e kundërshton dëshminë e tij të mëhershme që ai e kishte konfirmuar në fillim të marrjes në pyetje. Më parë ai kishte thënë se të katër të burgosurit serbë ishin vrarë 20 ditë përpara **A.A.** Ai e ka dhënë të njëjtën dëshmi në dy raste.

Gjykata Themelore ka gjetur se është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se të katër viktimat serb të gjetura në vendndodhjen KER01 ishin: **D.T.**, **D.V.**, **B.C.**, **Z.F.** dhe **Z.T.** Në qoftë se ushtarët serbë janë vrarë 20 ditë përpara **A.A.** ata janë vrarë në gjysmën e parë të marsit 1999. Trupi gjykues është i sigurt për datën kur u lirua **A.A.** nga Kleçka, sepse janë dhënë dëshmi nga dëshmitarët e tjerë të cilët u liruan në të njëjtën ditë. Megjithatë, **D.T.**, **D.V.**, **B.C.**, **Z.F.** dhe **Z.T.** nuk janë marrë nga UÇK-ja deri më 11 prill 1999.

Trupi gjykues ka konkluduar se i burgosuri i pestë serb, i cili u vra me kosë ishte Dragoljub Tanakovic, dhe pastaj ka theksuar disa kontradikta ndërmjet dëshmisë së **A.Z.** dhe shënimit në ditar. **A.Z.** ka thënë se ai nuk ishte vrarë më 18 prill, por dhjetë ditë më vonë, ndërsa shënimi sugjeron se ai ishte një nga katër serbët e qëlluar 10 ditë para serbit të pestë me kosë. Provat mjekoligjore tregojnë se ai ishte trupi i parë i hedhur në varr.⁴⁹

A.Z. po ashtu ka thënë sipas dijenisë se tij më të mirë se serbi ishte i vetmi i vrarë me kosë, ndërkohë që dy trupa u gjetën të kenë vdekur në këtë mënyrë: **D.V.** gjithashtu. Prandaj, Gjykata

⁴⁹ Gjykata Themelore Prishtinë, aktgjykimi, 17 shtator 2013, faqe 111.

Themelore ka gjetur se provat mjeko-ligjore “kundërshtojnë” dëshminë e **A.Z.** në lidhje me kosën.⁵⁰

Gjykata Themelore në fund ka shprehur dyshime rreth përmendjes së telave ligaturës nga **A.Z.** pas gërmimit. Trupi gjykues nuk mund të përjashtojë mundësinë që **A.Z.** ishte në dijeni për këtë dëshmi për herë të parë pasi ishte bërë gërmimi i varrit.

Gjykata e Apelit konkludon se **A.Z.** e kishte parë një grup prej katër serbëve duke i çuar në drejtim të gropës në tokë. Ai nuk e kishte parë personalisht vrasjen e tyre, por ai kishte dëgjuar të shkrepjen e të shtënave me armë. Disa ditë më vonë, ai e kishte parë vrasjen e një të burgosuri të pestë serb me kosë. Dëshmia e tij përputhet me provat e gjetura nga ekspertët mjeko-ligjorë dhe për këtë arsye deklaratat e tij janë të besueshme dhe serioze. Ekzaminimi mjeko-ligjor zbuloi se viktimat serbe të gjetura në vendndodhjen KER01 ishin **D.T., D.V., B.Z., Z.F.** dhe **Z.T.** Veshjet dhe palët e ligaturave përputhen me provat dhe një kosë është gjetur gjithashtu. Dy nga viktimat janë vrarë me të, të tjerët nga plagët e armës. Emrat e katër nga pesë viktimat u gjetën në ditarët e **Z.** Prandaj, Gjykata e Apelit gjen se tregimi i **A.Z.** në këtë pjesë është koherent dhe i besueshëm. Kjo është vërtetuar nga provat materiale, mjeko-ligjore dhe dëshmuese.

Për më tepër, kolegji i apelit nuk sheh ndonjë kontradiktë kur **A.Z.** dëshmoi se ai e kishte parë vrasjen e një të burgosuri me kosë edhe pse ekspertët e forenzikes gjetën dy viktime të vrarë me kosë. **A.Z.** asnjëherë nuk e kishte parë vrasjen e katër të burgosurve serbë; ai vetëm kishte dëgjuar të shtëna armësh. Pastaj, disa ditë më vonë, **A.Z.** e kishte parë me sy vrasjen e një të burgosuri tjetër me kosë. Si përfundim, ai nuk mund ta kishte parë se që të dyja viktimat ishin vrarë me kosë. Si rezultat, në këtë pjesë nuk ka kundërthënie siç është supozuar nga Gjykata Themelore.

Kolegji i apelit konstaton gjen se **A.Z.** e kishte parë me sy vrasjen e Dragoljub Tanaskoviqit. Ditëlindja e tij përputhet me shënimet e ditarit. Për më tepër, ai ishte përshkruar nga **A.Z.** si “i rangut të lartë”. Ekzaminimi forenzik zbuloi se ai kishte gradën ushtarake të një kapiteni dhe kështu ai mund të konsiderohet si oficer ushtarak dhe, në krahasim me viktimat e tjera, si i rangut të lartë.

Në këtë kontekst, Gjykata e Apelit gjen formulimin e Gjykatës Themelore të papërshtatshëm dhe në lidhje me insinuatën se trupi gjykues “nuk mund të përjashtojë mundësinë se **A.Z.** ka kuptuar për këtë provë për herë të parë pas gërmimit të varrit”.⁵¹ **A.Z.** e përmend kosën për herë të parë tetë javë pas gërmimit të varrit. Gjykata e Apelit rikujton se **A.Z.** asnjëherë nuk ishte pyetur

⁵⁰ Gjykata Themelore Prishtinë, aktgjykimi, 17 shtator 2013, faqe 110.

⁵¹ Gjykata Themelore Prishtinë, aktgjykimi, 17 shtator 2013, faqe 106.

ndonjëherë për këtë më parë. Intervista e parë u mbajt më 30 nëntor 2009 dhe kështu pas zhvarrimit. Prandaj, nuk ka asnjë “shtim” nga **A.Z.**, siç është konkluduar nga Gjykata Themelore. Ai thjesht nuk ishte marrë në pyetje për këtë çështje më parë. Në të vërtetë, trupi gjykues ka gabuar në vlerësimin negativ që ai kishte përmendur praninë e një kose, pas zhvarrimit, sepse asnjë deklaratë nuk është regjistruar para zhvarrimit.

Megjithatë, Gjykata e Apelit nuk i sheh ato gabime si vendimtare në vlerësimin e përgjithshëm dhe të plotë të vendimit të Gjykatës Themelore. Dëshmia e **A.Z.** në lidhje me këtë element të rastit është ende e pamjaftueshme që të jetë baza e një dënimi. Edhe prokurori në ankesën e tij thekson se deklarata e **Z.** përmban mospërputhje që nuk mund të shpjegohen pa interpretimin e tyre në dëm të të pandehurve.

Megjithatë, ndërsa kjo pjesë e dëshmisë së **Z.** është përgjithësisht e besueshme, ajo përmban disa të meta substanciale - veçanërisht dyshimet rreth dëshmisë së tij që kanë të bëjnë me datat, që është përmendur nga Gjykata Themelore. Ne nuk mund të harrojmë se në qoftë se ushtarët serbë janë vrarë 20 ditë përpara **A.A.**, atëherë ata janë vrarë në gjysmën e parë të marsit 1999. Pasi ne jemi të sigurt për datën kur **A.A.** ishte liruar nga Kleçka - për shkak se janë dhënë dëshmi nga dëshmitarë të tjerë të cilët u liruan në të njëjtën ditë, si mund të shpjegohet që **D.T.**, **D.V.**, **B.C.**, **Z.F.** dhe **Z.T.** nuk janë marrë nga UÇK-ja deri më 11 prill 1999? **A.Z.** nuk e ka shpjeguar këtë mospërputhje dhe ky dyshim duhet të merret në favor të të pandehurve. Në këtë pikë, kolegji i apelit duhet t’i rikujtoj ankuesit se parimi i përgjithshëm është që t’i japë një respekt në shkallë të konsiderueshme, konstatimit të faktit të trupit gjykues, pasi është trupi gjykues ai i cili i ka dëgjuar dëshmitë dhe është në pozitë më të mirë për të vlerësuar peshën dhe vlerën e tyre.

(8) Vrasja e V.M. dhe N.D.

Prokurori pretendon se sa i përket konstatimit nëse **Z.** i kishte vrarë apo jo të dy serbët, gjykata plotësisht ka injoruar rregullat elementare të arsyetimit gjyqësor. Përfundimi i vlerësimit të provave gjyqësore është “dëshmohet/nuk dëshmohet”. Çuditërisht, gjetja e trupit gjykues është se është “e mundur” që **A.Z.** t’i ketë vrarë dy serbët. Në të kundërtën, prokuroria thekson se nuk ka asnjë dyshim që **A.Z.** t’i ketë vrarë **V.M.** dhe **N.D.**, eshtrat e të cilëve janë nxjerrë pikërisht në vendin e treguar nga dëshmitari.

Dyshimet që rezultuan në një “mundësi” të thjeshtë duket se janë të bazuara në dy argumente kryesore:

- 1) Tregimi i **Z.** është kontradiktor sepse ai i kishte treguar policisë së EULEX-it se nuk e kishte parë se kur ishin vrarë të dy personat, por vetëm i kishte dëgjuar shkrepjet me armë; më vonë në prokurori kishte thënë se ai personalisht i kishte vrarë ata, me urdhrin e **F.L.**
- 2) **Z.** ka thënë se i kishte qëlluar viktimat kur të dytë ishin me shikim prej tij, megjithatë, autopsia ka sqaruar se **M.** i kishte pësuar dy plagë nga qëllimi me armë në anën e tij të djathtë të kokës dhe një pas kokës.

Për sa i përket argumentit të parë, prokuroria parashton se nuk ka asnjë kontradiktë siç pohohet nga Gjykata Themelore. Në deklaratën e tij të parë nuk ka asnjë referencë për përgjegjësinë e tij. **Z.** nuk e ka inkriminuar rrejshëm asnjërin në deklaratën e tij të parë. Ai ishte i gatshëm të rrëfejë për këtë krim, që është e kuptueshme jo vetëm për shkak të implikimeve ligjore, por edhe për shkak të stresit emocional të pranimi të një veprimi të tillë. Kur ai vendosi ta pranojë atë, ai ofroi një dëshmi të saktë, të detajuar dhe të gjallë të asaj që kishte ndodhur. Ai ka inkriminuar veten për vrasjen në një moment kur a) ai ishte i pandehur; b) ai nuk dinte asgjë për mundësinë për t'u bërë dëshmitar bashkëpunues; dhe c) nuk kishte absolutisht asnjë provë kundër tij, ose dikujt tjetër për veprën penale. Të gjitha rrethanat e mësipërme fuqishëm e mbështesin besueshmërinë e **Z.**: rrëfimi është spontan, rrëfimi është shumë i hollësishëm, ngurrimi për të pranuar përgjegjësinë është krejtësisht i kuptueshëm; keqardhja është reale.

Gjykata ka vlerësuar negativisht faktin se **Z.**, në deklaratën e tij të parë, fare nuk e ka përmendur **L.** Sipas pikëpamjes së prokurorit, kjo është e çuditshme. Sipas gjykatës, besueshmëria e **Z.** është zvogëluar për shkak se ai nuk e ka përfshirë **L.** në vrasjen të cilën ai e kishte pranuar.

Për sa i përket argumentit të dytë, prokurori thekson se gjykata e ka bërë një gabim të dukshëm kur ka vërtetuar se në kafkën e **M.** kishte gjurmë të dy plagëve nga shkrepja me armë në anën e djathtë dhe një në pjesën e pasme. Në të vërtetë, këto gjurmë i referohen viktimës së koduar KEQ01/001B, i cili është identifikuar si **N.D.**

Deklarata e **Z.** në këtë pikë (“I kam qëlluar nga një distancë prej dy metrave me pistoletën time Walter të kalibrit 9mm. [...] e kam shkrepur të gjithë karikatorin. Ata ishin me shikim nga unë. Unë thjeshtë kam qëlluar në drejtim të tyre. Nuk me kujtohet ku i kam qëlluar, sepse kam qenë i tronditur”) është absolutisht në përputhje me rezultatet e autopsisë dhe me karakteristikat teknike të armës. Gjurmët e gjetura në trupat e dy viktimave tregojnë se të paktën gjashtë fishekë u qëlluan. **N.D.** ishte goditur të paktën tre herë.

Gjykatat ka neglizhuar aspektet e mëposhtme të njohurive të përgjithshme: 1) një personi të cilit i është drejtuar jo patjetër qëndron pa lëvizur “me shikim nga sulmuesi”; 2) kur gjurmët e

plagëve të shumta janë gjetur në një kufomë ose mbetjet e një kufome, është e pamundur për të vërtetuar rendin kronologjik apo renditjen e të shtënave; dhe 3) kur dikush është qëlluar me ndonjë plumb, sidomos në kokë, trupi i tij/saj në mënyrë të pashmangshme lëviz (për shkak të forcës së ndikimit të plumbit, të dëmit të shkaktuar dhe reagimit subjektiv të viktimës); kjo e bën të pamundur për të vërtetuar në mënyrë të sigurt pozitat reciproke të viktimës dhe sulmuesit me revole gjatë gjithë veprimit.

Provat forenzike, pas vlerësimit të duhur, nuk e kundërshtojnë aspak dëshminë e **Z.** Në të kundërtën, e vërtetojnë fuqishëm.

Në përfundim, prokuroria shprehet se dëshmia e **Z.** në lidhje me vrasjen e dy serbëve është plotësisht e besueshme dhe e vërtetuar fuqimisht nga një seri e elementeve të pavarura. Në qoftë se, ashtu sikur gjykata supozon, **Z.** ishte aq i zemëruar dhe i vendosur për ta dërguar **L.** në burg si një akt i hakmarrjes, ai me siguri do t'i kishte lënë **L.** një pjesë më të madhe në tregimin e tij. Në fakt, **Z.** nuk kishte fare arsye për ta fajësuar veten. Ai thjesht mund të kishte thënë se **L.** i kishte vrarë të burgosurit. Në vend të kësaj, ai vetëm tha se **L.** i kishte thënë atij për t'i vrarë dy viktimat.

Gjykata Themelore erdhi në përfundim se më 30 nëntor 2009 dhe 11 shkurt 2010 **A.Z.** ka dhënë dy dëshmi kontradiktore për vrasjen e **V.M.** dhe **N.D.** Në vitin 2009 ai u tha hetuesve se “gjysmë ore pasi **G.** [sic] dhe **M.** u liruan, i kam dëgjuar disa të shtëna nga dy kallashnikovë nga drejtimi i fshatit Shalë.” Në vitin 2010 ai ka thënë se ai i kishte vrarë dy të burgosur sipas udhëzimeve të **F.L.** Kur ai ishte përballur me këtë mospërputhje më 7 korrik 2011, ai tha se të dy versionet e dëshmisë së tij ishin të vërteta. Ai tha se “fillimisht ata u liruan dhe pastaj ata u vranë, sepse është një shenjë plus afër emrave të tyre.” Megjithatë, ai nuk arriti të shpjegojë kundërthënien e dukshme në dëshminë e tij.

Kur ishte intervistuar më 11 shkurt 2010, duke iu referuar **N.D.** dhe **V.M.**, ai tha se ata ishin “civilë”. Ata nuk ishin. Që të dy ata ishin polic. Ata ishin marrë nga UÇK-ja më 9 shkurt 1999.

Për më tepër, trupi gjykues ka ardhur në përfundim se në bazë të raportit të autopsisë thuhet se **V.M.** ka marrë dy plagë në anën e djathtë të kokës dhe një plagë me armë zjarri në pjesën e pasme të kokës. Në raportin e autopsisë mbi **N.D.** thuhet se ka marrë një plagë në kokë me armë zjarri dhe një plagë me armë në trup. Po të kishte qenë ai aq “i tronditur” siç do ta bënte trupin gjykues të besonte, është për t'u habitur që ai, me sa duket, klinikisht të gjuante në drejtim të njëjës nga viktimat në pjesën e prapme të kokës. Nëse ai nuk e kishte shkrepur të shtënën në fjalë, është për t'u habitur se ai ka harruar të përmend se kush e bëri atë.

Pohimi i tij se ai i kishte vrarë të dy burrat në mënyrë të qartë kishte për qellim shtimin e peshës vërtetësisë së tij dhe pretendimit të tij se ai i kishte vrarë të dy burrat sipas udhëzimeve të **F.L.**

Gjykata e Apelit gjen se më 3 dhjetor 2009 **A.Z.** ishte pyetur në lidhje me **L.G. [N.D.]** dhe **V.M. [V.M.]** të liruar më 5 prill 1999:

AZ: 5 prill 1999 këta dy të burgosur janë liruar nga unë. Unë e kisha pranuar urdhrin nga F.L. për ta bërë këtë gjë.⁵²

AZ: Gjysmë ore pasi G. dhe M. ishin liruar, unë i kam dëgjuar disa të shtëna me armë të shkrepara nga dy kallashnikov nga drejtimi i fshatit Shalë. A.S. kishte mbetur diku me A.K. me lopata vetëm pak kohë përpara se të burgosurit ishin nxjerrë jashtë burgut nga N.K., N.S. dhe B.L. Pak kohë më vonë A.S. erdhi dhe tha: Ne e kryem me ta ata dhe i mbuluam.⁵³

Megjithatë, më 11 shkurt 2010, **A.Z.** ka dhënë një deklaratë kundërthënëse dhe ka pranuar se ai i kishte vrarë të dy të burgosurit:

Unë e konfirmoj por dua të shtoj diçka tjetër. Unë nuk e kam folur të gjithë të vërtetën kur isha intervistuar, sepse në realitet, unë vetë i vrava këta dy serbë dhe dua ta tregoj të gjithë të vërtetën tani.⁵⁴

E kam shkrepur të gjithë karikatorin. Ata ishin me shikim prej meje, nuk me kujtohet se ku i kam qëlluar sepse kam qenë i tronditur.⁵⁵

Kur ishte ballafaquar me këtë kundërthënie në lidhje rreth asaj se kush i kishte vrarë ushtarët, **A.Z.**, më 7 korrik 2011 ka thënë se të dy versionet e dëshmisë së tij ishin të vërteta. Gjykata Themelore thekson se ai nuk arriti të shpjegojë kontradiktat në dëshminë e tij. Gjykata e Apelit pajtohet me trupin gjykues të shkallës së parë. Megjithatë, në deklaratën e tij të parë ai nuk e kishte fajësuar rrejshëm askënd dhe ai ishte shumë ngurrues për të rrëfyer për krimin, e cila sipas mendimit të Gjykatës së Apelit është krejtësisht të pakuptueshme. Nuk ka pasur kurrfarë implikimi ligjore rreth tij, pasi që ai kishte vendosur tashmë për të dëshmuar për ato fakte.

Gjatë marrjes së tij në pyetje, **A.Z.** tha: *Unë nuk e kam folur të gjithë të vërtetën kur isha intervistuar, sepse në realitet, unë vetë i vrava këta dy serbë dhe tani dua ta tregoj të gjithë të vërtetën.⁵⁶*

⁵² Deklarata në policinë e EULEX, **A.Z.**, 3 dhjetor 2009, pika 85.

⁵³ Deklarata në policinë e EULEX, **A.Z.**, 3 dhjetor 2009, pika 86.

⁵⁴ PSRK, procesverbal i dëgjimit të dyshuarit në hetim, **A.Z.**, 11 shkurt 2010, f. 11.

⁵⁵ PSRK, procesverbal i dëgjimit të dyshuarit në hetim, **A.Z.**, 11 shkurt 2010, f. 12.

Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje më 7 korrik 2011, **A.Z.** ka dëshmuar:

Q. Ju i keni thënë PP kur ishit pyetur “perse keni ardhur në EULEX”, ju keni thënë “për ta treguar të vërtetën”. A ju kujtohet ta keni thënë këtë?

AZ. Po.

Q. Nëse kjo është arsyeja që ju keni ardhur për ta dhënë rrëfimin tuaj, kur ju ka lindur kjo dëshirë e re për të treguar të vërtetën?

*AZ. Nga momenti kur e kam larguar idenë për ta vrarë **F.**, e kam dorëzuar armen time, kam qenë i paarmatosur dhe më pas unë gjithmonë kam menduar që të arrij një përfundim me marrëveshje.*

Q. Nga ai moment iu keni përkushtuar të vërtetën?

AZ. Po

Q. Të gjithë të vërtetën, a është kështu?

AZ. Po

Q. Të gjithë të vërtetën dhe asgjë pos të vërtetës?

AZ. Po

Q. Atëherë perse keni gënjer për mos vrasjen e dy serbeve?

AZ. Nuk jam përpjekur që ta fsheh këtë por po mendoja nëse do të kishte qenë më mirë që t'i tregoja PP apo gjykatës.⁵⁷

Duke marrë parasysh dhe analizuar me shumë kujdes provat materiale, dhe duke parë shumë mospërputhje në deklaratat e **Z.** në këtë drejtim, ky përfundim në asnjë mënyrë nuk zhvlerësohet nga ekzaminim mjeko-ligjor dhe autopsia. Gjykata e Apelit gjen se eshtrat e **V.M.** dhe **N.D.** u gjetën në vendndodhjen KEQ01. Raporti i autopsisë për **V.M.** tregon të shtëna armësh në kokë dhe në trup, raporti i autopsisë për **N.D.** zbulon të shtëna armësh në kokë, konkretisht, tre të shtëna armësh, duke përfshirë një në pjesën e prapme të kokës. Gjykata Themelore kishte gjetur se në raportin e autopsisë lidhur me **M.** thuhet dy plagë në anën e djathtë të kokës dhe një plagë në pjesën e pasme me armë zjarri. Për **D.**, autopsia tregon një plagë në kokë dhe një plagë në

⁵⁶ PSRK, procesverbal i dëgjimit të dyshuarit në hetim, **A.Z.**, 11 shkurt 2010, f. 11.

⁵⁷ PSRK, procesverbal i dëshmitarit bashkëpunues, dëgjim hetimor, **A.Z.**, 7 korrik 2011, pika 327-332, faqe 24.

trup. Këto elemente, të vlerësuara në nivel të përgjithshëm, e lejojnë kolegjin a apelit për të arritur në përfundimin se **A.Z.** mund t'i kishte vrarë dy të burgosurit.

Megjithatë, kolegji i apelit pajtohet me Gjykatën Themelore se **Z.** ka ofruar dy rrëfime kontradiktore për vrasjen e **V.M.** dhe **N.D.**. Është krejtësisht e vërtetë se në vitin 2009 ai iu kishte thënë hetuesve “*gjysmë ore pasi ishin liruar G. dhe M., unë i kam dëgjuar disa të shtëna nga dy kallashnikovë nga drejtimi i fshatit Shalë.*” Në vitin 2010, ka thënë se ai i kishte vrarë dy të burgosurit sipas udhëzimeve të **F.L.** Është gjithashtu e vërtetë se kur është ballafaquar me këtë mospërputhje më 7 korrik 2011 ai tha se të dy versionet e dëshmisë së tij ishin të vërteta - e cila është thjesht e pamundur, dhe gjithashtu është e vërtetë se ai nuk kishte arritur të shpjegonte kontradiktat e qarta në dëshminë e tij. Këto kontradikta, dhe po ashtu përfshirja e vazhdueshme e **L.** në çdo vepër e cila ishte raportuar nga ana e tij, i bëjnë deklaratat e tij jo të besueshme dhe jo serioze.

(9) Vrasja e A.A.

Gjykata e Apelit thekson se emri i **A.A.** është përmendur në ditar /012 f. 2. Kjo është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm se ai ishte sjellë në burgun e Kleçkës më 21 mars 1999, dhe ishte liruar më 2 prill 1999. **A.Z.** dëshmoi se një ditë pas lirim të tij, ai u arrestua përsëri dhe u vra në afërsi të fshatit Kleçkë. Ai dëshmoi se e kishte parë vrasjen e **A.A.** nga një distancë prej 50 metra. Ai ishte qëlluar nga **N.K.** dhe **N.K.** të cilët kishin qëlluar me AK47. Ai dëshmoi se përveç “**V.D.**”, **N.S.** ishte i pranishëm po ashtu, por se ai nuk e kishte parë nëse ai kishte qëlluar me armë.⁵⁸

A.Z. dëshmoi se “...rreth 20 ditë para vrasjes së **A.A.**, kanë qenë katër serbë të ekzekutuar në atë vend të cilin më herët ia kishte treguar hetuesve të EULEX-it..” Ai pastaj tregoi se nuk e kishte parë trupin për shkak se nuk kishte guxuar të shkonte.⁵⁹

Në përfundim, Gjykata e Apelit konstaton se dëshmia e **A.Z.** është e besueshme për aq sa ajo konfirmon se **A.A.** ishte vrarë. Kjo pastaj përputhët me datat në ditarin e tij. Megjithatë, dëshmia e tij ku të pandehurit përfshihen si kryes të veprës nuk mund të provohet si e besueshme dhe serioze. Ai nuk ka dhënë ndonjë detaj rreth këtij krimi. Duke pasur parasysh distancën, e cila ishte treguar prej tij, prej vendit ku ndodhej nga vendi ku ka ndodhur krimi, nuk ka prova të mjaftueshme për të konkluduar se **N.K.**, **N.K.**, **R.M.** dhe **N.S.** e kanë kryer veprën penale.

⁵⁸ PSRK, procesverbal i dëgjimit të dyshuarit, **A.Z.**, 9 shkurt 2010, faqe 25; Deklarata në polici të EULEX-it, **A.Z.**, 3 dhjetor 2009.

⁵⁹ PSRK, procesverbal i dëgjimit të dyshuarit, **A.Z.**, 9 shkurt 2010, faqe 26.

(10) Vrasja e Sh.A. dhe Y.G.

Në lidhje me vrasjen e **Sh.A.** dhe **Y.G.**, Gjykata e Apelit gjen se më 30 nëntor 2009 **A.Z.** ka thënë:

*I.G.: Nga fshati Piran. Ka punuar në MUP në Prizren. I pranuar në Kleçkë 16.02.1999. Ai ishte nxjerrë nga burgu i Kleçkës nga **A.K.**, **N.K.** dhe **N.K.** Më pak se gjysmë ore më vonë, kam dëgjuar disa të shtëna të shkrepura me AK 47 dhe kam menduar se **GJAFIQI** ishte vrarë”. “Ditën tjetër kam shkuar për ta parë vendin me dhe të njomë (lokacioni i parë, varri i dytë). Vendi quhet Livadhi i Canit. Në faqe 3 të ditarit tim është data e lirim, p.sh., 03.04.1999. Ka një shenje + para emrit, që nënkupton se ai ishte vrarë.⁶⁰*

S.A.: Drejtor i burgut nga Mitrovica. I burgosur më 21.03.1999. Në faqe 3 të ditarit tim është data e lirim, p.sh., 03.04.1999. Ka një shenje + para emrit, që nënkupton se ai ishte vrarë. Ai ishte nxjerrë jashtë burgut në po të njëjtën kohë me Gjafiqin.⁶¹

Më 9 shkurt 2010, ai tha se ata ishin marrë nga **N.K.**, **N.K.**, **N.S.** dhe ka theksuar:

*Nuk jam i sigurt nëse **A.K.** ishte në grupin që i mori të burgosurit nga aty.⁶²*

Gjykata Themelore konsideroi se kjo ishte një kundërthënie, pasi që më 30 nëntor 2009 “ai dukej i sigurt” se **A.K.** ishte atje, ndërsa më 9 shkurt 2010, ai tha se me veturë i çuan të burgosurit drejt maleve, ai nuk e përmendi të ketë dëgjuar të shtëna armësh, dhe se ata i kishin thënë atij se i kishin vrarë ata.⁶³

Gjykata e Apelit konstaton se dëshmia e **A.Z.** përputhet me shënimet e ditarit. Emri i Sherafedin Ajetit është i renditur në ditar /012 f. 2 me shënimin e mëposhtëm: I ndaluar prej 21.03.1999, i liruar më 03.04.1999. Në faqe 3 **S.** Mitrovic është i renditur me një shenjë “+” dhe me datën 3 prill 1999.

Emri i **I.G.** [**I.G.P.**] figuron në ditar në /012 në faqe 1 me informatën: I pranuar më 16.02.99, i liruar më 03.04.99. Në faqe 3 “edhe imeri piranë” figuron me një shenjë “+” dhe data 3 prill 1999. Më 30 nëntor 2009 **A.Z.** kishte treguar se shenja “+” do të thoshte se i burgosuri ishte vrarë.

Duke marrë parasysh ato që u thanë më lart, Gjykata e Apelit konstaton se dëshmia e **A.Z.** është pjesërisht e besueshme dhe e mbështetshme sa i përket ndalimit të **Sh.A.** dhe **Y.G.** në objektin e

⁶⁰ Deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit, **A.Z.**, 30 nëntor 2009, f. 11, pika 60.

⁶¹ Deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit, **A.Z.**, 30 nëntor 2009, f. 11, pika 62.

⁶² PSRK, procesverbali i dëgjimit të të dyshuarit gjatë hetimit, **A.Z.**, 9 shkurt 2010, f. 24.

⁶³ Gjykata Themelore në Prishtinë, Aktgjykimi, 13 shtator 2013, f. 97 dhe 113.

burgut në Kleçkë dhe vrasjes më 3 prill 1999. Megjithatë, Kolegji i Apelit nuk e gjen dëshminë e **A.Z.** të mbështetshme për sa i përket asaj që ai e përfshin njërin ose të gjithë të pandehurit në kryerjen e krimeve. Siç u përmend më lart, ai nuk ka dhënë asnjë detaj në lidhje me këtë krim. Ai nuk ka thënë asgjë përveç deklaratës se **N.K.**, **N.K.**, **N.S.** i kishin marrë ata të burgosur, por ai nuk i kishte parë të pandehurit duke i vrarë ata. Mungesa e këtyre detajeve krijon dyshime të cilat duhet të interpretohen në favor të të pandehurve.

(11) S.D.

Sipas Prokurorisë, Gjykata Themelore iu ka dhënë vlerë negative disa kundërthënieve në dëshminë e **Z.** sa i përket **S.D.**, gjyqtarit ushtarak gjatë luftës, si dhe rrëfimit të **B.K.**, një ish-komandanti i cili ishte dënuar me vdekje.

Prokurori beson se nuk ka dyshim se **Z.** dhe **D.**, në cilësitë e tyre të ndryshme, kishin pasur kontakt me njëri-tjetrin gjatë luftës. **Z.** kishte pasur në posedim të tij një numër dokumentesh që kishin të bënin me burgun (përfshirë listat e të burgosurve dhe vendimet e nënshkruara të Gjykatës të cilat ishin njohur edhe nga **D.**). **Z.** kishte dhënë përshkrim fizik të detajuar dhe të saktë të **D.** (*ai ishte njeri i mirë dhe si baba për mua*). **D.** i kujtohet emri i vërtetë i **Z.** dhe pseudonimi i tij gjatë luftës.

Është e vërtetë se **Z.** ishte ngatërruar në lidhje me identitetin e **P.U.** Megjithatë, dy prej bashkëpunëtorëve më të ngushtë të **S.D.** gjatë luftës dëshmuuan se, a) ata nuk e dinin nëse **D.** kishte pseudonim, b) të gjithë e njihnin atë si **S.**, c) ata nuk e njihnin askë me emrin **P.U.** Përfundimi i arsyeshëm është se përdorimi që **D.** i ka bërë e atij pseudonimi ishte mjaft i kufizuar, dhe në çdo rast, ai nuk ishte emri me të cilin e njihnin njerëzit. Nuk ka asnjë kundërthënie reale në dëshminë e **Z.**

Nuk është kundërthënëse se **Z.** nuk dëshironte ta dërgonte personin e dënuar te **D.**, dhe gjeti një zgjidhje që nuk do ta ekspozonte atë. Në fakt, pasi **Z.** e dërgoi të burgosurin tek ai, **D.** e liroi **K.** **D.** dëshmoi se, a) edhe pse askush nuk ndërhyri në punën e tij, jo të gjithë në kuadër të UÇK-së ishin të kënaqur me vendimin e tij për të mos ekzekutuar **K.**; dhe b) koordinatori i burgut kishte shqetësime në lidhje me rastin **K.**, aq shumë saqë, siç është vënë në dukje tashmë, **D.** kishte shkuar në burg që personalisht ta siguronte atë. Nuk ka kundërthënie në deklaratat e **Z.**

Gjykata Themelore erdhi në përfundimin se përshkrimi i dhënë nga **A.Z.** i marrëdhënieve të tij me **S.D.** duket mjaft i zbrazët. **S.D.** dhe **P.U.** ishin një dhe po i njëjti person. **S.D.** dha dëshmi se **P.U.** ishte emri që ai përdorte për ta fshehur identitetin e tij të vërtetë. Për më tepër, është e

çuditshme që **A.Z.** do të refuzonte urdhrin për ta çuar **B.K.** pikërisht para asaj gjykate. **A.Z.** mori një urdhër nga **S.D.** që t'ia sillte **B.K.**, atij. Megjithatë, ai tha se ai e kishte refuzuar, duke nënshkruar në pjesën e prapme të urdhrin se ai nuk mund ta ekzekutonte urdhrin. Ai tha se disa ditë më vonë, ai kishte shkuar për ta takuar **S.D.** dhe i kishte thënë atij se ai nuk ishte i gatshëm të “merrte plumb” për **B.K.** **F.L.** i kishte thënë atij: *Nëse e liron këtë unë do të të vras. Ky duhet të ekzekutohet.* Duke iu referuar rastit kur ai kishte refuzuar që ta çonte **B.K.** te **S.D.**, **A.Z.** dha dëshmi se **S.D.** më pas i kishte dërguar katër policë ushtarake për ta marrë **B.K.** Në rastin e Prokurorisë, policia ushtarake e ngarkuar me shoqërimin e **B.K.** për tek **S.D.** ishin nën komandën e **F.L.** Këto rrëfime të kësaj ngjarje nga ana e **A.Z.** qartazi nuk përputhen. **A.Z.** nuk pranoi të vepronte në përputhje me urdhrin që ta çonte **B.K.** para gjykatës ushtarake, sepse kishte frikë nga reagimi i **F.L.**, pas së cilës **S.D.** e dërgoi policinë ushtarake që ta merrte atë. **S.D.** është pyetur nëse **A.Z.** kishte deklaruar ndonjëherë se ai nuk donte të “merrte plumb” për Kuqin. Në përgjigje ai tha: “Jo. Asnjëherë.”

Gjykata e Apelit, ashtu si edhe **G.** e **Q.**, gjen se marrëdhëniet në mes të **S.D.** dhe **A.Z.** ishin sipërfaqësore. **A.Z.** nuk ishte në gjendje të jepte një përshkrim fizik të qartë, të detajuar dhe të saktë të **D.** përveç vërejtjes së përgjithshme se “... ai ishte njeri i mirë dhe si baba për mua ...”. Ekziston edhe një kundërthënie kur **S.D.** dëshmoi se ai e mbante “mend Murrizin shumë mirë”, por ai nuk mund ta lidhte emrin e **A.Z.** me këtë fytyrë. Në të vërtetë, nuk ka nevojë që Kolegji i Apelit të elaborojë më tej për këtë çështje. Megjithatë, Kolegji vëren mospërputhjen e mëtejshme sa i përket asaj se kur **A.Z.** dëshmoi se **D.** ishte “si baba”. Ai tha se kur u përgjigj në pyetjen nëse ai e njohte **P.U.**:

P. Ju thatë se ai është i moshës rreth 30-35 vjeç?

A.Z. Kjo është ajo çfarë unë mendoj.

Kur avokati mbrojtës Karim Khan e ballafaqoi **A.Z.** se **S.D.** është **P.U.**, dhe nëse **S.** ishte duke gënjyer, **A.Z.** tha se ai nuk gënjente. Ai dha një shpjegim: *është e mundur nga personi që e kam marrë vendimin, nga P.U., se personi që erdhi me atë, unë mendova se ishte nga P.U. sepse unë nuk e mora atë drejtpërdrejt nga S.D.* Ky fakt pa dyshim e zvogëlon kredibilitetin e **A.Z.** Ai tha se ai e njohte atë si “.....si baba për mua” por ai nuk e dinte se **S.D.** ishte **P.U.**

Sa i përket **B.K.**, Gjykata e Apelit vjen në përfundim se ai ishte i burgosur në objektin e burgut në Kleçkë. Ai ishte dënuar nga **G.U.** e udhëhequr nga **S.D.**, i cili e kishte dënuar atë me vdekje. Gjersa ai ishte i burgosur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, **A.Z.** i ishte kërkuar që ta sillte atë tek **D.** Kolegji i Apelit gjen se **A.Z.** nuk është kredibil kur dëshmoi se ai ishte kërcënuar nga **F.L.** me fjalinë: *Nëse e liron këtë unë do të të vras. Ky duhet të ekzekutohet.* Duke marrë

parasysh këto më lart, është krejtësisht e pakuptueshme se pse **Z.** kishte shqetësime lidhur dërgimin e të burgosurit, pasi ai besonte se do të ballafaqohej me një reagim shumë të ashpër nëse nuk do ta bënte këtë, gjë që përfshin madje se edhe ai vetë do të vritej. Më tej, i burgosuri duhej të dërgohej jo te **L.** por te **D.** (**S.D.** u pyet nëse koordinatori i burgut kishte refuzuar ta transferonte atë nga burgu në **G.**, ai u përgjigj se atij nuk i kujtohej). Si përfundim, ekziston një kundërthënie e qartë në deklaratat e **Z.** Kolegji i Apelit gjen se jo vetëm që është e çuditshme, por e pabesueshme që **A.Z.** kishte arsye të forta që të mos e dërgonte **B.K.** te **S.D.** Nuk ka shpjegim lidhur me atë se pse **A.Z.** ishte i shqetësuar lidhur me pasojat e veprimit të tij. **S.D.** ishte gjyqtar ushtarak, që janë njerëz të nderit, ai ishte po ashtu “...njeri i mirë dhe si baba ...”, dhe kështu sjellja e **Z.** nuk mund të shpjegohet në mënyrë racionale. Duke marrë parasysh ato që u thanë më lart, Gjykata e Apelit vëren se ka shumë kundërthënie në deklaratat e **Z.** në lidhje me **S.D.** dhe **B.K.**, pajtohet me vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë për këtë çështje dhe e konfirmon atë.

(12) Ekzistimi i rrahjeve sistematike në Kleçkë.

Gjykata Themelore erdhi në përfundimin se, gjersa të ndaluar të caktuar i ishin nënshtruar keqtrajtimit, nuk ka prova të keqtrajtimit sistematik të të ndaluarve mbi baza arbitrare. Deklaratat e dëshmitarit nuk janë të mjaftueshme për të nxjerr përfundim se për shkak se ata ishin të ndaluar në Kleçkë, ata do të ishin nën një frikë të vazhdueshme, se do t’i nënshtroheshin abuzimit fizik ose vdekjes. Duke marrë parasysh provat e mësipërme, trupi gjykues gjeti se kushtet e paraburgimit në vetvete nuk përbëjnë trajtim mizor.⁶⁴

Gjykata Themelore më tej vërejti se nëse një sjellje e caktuar përbën trajtim mizor është çështje e faktit që duhet të vërtetohet rast pas rasti.⁶⁵ Në këtë aspekt, në Aktakuzë përmenden individë të cilët i janë nënshtruar trajtimit çnjerëzor; ish-drejtori i burgut **S.A.**, ish-polici **Y.G.**, tre vëllezërit Bali, Elmi dhe **N.K.**, civilë anonimë, dëshmitari H dhe vëllai i tij, pesë ushtarakët serbë **D.T.**, **D.V.**, **B.C.**, **Ž.F.**, **Ž.T.**, **V.M.** dhe **N.D.** Provat e paraqitura nga prokurori tregojnë se ka mundësi që individë të tjerë të caktuar t’i jenë nënshtruar trajtimit mizor.⁶⁶

Gjykata e Apelit pajtohet me Gjykata Themelore, dhe vëren se nuk është provuar përtej dyshimit të bazuar se rrahjet kanë ndodhur në objektin e burgut në Kleçkë. Dëshmitari D ka dëshmuar se ai ishte keqtrajtuar disa herë. Ushtarët hynin në dhomën e tij dhe e rrihnin. Ishin rreth gjashtë të

⁶⁴ Gjykata Themelore në Prishtinë, Aktgjykimi, 13 shtator 2013, f. 163.

⁶⁵TPNJ, *Prokurori kundër Fatmir Limaj, Haradin Bala, Isak Musliu*, Aktgjykimi nga Gjykimi, 30 nëntor 2005, para. 232.

⁶⁶ Gjykata Themelore në Prishtinë, Aktgjykimi, 13 shtator 2013, f. 164.

burgosur të tjerë, të gjithë ishin shqiptarë. Ata ishin në gjendje të keqe dhe mund të shihej se ata rriheshin. Ushtarët erdhën në dhomën e tij dhe ai ishte dëshmitar i rrahjes së “Shero-s”, një të burgosuri tjetër. Rrahjet ndodhën rreth datës 20 mars 1999. Dëshmitari V dha dëshmi se një mashkull i ri ishte rrahur nga ushtarët e UÇK-së. Dëshmitari anonim M dëshmoi se ai ishte rrahur në objektin e burgut në Kleçkë. Për më tepër, ai kishte dëgjuar britma nga kati 1-rë. Dëshmitari L konfirmoi se një i burgosur ishte rrahur keq. Sipas thashethemeve, 5 ose 6 ushtarë ishin rrahur keq në Kleçkë. Dëshmitari **N.R.** e ka konfirmuar se ai i kishte britmat e të burgosurve. Ai ka dëshmuar se një ditë ai kishte dëgjuar britma shumë të frikshme nga kati më sipër, dhe ai kishte menduar se po rriheshin dy të burgosurit. Dëshmitari C ka konfirmuar se roja i kishte marrë të burgosurit për t’i marrë në pyetje dhe i kishte rrahur ata. Të burgosur të tjerë kanë thënë se ata ishin rrahur nga dikush i vogël me syze dhe se të gjithë ata me të cilët ishin në qeli ishin rrahur keq.

Nga sa u tha më sipër është shumë e qartë se shumë rrahje ndodhën në qendrën e paraburgimit. Megjithatë, dhe në kundërshtim me gjetjet e gjykatës së shkallës së parë, Kolegji i Apelit mendon se ato rrahje kishin arritur në shkallë shqetësuese, gjë që konsiderohet si sistematike në lidhje me të burgosur të caktuar. Kolegji është i bindur se rrahjet në qendrën e paraburgimit në Kleçkë ishin pak a shumë një trajtim i zakonshëm për t’i frikësuar ose për t’i thyer mentalisht të burgosurit e caktuar.

Ky përfundim në asnjë mënyrë nuk zhvleftësohet nga deklaratat e **S.D.** Ai dëshmoi se të burgosurit nuk janë ankuar. Megjithatë, **A.Z.** ka thënë se **D.** nuk ishte në dijeni për praninë e disa të burgosurve, se ai nuk i kishte intervistuar të burgosurit serbë, dhe në përgjithësi ai nuk është marrë me civilë, dhe se ai nuk i kishte parë të burgosurit serbë në shtëpitë e djegura.⁶⁷

Megjithatë, **A.Z.** tha se serbët e ndaluar mbaheshin në shtëpi vetëm për një ose dy orë, ndoshta një natë, dhe pastaj dërgoheshin në bodrumet e dy shtëpive të djegura 100-200 metra tutje.⁶⁸ **A.Z.** tha se kishte intervista të paligjshme ose jozyrtare gjatë të cilave të ndaluarit rriheshin dhe torturoheshin. Andaj, fakti se **S.D.** kishte dëshmuar se ai nuk ishte në dijeni të ndonjë keqtrajtimi të të burgosurve nuk i sfidon dëshmitë e një numri dëshmitarësh që konfirmojnë se në Kleçkë kanë ndodhur rrahje sistematike.

Në fund, Gjykata e Apelit vëren se nuk ka prova të mjaftueshme që provojnë përfshirjen e ndonjërit nga të pandehurit në rrahje. Përveç **A.Z.**, asnjëri nga të dyshuarit nuk ishte në gjendje të japë dëshmi se njëri ose të gjithë të pandehurit kishin marrë pjesë aktivisht në rrahje. Dëshmitari V kishte dëshmuar se ai ishte marrë në pyetje nga **F.L.**, **H.S.** dhe **S.D.** Megjithatë, ai nuk kishte

⁶⁷ PSRK, procesverbali i dëgjimit të të dyshuarit në hetim, **A.Z.**, 9 shkurt 2010, f. 15, 17, 18, 20.

⁶⁸ Raport, deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit **A.Z.**, 30 nëntor 2009, f. 9.

parë ndonjë përfshirje të këtyre personave në rrahje. Dëshmitari **U.K.** dëshmoi se pjesëtarët e policisë ushtarake si **A.Z.**, **F.L.**, “**F.**”, dhe “**N.**” erdhën dhe u përkujdesën për të burgosurit që t’i vendosnin ata në bodrum. Përfshirja aktive në rrahje nuk ishte dëshmuar aspak.

Duke marrë parasysh ato që u thanë më lart, Gjykata e Apelit vjen në përfundim se vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë në lidhje me rrahjet sistematike në Kleçkë siç detajohet në aktakuzë është korrekt dhe duhet të konfirmohet.

(13) Hierarkia dhe zinxhiri komandues në burgun e Kleçkës.

Gjykata e Apelit gjen se provat janë jo konsistente sa i përket hierarkisë dhe zinxhirit komandues në burgun e Kleçkës. Nga provat nuk është e qartë se kush e kishte komandën më të lartë dhe të drejtpërdrejtë mbi qendrën e paraburgimit.

U.K. ka dhënë dëshmi se policia ushtarake qëndronte në katin e sipërm. Ai e kishte parë **F.L.** disa herë në vitin 1999 në Kleçkë. Ai ishte i vendosur në ndërtesën ku ishte kuzhina. Sa i përket “**B.F.**”, ai ka dëshmuar se ai ishte në gjendje ta hetonte këdo që ai dëshironte. Ai ishte një person shumë i pushtetshëm. Ai përkiste grupit të **F.L.** Në pjesën e parë të prillit të vitit 1999, ai kishte parë katër eprorë serbë të silleshin në Kleçkë. Pjesëtarët e policisë ushtarake si **A.Z.**, **L.**, “**F.**”, “**F.**” dhe “**N.**” dolën jashtë, u përkujdesën për ta dhe i vendosën në bodrum. Atij i kujtohen këta emra për shkak se ata kishin pozita më të larta. Ai tha se **A.Z.** ishte roje në burg.

S.D. deklaroi se **A.Z.** ishte përgjegjës për menaxhimin e përditshëm të burgut, dhe i referohet si “drejtori”, pa e dhënë identitetin e tij (ai më vonë e konfirmoi në Gjykatë se në të vërtetë ai ishte personi i njëjtë, domethënë **A.Z.**). Ai më tej deklaroi se të burgosurit ishin nën kontrollin fizik të policisë ushtarake. Sa i përket **L.**, ai dëshmoi se ai ishte i vetmi (me fuqinë që ta lironte dikë) i cili e kishte fuqinë e tillë, pasi që ai ishte shef i policisë ushtarake. Lidhur me “**F.**” ai tha, “Unë e di se ai ishte polic ushtarak. E kam parë në Kleçkë. Ai ka qenë edhe në Shtab. Unë do t’i lëshoja udhëzime atij se si të vepronte dhe se si policia duhej të sillej”. Ai shumë shpesh e kishte parë “**F.**” në Kleçkë.

Megjithatë, Gjykata e Apelit vëren mospërputhje. Në dëshminë e tij para Gjykatës më 23 prill 2013, **S.D.** shpjegon se ai ishte keqkuptuar gjatë deklaratës së tij para PSRK-së në lidhje me përfshirjen e **F.L.** Ai specifikoi se burgu ishte nën shërbimin ligjor dhe Gjykatës ushtarake, e jo nën policinë ushtarake. Ai po ashtu e minimizoi rolin e **N.K.**

Dëshmitari B ka dëshmuar se **N.K.** ishte shefi i policisë ushtarake. Ai deklaroi se **A.Z.** ishte mbikëqyrës i burgut.

Dëshmitari G tha se Komandant në Kleçkë ishte **H.S.** - Topi.

Dëshmitari H dëshmoi se ai ishte arrestuar, ai e cekti se ushtarët e UÇK-së po prisnin që të vinte komandanti i tyre. Komandanti ishte shumë i ri, i moshës rreth 25-30 vjeçare. Ai e përshkroi "**B.**" me flokë të errëta, i gjatë 1.80 m, dhe një tip atleti.

Dëshmitari C dëshmoi se "**F.**" e kishte marrë atë në pyetje. Ai më vonë ishte liruar nga Kleçka nga **A.Z.** Ai mendonte se **A.Z.** ishte drejtor i qendrës së paraburgimit.

Dëshmitari M dha dëshmi se ai ishte marrë në pyetje në Kleçkë nga **S.S.**, i cili foli me **N.**, i cili i tha gjithkujt (përfshirë gjyqtarin) se të burgosurit ishin përgjegjësi e **A.Z.** dhe se ai do t'i lironte ata, dhe më pastaj ata u liruan. Kampi ishte nën përgjegjësinë e **F.L.** sepse njësitë ishin nën kontrollin e tij. Megjithatë, ai nuk e dinte se kush ishte përgjegjës për burgun. Ai deklaroi: "E di se në Kleçkë ishte Shtabi i Brigadës 121 dhe me sa di unë **F.L.** ishte në krye të Brigadës."

Dëshmitari L dha dëshmi se kur u mor në pyetje nga **O.** në Kleçkë, "**N.**" e kishte ndërprerë marrjen në pyetje dhe e kishte liruar atë.

Dëshmitari V dëshmoi se komandantët e brigadës nga rangu më i lartë e deri te rangu më i ulët në vitin 1998 ishin: **F.L.** dhe **H.S.** Ai ishte arrestuar dhe transportuar në Kleçkë, ishte maltretuar rrugës nga pesë ushtarë të policisë ushtarake, se ai kishte qëndruar 56 ditë në burg dhe se atje nuk ishte maltretuar, dhe se ai e identifikoi "**B.H.**" si roje i burgut i quajtur "**G.**". Ai dëshmoi se komandant ishte "**M.**" (**A.Z.**). Gjatë ndalimit të tij ai ishte marrë në pyetje nga **F.**, **H.S.**, **S.D.** dhe "**M.**".

Dëshmitari **N.M.** i identifikoi në tabelën me foto 2A, fotografia 6, **N.K.** si pjesëtar të policisë ushtarake. Ai mendon se ai ishte Komandant në Brigadën 121.

B.Z. dëshmoi se prej janarit deri në prill 1999 **F.L.** ishte shef i tërë policisë ushtarake të UÇK-së. Komandant në Kleçkë ishte **H.S.** i Brigadës 121. Atij i kujtohet "**B.F.**" si pjesëtarë i Brigadës 121 nën komandën e **H.S.**, dhe se ai e kishte parë atë në shtab në Kleçkë. Sa i përket "**N.**", ai dha dëshmi se ai ishte pjesëtar i Brigadës 121 nën komandën e drejtpërdrejtë të drejtorisë së policisë ushtarake që udhëhiqej nga **F.L.**, dhe ai e identifikoi "**F.**" si epror.

A.O. dha dëshmi se **H.S.** ishte Komandant i Brigadës 121.

A.H. dëshmoi se ai ishte administrator i policisë ushtarake të UÇK-së në kuadër të Brigadës 121. Ai ka deklaruar se eprori i tij i drejtpërdrejtë ishte Ukë Gegaj, dhe se **N.K.** ishte më i lartë në zinxhirin komandues se Gegaj.

Sh.B. ishte pjesëtar i Brigadës 121 dhe ushtar i thjeshtë. Ai dëshmoi se mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë ishte **R.K.** dhe pastaj **A.S.** Ai tha se **N.K.** ishte më i lartë në komandë se **A.S.**

Duke marrë parasysh nga sa u tha më sipër, Kolegji i Apelit konstaton se dëshmia është jo konsistente lidhur me atë se kush mbante pozicion të lartë në Kleçkë. Provat nuk e bëjnë të mundur identifikimin, *per se* ose *de facto* ose *de jure*, të komandantit, edhe pse Kolegji i Apelit konstaton se dëshmitarët e përmendur më lart janë të besueshëm. Pyetja se kush e kishte komandën mbi Kleçkë është vendimtare për akuzat në Aktakuzë. Pjesërisht është provuar se krimet janë kryer nga pjesëtarët e policisë ushtarake që ishin të vendosur në Kleçkë. Meqë, megjithatë, komandanti dhe hierarkia e qartë nuk mund të përcaktohen, përgjegjësia penale nuk mund t'i caktohet asnjërit prej të pandehurve dhe vendimi i trupit gjykues të shkallës së parë në këtë aspekt është i saktë dhe duhet konfirmohet.

E. Përgjegjësia e komandantit.

Në Pikën 1 të Aktakuzës kundër të pandehurit **N.K.**, ai akuzohet se “... në cilësinë e tij... si komandant, dhe si person që mbante funksionin e përgjegjësive mbi qendrën e paraburgimit të Kleçkës ...”.

Në Pikën 1 të Aktakuzës kundër **F.L.**, ai akuzohet se “si komandant i UÇK-së... dhe si person që ushtronte kontroll të përgjithshëm mbi qendrën e paraburgimit në Kleçkë ...’ me Pikat 2 dhe Pikat 3 **F.L.** akuzohet po ashtu se në cilësinë e tij si komandant i UÇK-së.....”.

Në Pikën 1 të Aktakuzës kundër **N.S.**, ai akuzohet se “... në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së që mbante funksionin e përgjegjësive në kuadër të qendrës së paraburgimit të Kleçkës.....”.⁶⁹

Gjykata e Apelit është pajtohet tërësisht me Gjykatën Themelore se në Aktakuzë nuk supozohet në mënyrë specifike përgjegjësia eprorë, ose komanduese e asnjërit prej të akuzuarve. Në të vërtetë, nuk ekziston asnjë referencë në Aktakuzë sa i përket bazës ligjore mbi të cilën do të mund të bazohet çfarëdo supozimi për përgjegjësinë eprorë. Në aktvendimin e vet të datës

⁶⁹ PSRK, Aktakuza, f. 3, 9, 11.

20 nëntor 2012, Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka dhënë asnjë përcaktim mbi këtë çështje, por në vend të kësaj vendosi ta “lërë çështjen të hapur”.⁷⁰

Gjykata e Apelit konstaton se të pandehurit **N.K., F.L.** dhe **N.S.** janë akuzuar në mënyrë korrekte dhe ndaj tyre është ngritur aktakuza për përgjegjësi eprorë. Me anë të nenit 386 paragrafi 2 të KPPK-së, Gjykata nuk detyrohet me propozimet e paditësit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës. Prandaj, Gjykata ishte i lirë që të vlerësonte nëse përgjegjësia penale e të pandehurve është ose nuk është e tillë që bazohet në përgjegjësinë komanduese, për aq kohë sa ajo është trajtuar si duhet në aktakuzë. Sipas pikëpamjes së Gjykatës, është e mjaftueshme që ngjarjet historike janë përshkruar si duhet në aktakuzë, dhe se ato mund të kuptohen nga Gjykata, si dhe nga i pandehuri se me cilën vepër penale ngarkohet ai. Kolegji nuk ke kundërshton aktakuzën, pasi që ajo ishte e qartë për të pandehurit **N.K., F.L.** dhe **N.S.** se ata ngarkohen me përgjegjësinë komanduese.

Gjykata e Apelit në fillim do t'i trajtojë vërejtjet e përgjithshme për sa i përket kushteve për përgjegjësinë komanduese, dhe pastaj Kolegji do ta vlerësojë secilin të pandehur veç e veç.

(1) Statuti TPNJ-së.

Neni 7 (3) i Statutit të TPNJ-së parasheh kriteret ligjore sa i përket përgjegjësisë komanduese, duke i dhënë kështu fjalës “komandant” kuptim gjyqësor. Për përgjegjësinë sipas nenit 7 (3) të Statutit të TPNJ-së thuhet si vijon:

Fakti që cilido prej veprimeve të përmendura në nenet 2 deri në 5 të këtij Statuti u krye prej një vartësi, nuk e liron eprorin e tij nga përgjegjësia penale në qoftë se ai dinte ose kishte arsye të dinte se vartësi do të kryente ose kishte kryer veprime të tilla dhe eprori nuk mori masat e nevojshme dhe të arsyeshme për parandalimin e veprimeve të tilla ose për ndëshkimin e kryesve të tyre.

(2) Elementet ligjore për përgjegjësinë eprorë.

Sipas jurisprudencës së përcaktuar, tre elemente duhet të provohen para se një person të mund të shkaktojë përgjegjësinë eprorë për krimet e kryera nga vartësit. Për një dënim sipas nenit 7 (3) të Statutit, nevojitet prova se: (i) ka ekzistuar marrëdhënia epror-vartës ndërmjet komandantit (i

⁷⁰ Gjykata Supreme e Kosovës, Aktvendim, 20 nëntor 2012, f. 33.

akuzuari) dhe kryerësit të krimit; (ii) i akuzuari e dinte ose kishte arsye të dinte se krimi do të kryhej ose ishte kryer; dhe (iii) i akuzuari nuk mori masat e nevojshme dhe të arsyeshme për parandalimin e krimit ose për ndëshkimin e kryerësit të tyre.⁷¹

(2.1) Marrëdhënia epror-vartës, funksioni komandues.

Jo vetëm personeli ushtarak por edhe civil mund të jetë përgjegjës për krimet të luftës mbi bazën e përgjegjësisë komanduese. Tribunali Penal Ndërkombëtar për Ruandën, në *rastin Akayesu* në vitin 1998 dhe në *rastin Kayishema dhe Ruzindana* në vitin 1999, dhe Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë në *rastin Delalić* në vitin 1998, e ka pranuar këtë parim. Ai gjendet edhe në Statutin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare. Statutet e Tribunaleve Penale Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë dhe për Ruandën, dhe ai i Gjykatës Speciale për Sierra Leone-n, në aspekte të përgjithshme i referohen “eprorit, ashtu siç bëjnë shumë doracakë ushtarakë dhe legjislacione kombëtare”.

Ky parim njihet dhe pranohet në aktgjykime të ndryshme të Tribunaleve Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë dhe për Ruandën.⁷² Tribunalet e identifikuan pasjen e vërtetë të kontrollit mbi veprimet e vartësve në sensin e aftësisë materiale për ta parandaluar dhe ndëshkuar kryerjen e krimeve, si kriter vendimtar.⁷³ Ideja e njëjtë pasqyrohet në nenin 28 të Statutit të Gjykatës Penale Ndërkombëtare.⁷⁴

Është e nevojshme të merret në konsideratë nocioni i komandës ose autoriteti i eprorit në kuadër të kuptimit të nenit 7 (3) të Statutit para se të merret në shqyrtim çështja specifike e autoritetit *de facto*. Neni 87 (3) i Protokollit Shtesë I të Konventave të Gjenevës të vitit 1949 parasheh:

Palët e larta kontraktuese dhe palët në konflikt i kërkojnë çdo komandanti i cili është në dijeni se vartësit ose personat e tjerë nën kontrollin e tij do të kryejnë ose kanë kryer një shkelje të Konventave ose Protokollin e tij, të iniciojë hapa të tilla sipas nevojës për të

⁷¹ TPNJ, *Prokurori kundër Tihomir Blaškić*, Aktgjykimi, 3 mars 2000, 3 mars 2000, para. 294; TPNJ, *Prokurori Zlatko Aleksovski*, Aktgjykimi, 25 qershor 1999, paragrafët 68, 72, 81, 118.

⁷² ICTR, *Prokurori kundër Clément Kayishema and Obed Ruzindana*, Aktgjykim, 1 qershor 2001, paragrafët 212, 217, 218; TPNJ, *Prokurori kundër Zejnil Delalić dhe të tjerët*, Aktgjykimi i Apelit, 20 shkurt 2001, paragrafët 182-214; TPNJ, *Prokurori kundër Zlatko Aleksovski*, Aktgjykimi, 25 qershor 1999, paragrafët 30, 76, 78, TPNJ, *Prokurori kundër Tihomir Blaškić*, Aktgjykimi, 3 mars 2000, paragrafët 205, 296, 300; TPNJ, *Prokurori kundër Dragoljub Kunarac dhe të tjerët*, Aktgjykimi, 22 shkurt 2001, para. 396; TPNJ, *Prokurori kundër Miroslav Kvočka dhe të tjerët*, Judgment, 2 November 2001, para. 315.

⁷³ Shih, p.sh., TPNJ, *Prokurori kundër Zejnil Delalić dhe të tjerët*, Aktgjykimi, 16 November 2001, para. 354; TPNJ, *Prokurori kundër Zlatko Aleksovski*, Aktgjykimi, 25 qershor 1999, paragrafët 77, 91; TPNJ, *Prokurori kundër Miroslav Kvočka dhe të tjerët*, Aktgjykimi, 2 nëntor 2001, para. 240 (3), 313.

⁷⁴ Statuti i Romës i Gjykatës Ndërkombëtare Penale, neni 28.

*parandaluar shkeljet e tilla të Konventave ose këtij Protokolli, dhe, kur është e përshtatshme të iniciojnë veprime disiplinore ose penale kundër atyre shkelësve.*⁷⁵

Aktgjykimi *Blaskić*, duke iu referuar aktgjykimit nga gjykimi dhe Protokollit Shtesë I, e ka interpretuar kontrollin në aspektin e aftësisë materiale të komandantit që të ndëshkojë:

*Çfarë merret parasysh është aftësia e tij materiale, që në vend të lëshimit të urdhrave ose të marrjes së veprimeve disiplinore mund të përfshijë, për shembull, dorëzimin e raporteve tek autoritetet kompetente me qëllim që të ndërmerren masat e duhura.*⁷⁶

Në aspektin e kuptimit të komandantit ose eprorit siç përcaktohet në nenin 7 (3) të Statutit, Dhoma e Apelit mbajti këtë qëndrim në *rastin Aleksovski*:

*Neni 7 (3) parasheh kriteret juridike për përgjegjësinë komanduese, duke i dhënë fjalës “komandant” një kuptim gjyqësor, në atë dispozita bëhet e zbatueshme vetëm kur eprori me elementin e kërkuar mendor ka dështuar t’i ushtrojë autorizimet e veta që t’i parandalojë vartësit nga kryerja e veprave ose që t’i ndëshkojë ata më pastaj. Kjo domosdoshmërisht nënkupton se eprori duhet të ketë pushtet të tillë para mosushtrimit të tyre nga ana e tij. Nëse faktet e rastit i përmbushin kriteret sa i përket autoritetit të eprorit siç përcaktohen në nenin 7 (3), konstatimi ligjor do të ishte se një i akuzuar është epror brenda kuptimit të asaj dispozite.*⁷⁷

Sipas nenit 7 (3), pra një komandant ose epror është ai i cili e ka pushtetin ose autoritetin qoftë në formën *de jure* ose *a de facto* për ta parandaluar krimin e vartësit ose për t’i ndëshkuar kryerësit e krimit pas kryerjes së krimit. Pushteti ose autoriteti për të parandaluar ose ndëshkuar nuk buron vetëm nga autoriteti *de jure* i dhënë përmes emërimit zyrtar. Në shumë konflikte bashkëkohore, mund të ketë vetëm qeveri *de facto*, të vetëshpallura dhe si rrjedhojë armatat dhe grupet paramilitare *de facto* bëhen vartëse të tyre. Struktura komanduese, e organizuar me nguti, mund të jetë vërtet e çrregullt dhe primitive. Për ta zbatuar ligjin në këto rrethana krijohet vendosmëria e llogaridhënies, jo vetëm e shkelësve individualë por e komandantëve të tyre ose e eprorëve, të cilët, bazuar në prova, i kontrollojnë ata, megjithatë pa autorizim ose emërim formal.⁷⁸

⁷⁵ TPNJ, *Prokurori kundër Zejnir Delalić dhe të tjerët*, Aktgjykimi i Apelit, 20 shkurt 2001, para. 189.

⁷⁶ TPNJ, *Prokurori kundër Tihomir Blaškić*, Aktgjykimi, 3 mars 2000, para. 302; TPNJ, *Prokurori kundër Zejnir Delalić dhe të tjerët*, Aktgjykimi i Apelit, 20 shkurt 2001, para. 190.

⁷⁷ TPNJ, *Prokurori kundër Zlatko Aleksovski*, Aktgjykimi i Apelit, 25 June 1999, para. 76; TPNJ, *Prokurori kundër Zejnir Delalić dhe të tjerët*, Aktgjykimi i Apelit, 20 shkurt 2001, para. 191.

⁷⁸ TPNJ, *Prokurori kundër Zejnir Delalić dhe të tjerët*, Aktgjykimi i Apelit, 20 shkurt 2001, paragrafët 192-193.

Gjykata e Apelit rikujton, si parim i përgjithshëm, se marrëdhënia ndërmjet komandantit dhe vartësit nuk është e thënë që domosdoshmërisht të jetë e drejtpërdrejtë *de jure*. Përgjegjësia komanduese *de facto* është e mjaftueshme si shkak për përgjegjësinë e komandantit.

Është jurisprudencë e përcaktuar se eprori mund të ketë kontroll efektiv mbi personat që kryejnë këto shkelje të së drejtës humanitare ndërkombëtare. Një komandant si rrjedhojë mund të ngarkohet me përgjegjësi penale për krimet e kryera nga personat të cilët nuk janë formalisht vartës të tij të drejtpërdrejtë, për aq kohë sa ai ushtron kontroll efektiv mbi ta. Aftësia për të ushtruar kontroll efektiv është e domosdoshme për të përcaktuar përgjegjësinë eprorë. Pragu që duhet të arrihet në përcaktimin e marrëdhënies epror-vartës për nevojat e nenit 7 (3) të Statutit është kontrolli efektiv mbi një vartës në sensin e aftësisë materiale për ta parandaluar ose ndëshkuar sjelljen penale.⁷⁹

(2.2) Komandanti/eprori e dinte, ose kishte arsye të dinte.

Jurisprudenca po ashtu konfirmon se përgjegjësia komanduese nuk kufizohet në situatat kur komandanti/eprori ka pasur njohuri të vërtetë për krimet e kryera ose që do të kryheshin nga vartësit e tij ose saj, por ajo njohuri konstruktive nuk është e mjaftueshme. Kjo ideja e fundit është shprehur në burime të ndryshme me formulime paksa të ndryshme: “kishte arsye të dinte”,⁸⁰ “kishte informata të cilat duhej t’i kishin bërë të mundur [komandantit/eprorit] të vinte në përfundim në rrethanat në atë kohë”,⁸¹ komandanti/eprori “(për shkak të rrethanave në atë kohë,) duhet të kishte ditur”,⁸² komandanti/eprori ishte “përgjegjës meqenëse ka dështuar ta marrë njohurinë e tillë”,⁸³ dhe komandanti/eprori ishte “penalisht përgjegjës për shkak të pakujdesisë meqë ka dështuar të dijë”.⁸⁴ Këto formulime në thelb përfshijnë konceptin e njohurisë konstruktive.

Në përcaktimin nëse ky standard është arritur ose jo, duhet të merret parasysh në frymën e funksionit komandues të të akuzuarit, nëse kjo vërtetohet. Në të vërtetë, siç u konstatua nga

⁷⁹TPNJ, *Prokurori kundër Zejnir Delalić dhe të tjerët (Rasti-Čelebići)*, Aktgjykimi i Apelit, 20 shkurt 2001, para. 256.

⁸⁰Shih, p.sh., Statuti i TPNJ-së, neni 7 (3); Statuti i TPNR-së, neni 6 (3); Statuti i gjykatës Speciale për Sierra Leone, neni 6 (3); Rregullorja e UNTAET nr. 2000/15, neni 16; Kanada, *Doracaku i LOAC*; Kamboxhia, *Ligji për Gjykimin e Kmerëve të Kuq*; Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së mbi projekt Statutin e TPNJ-së.

⁸¹Shih, p.sh., Protokollin Shtesë I, neni 86 (2) (e miratuar me konsensus); Doracakët Ushtarakë të Kanadasë, Holandës, Zelandës së Re, Suedisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës; Indonezi, Tribunali Ad Hoc mbi të Drejtat e Njeriut për Timorin Lindor, *rasti Abilio Soares*, Aktakuza dhe Aktgjykimi.

⁸²Shih, p.sh., Statuti i GJPN-së, neni 28 (a) (i); Doracakët Ushtarakë të Australisë, Belgjikës, Kanadasë dhe Zelandës së Re; Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjykata Federale e Floridës, *rasti Ford kundër García*, Aktgjykimi.

⁸³Shih, p.sh., IMT (Tokio), *Rasti i Kriminelëve Kryesorë të Luftës*.

⁸⁴Shih p.sh., Kanada, *Ligji mbi Krimet kundër Njerëzimit dhe Krimet e Luftës*.

Dhoma e Gjyqimit të *Aleksovski*, pozicioni komandues i individit *per se* është një tregues i rëndësishëm se ai ka ditur për krimet e kryera nga vartësit e tij.⁸⁵ Treguesit e tjerë janë; “numri, lloji dhe fushëveprimi i veprimeve të paligjshme, koha gjatë të cilës kanë ndodhur veprimet e paligjshme, numri dhe lloji i trupave të përfshira, logjistika e përfshirë, nëse ka të tillë, vendndodhja gjeografike e veprimeve, shtrirja e paraqitjes së këtyre veprimeve, shpejtësia e operacioneve, *modus operandi* e veprimeve të ngjashme të paligjshme, eprorët dhe stafi i përfshirë, dhe vendndodhja e komandantit në atë kohë.”⁸⁶

Kolegji i Apelit e përsërit se Aktgjykimi i Apelit në *rastin Čelebići*, e ka vendosur çështjen e interpretimit të standardit të “kishte arsye të dinte.” Në atë Aktgjykim, Dhoma e Apelit theksoi se “eprori do të jetë penalisht përgjegjës nëpërmjet parimeve të përgjegjësisë eprorë *vetëm nëse informacioni ishte në dispozicion të tij*, të cilat do të vinin atë në dijeni për veprat penale të kryera nga vartësit.” Më tej, Dhoma e Apelit tha se “[p]akujdesia ndaj detyrës për të marrë njohuri të tilla, megjithatë, nuk përfshihet në dispozitën [neni 7 (3)] si një vepër e veçantë, dhe si rrjedhojë eprori nuk është përgjegjës sipas dispozitave për dështimet e tilla, por vetëm për mosmarrjen e masave të nevojshme dhe të arsyeshme për të parandaluar ose për të ndëshkuar.” Nuk ka asnjë arsye që Dhoma e Apelit të ikë nga ai qëndrim. Interpretimi i aktgjyqimit nga gjykimi, nuk është në përputhje me jurisprudencën e Dhomës së Apelit në këtë aspekt dhe duhet të korrigjohet në përputhje me rrethanat.⁸⁷

(2.3) Eprori nuk i ka marrë masat e nevojshme dhe të arsyeshme për ta parandaluar veprën penale ose për ta ndëshkuar kryerësin.

Në *rastin Delalić* në vitin 1998, TPNJ-ja e interpretoi termin “masat e nevojshme dhe të arsyeshme” për t’u kufizuar në masat e tilla pasi që ato janë në kuadër të autorizimeve të dikujt, pasi që askush nuk mund të obligohet të bëjë të pamundshmen.⁸⁸ Sa u përket masave të nevojshme dhe të arsyeshme për të siguruar ndëshkimin e kriminelëve të dyshuar të luftës, Tribunali konstatoi se në *rastin Kvočka* në vitin 2001 se eprori jo domosdoshmërisht duhet të zbatojë ndëshkimin por “duhet të ndër marrë një hap të rëndësishëm në procesin disiplinor”.⁸⁹ Në Aktgjykimin e tij në *rastin Blaškić* në vitin 2000, Tribunali konstatoi se “në disa rrethana,

⁸⁵ TPNJ, *Prokurori kundër Zlatko Aleksovski*, Aktgjykimi, 25 qershor 1999, para. 80.

⁸⁶ TPNJ, *Prokurori kundër Tihomir Blaškić*, Aktgjykimi, 3 mars 2000, para. 307.

⁸⁷ TPNJ, *Prokurori kundër Tihomir Blaškić*, Aktgjykimi, 3 mars 2000, para. 62.

⁸⁸ TPNJ, *Prokurori kundër Zejnil Delalić dhe të tjerët*, Aktgjykimi, 16 nëntor 1998, para. 341-342.

⁸⁹ TPNJ, *Prokurori kundër Miroslav Kvočka*, Aktgjykimi, 2 nëntor 2001, para. 316.

komandanti mund ta ushtrojë obligimin e tij për të parandaluar ose ndëshkuar një vepër duke e raportuar çështjen tek autoritetet kompetente”.⁹⁰

Në Aktgjykimin e tij në *rastin Blaškić* në vitin 2000, TPNJ-ja ka specifikuar, megjithatë, se një komandant duhet t’i japë përparësi, kur ai ose ajo e di ose ka arsye të dijë se vartësit e tij ose të saj do të kryejnë krime, t’i parandalojë ato krime nga kryerja dhe se “ai nuk mund ta kompensojë mosveprimin me ndëshkimin e vartësve më pastaj”.⁹¹

Çfarë i përbën masat [e nevojshme dhe të arsyeshme] nuk është çështje e së drejtës materiale, por e provave; vlerësimi nëse eprori e ka përmbushur detyrën e tij për të parandaluar ose ndëshkuar sipas nenit 7 (3) të Statutit duhet të bëhet rast pas rasti, ashtu që të marrë parasysh “rrethanat e çdo situatë të veçantë”. Sipas nenit 86 të Protokollit Shtesë I, eprorët e kanë për detyrë t’i marrin “të gjitha masat e realizueshme brenda fuqisë së tyre” për të parandaluar apo ndëshkuar shkeljen e ligjeve të luftës dhe sipas nenit 87 të Protokollit Shtesë, të tilla “masat e realizueshme” mund të marrin formën e të dy masave “disiplinore ose penale”. Mosndëshkimi i vartësve që kryejnë krime të luftës mund të jetë si pasojë e mos-hetimit të krimet e mundshme dhe/ose mos-raportimi i pretendimeve për krime lufte tek autoritetet më të larta.

Në Aktgjykimin *Krnojelac* Dhoma Gjyqësore theksoi se masat e kërkuara nga eprori kufizohen në ato që janë të realizueshme në të gjitha rrethanat dhe janë ‘brenda fuqisë së tij.’ Eprori nuk është i detyruar të bëjë të pamundurën. Megjithatë, eprori e ka për detyrë t’i ushtrojë kompetencat që ai ka brenda kufijve të këtyre kufizimeve.⁹²

(2.4) Deklarimi për përgjegjësinë eprore.

Gjykata e Apelit vëren se Prokuroria duhet ta deklarojë në aktakuzë mënyrën specifike të përgjegjësisë me të cilën ngarkohet i akuzuari, si dhe provat materiale, ku mbështetet ajo mënyrë e përgjegjësisë. Sipas neneve 17 (4), 20 (2), 20 (4) (a) dhe 20 (4) (b) të Statutit dhe Rregullës 47 (C) të Rregullores, prokurori duhet t’i deklarojë faktet materiale që i mbështesin akuzat në aktakuzë, por jo provat me të cilat provohen faktet e tilla. Aktakuza mbështetet me veçantinë e mjaftueshme vetëm nëse përcakton faktet materiale të rastit të Prokurorisë me detaje të mjaftueshme për ta informuar të pandehurin në mënyrë të qartë lidhur me akuzat kundër tij ose saj në mënyrë që ai ose ajo të mund të përgatisë mbrojtjen e tij ose të saj. Aktakuza e cila nuk

⁹⁰ TPNJ, *Prokurori kundër Tihomir Blaškić*, Aktgjykimi, 3 mars 2000, para. 335.

⁹¹ TPNJ, *Prokurori kundër Tihomir Blaškić*, Aktgjykimi, 3 mars 2000, para. 336.

⁹² TPNJ, *Prokurori kundër Milorad Krnojelac*, Aktgjykimi, 15 mars 2002, para. 95.

arrin t'i parashtrojë në mënyrë të rregullt faktet materiale që i mbështesin akuzat kundër të akuzuarit është e mangët.

Megjithatë, saherë që një i akuzuar akuzohet për përgjegjësi eprore mbi bazën e nenit 6 (3) të Statutit, faktet materiale të cilat duhet të deklarohen në Aktakuzë janë, (i) se i akuzuari është epror i vartësve mjaftueshëm të identifikuar mbi të cilët ai ka pasur kontroll efektiv – në sensin e aftësisë materiale për ta parandaluar ose ndëshkuar sjelljen kriminale – dhe për veprimet e të cilëve pretendohet se ai është përgjegjës; (ii) veprat penale të kryera nga të tjerët për të cilët pretendohet se i akuzuari është përgjegjës; (iii) sjellja e të akuzuarit sipas të cilës mund të konstatohet se ai ka ditur ose kishte arsye të dinte se krimet do të kryheshin ose ishin kryer nga vartësit e tij; dhe (iv) sjellja e të akuzuarit sipas të cilës mund të konstatohet se ai nuk ka marrë masat e nevojshme dhe të arsyeshme për të parandaluar veprimet e tilla ose t'i ndëshkojë personat të cilat i kanë kryer ato. Sa i përket elementit të fundit, do të jetë e mjaftueshme në shumë raste që të mbështetet se i akuzuari nuk ka marrë asnjë masë të nevojshme dhe të arsyeshme për të parandaluar ose ndëshkuar kryerjen e veprave penale. Aktakuza mund të jetë e mangët kur faktet materiale janë të pa specifikuar mjaftueshëm.⁹³

(3) N.K. (i akuzuar si komandant në Aktakuzë).

Në Pikën 1 të Aktakuzës kundër të akuzuarve **N.K.**, **F.L.** dhe **N.S.** pretendohet përgjegjësia eprore e të akuzuarve si *komandantë të UÇK-së dhe/ose pjesëtarë të UÇK-së që kanë mbajtur funksione të përgjegjësive në kuadër të qendrës së paraburgimit në Kleçkë*, në krimin e shkeljes së integritetit trupor dhe shëndetit një numër i papërcaktuar i civilëve serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurve ushtarakë serbë, të ndaluar në burgun në Kleçkë.

Gjykata e shkallës së parë vuri në dukje se nuk është vërtetuar se **N.K.** ka ushtruar përgjegjësi eprore. Provat nuk i mundësojnë trupit gjykues që të vijë në përfundim se është e sigurt se i pandehuri e dinte ose kishte arsye të dinte se individë të veçantë, të tillë si dëshmitari anonim H, vëllai i tij ose **Sh.A.** do t'i nënshtroheshin trajtimit mizor ose i ishin nënshtuar trajtimit mizor; dhe se **N.K.** nuk i kishte marrë masat e nevojshme dhe të arsyeshme për t'i parandaluar krimet apo për të dënuar kryerësit e tyre.

Gjykata e Apelit vëren se i akuzuari ka dhënë dëshmi se pseudonimi i tij ishte “**F.**”. Disa dëshmitarë e kanë konfirmuar se ai ishte pjesëtar i Brigadës 121 nën të akuzuarin **F.L.**

⁹³ TPNR, *Prokurori kundër Mikaeli Muhimana*, Aktgjykimi i Apelit, 21 maj 2007, paragrafët 76,167. 195; TPNR, *Prokurori kundër André Ntagerura dhe të tjerëve*, Aktgjykimi i Apelit, 7 korrik 2006, para. 27.

Dëshmitari C dëshmoi se ai ishte në mesin e tre ushtarëve të UÇK-së që e çuan atë me veturë në Tërpezë. I akuzuari ishte i pranishëm kur ai u rrah. Ai mori pjesë aktive në rrahjen e tij dhe më në fund e çoi atë në Kleçkë. Në çdo rast, Gjykata e Apelit thekson se **N.K.** nuk është e ngarkuar me ngjarjet në Tërpeza, megjithëse këto ngjarje janë marrë si prova të kontekstit dhe provojnë se i pandehuri në përgjithësi kishte gatishmërinë që të merrte pjesë në rrahjet e të burgosurve dhe që të kryente krime lufte.

Dëshmitari C tha se ai ishte i ndaluar me **A.A., S., I.** dhe një serb **M.** Ai dëshmoi se ai nuk e ka parë "**F.**" në Kleçkë. Gjykata e Apelit vëren se kur ai e ka dhënë deklaratën e tij në PSRK më 21 shtator 2010, atij asnjëherë nuk i ishin treguar fotot e "**F.**". Prandaj, procedura e identifikimit është e gabuar dhe e pamjaftueshme. Dëshmitari C gjithashtu deklaroi se pas luftës ai zbuloi se "**F.**" ishte **N.S. B.Z.** tha se ai e kishte parë "**F.**" në Kleçkë, por nuk ka dhënë detaje të tjera. **S.D.** gjithashtu e njohi "**F.**", si zyrtar të policisë ushtarake dhe e kishte parë atë në Kleçkë. Ai qe në gjendje të identifikonte atë.

Dëshmitari H e cek se "**B.**" kishte shtënë në të në kohën e kapjes së tij. Megjithatë, nga dëshmitari H nuk është kërkuar asnjëherë që ta identifikojë **N.K.** në tabelë. **U.K.** (ish- dëshmitari I) dëshmoi se "**B.F.**" i mori në ngarkim katër oficerët serbë që u sollën në Kleçkë në prill të vitit 1999 dhe se ai ishte një "oficer i policisë së zonës". Ai konfirmoi se "**B.F.**" ishte **N.K.** dhe e identifikoi atë. Dëshmitari bashkëpunues **A.Z.** konfirmon se dëshmitari C ishte i ndaluar në Kleçkë nga 20 marsi 1999 deri më 2 prill të vitit 1999 (shih po ashtu ditarin /012, faqe 1, 2). Ditari /012 faqja e fundit i **A.Z.** (5) përmendet dëshmitari H dhe vëllai i tij dhe data 28 shkurt 1999. **S.D.** e pranoi se ai e kishte parë dëshmitarin H dhe vëllain e tij duke iu nënshtruar trajtimit mizor, dhe dëshmoi se ai e kishte parë **Sh.A.** në Kleçkë, por nuk e di se çfarë kishte ndodhur me të.

S.D. nuk u pyet nëse ai e dinte se kush e kishte rrahur dëshmitarin H dhe vëllain e tij. Gjithashtu, në Gjykatë gjatë dëshmisë së tij të datës 23 prill 2013, sërish në lidhje me dy vëllezërit serbë, ai nuk ishte pyetur asnjëherë se kush i kishte kryer rrahjet/vrasje.

Gjykata e Apelit pajtohet me Gjykatën Themelore dhe konstaton se provat nuk tregojnë se i pandehuri ka ushtruar komandë mbi qendrën e paraburgimit dhe as nuk kishte post eprori. Kolegji i Apelit konstaton se ka një vërtetim të kufizuar që e përfshin të pandehurit në kryerjen e rrahjeve, sidomos të dëshmitarit H. Megjithatë, ka zbrazëtira në prova sa i përket identifikimit të **N.K.** Në përfundim, Gjykata e Apelit konstaton se, për shkak të mungesës së provave të besueshme të identifikimit, provat janë të pamjaftueshme për të vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se **N.K.** ka mbajtur një post të lartë në Kleçkë dhe se ai nuk ka vepruar.

(4) F.L. (i akuzuar si komandant në Aktakuzë)

Pika 1 e Aktakuzës kundër të akuzuarve **N.K.**, **F.L.** dhe **N.S.** pohon se **F.L.** akuzohet se ... si komandant i UÇK-së... dhe si person që ushtronte kontroll të përgjithshëm mbi qendrën e paraburgimit në Kleçkë në krimin e shkeljes së integritetit trupor dhe shëndetit të një numri të papërcaktuar të civilëve serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurve ushtarakë serbë, të ndaluar në burgun në Kleçkë duke i mbajtur ata në kushte çnjerëzore nga fillimi i vitit 1999 deri në mesin e qershorit 1999.

Sipas Pikës 2 të Aktakuzës, **F.L.** akuzohet se si komandant ka kryer krimin e torturës ndaj një të burgosuri ushtarak serb të ndaluar në qendrën e paraburgimit në Kleçkë.⁹⁴

Gjykata e shkallës së parë arriti në përfundimin se aktakuza nuk arriti të mbështesë dhe të paraqesë faktet materiale për ekzistencën e një marrëdhënie epror-vartës, apo se i akuzuari e dinte ose kishte arsye të dinte se vepra penale do të kryhej ose ishte kryer, ose ishte kryer, apo se i akuzuari nuk mori masat e nevojshme dhe të arsyeshme për të parandaluar veprën penale apo për të dënuar kryerësit.

Gjykata e Apelit konstaton se është provuar se në vitin 1998, i akuzuari ishte komandant i Brigadës 121. Në nëntor të vitit 1998, **F.L.** ishte emëruar anëtar i Shtabit të Përgjithshëm dhe **H.S.** mori komandën mbi Brigadën 121. Në këtë post të ri ai ishte epror me një marrëdhënie të qartë epror-vartës.

F.L. dëshmoi se ai ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm deri rreth 30 marsit dhe më pas ishte emëruar Zëvendësministër i Mbrojtjes. **A.K.** dha dëshmi, kur u pyet, se **F.L.** ishte anëtar i zinxhirit komandues të Shtabit të UÇK-së. **N.K.** dëshmoi se **L.** ka qenë drejtor i Policisë Ushtarake të SH të UÇK-së deri në fund të marsit dhe pastaj shkoi në Shqipëri që të bëhej ministër. **N.S.** dëshmoi se **F.L.** ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm në Novosellë. Dëshmitari **B.Z.** ka dëshmuar se nga janari deri në prill të vitit 1999 **F.L.** ishte shefi i gjithë policisë ushtarake të UÇK-së, dhe se **N.** ishte pjesëtar i Brigadës 121 nën komandën e drejtpërdrejtë të drejtorisë së policisë ushtarake të udhëhequr nga **F.L.** **S.D.** ka dëshmuar në një deklaratë të parë se **L.** ishte i vetmi që kishte fuqi të tillë pasi që ai ishte shefi i policisë ushtarake. Megjithatë, ai e ndryshoi deklaratën e tij dhe deklaroi se ai e nuk kishte fuqi të tillë. Dëshmitari M vuri në dukje se kampi ishte nën përgjegjësinë e **L.** dhe se njësitë ishin nën kontrollin e tij. **U.K.** ka thënë se **L.** kishte një pozitë më të lartë dhe kishte parë **L.** në Kleçkë në vitin 1999, posaçërisht kur ishin sjellë aty katër oficerët serbë, por ai nuk e dinte nëse **L.** ishte marrë me ta. Dëshmitari **N.M.** dha dëshmi se **L.** ishte emëruar si shefi i të gjithë policisë ushtarake të UÇK-së.

⁹⁴ PSRK, Aktakuza, f. 9.

Kolegji i Apelit thekson se rrahjet janë kryer nga pjesëtarët e policisë ushtarake. **B.Z.** dëshmoi se komandant në Kleçkë ka qenë **H.S.** i Brigadës 121 [e cila është njësi e policisë ushtarake]. **S.D.** dëshmoi se të burgosurit ishin nën kontrollin fizik të policisë ushtarake. Dëshmitari M dëshmoi se kampi ishte nën përgjegjësinë e **L. U.K.** vuri në dukje se policia ushtarake qëndronte në katin më të lartë. **B.Z.** dëshmoi se komandant në Kleçkë ishte **H.S.** i Brigadës 121 (Policia Ushtarake).

Për më tepër, gjykata e shkallës së parë e ka elaboruar mirë dhe provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se rrahjet kanë ndodhur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, dhe Gjykata e Apelit pajtohet plotësisht me gjetjet e saj. Dëshmitari D dha dëshmi se i burgosuri i njohur si “Shero” i ishte nënshtruar një rrahje para të burgosurve të tjerë. Ai u mor lart dhe dëshmitari D më pas mund ta dëgjonte atë duke bërtitur. Dëshmitari V dha dëshmi në lidhje me trajtimin e tij gjersa ishte i ndaluar në Kleçkë. Ai tha se gjatë asaj periudhe **M.S.** e kishte kërcënuar se do ta vriste atë. Ai dëshmoi: “Ai më tërhoqi jashtë qelisë me thes mbi kokën time dhe më kërcënoi me jetë. Kur isha në burg, **M.Sh.**, së bashku me kushëririn e tij dhe tre persona të tjerë erdhën tri herë në qelinë time. Në një rast ata më kërcënuan mua dhe në një rast tjetër ata më goditën me shqelma “Në të njëjtën deklaratë ai tha: *Personalisht, unë asnjëherë nuk jam keqtrajtuar fizikisht në Kleçkë. I kam marrë vetëm dy goditje me gju në barkun tim.*

Dëshmitari V ka përshkruar se ka parë shenja në duart dhe supet e **B.K.**, por tha se **B.K.** ka deklaruar se ai e kishte lënduar veten. Ai dha dëshmi në lidhje me një djalë të ri 17 vjeç, nga fshati Obri me të cilin ai kishte qenë i ndaluar për dy ditë. Ushtarët e UÇK-së, duke përfshirë **B.H.**, e kishin rrahur atë mashkullin e ri. Dëshmitari anonim M dëshmoi se gjatë ndalimit të tij një person me maskë e kishte goditur atë me një shkop në shpinë dy herë. Ai i kishte dëgjuar të burgosurit duke bërtitur kur ata merreshin në pyetje në katin e parë. Ai tha se kur të burgosurit ktheheshin në qeli, ai mund të shihte se ata ishin rrahur. Dëshmitari anonim L dëshmoi se gjatë burgimit të tij në Kleçkë, ai e kishte parë një ushtar të UÇK-së të burgosur në qelinë e tij, të cilin ai tha se e kishin rrahur keq. **N.R.** ishte arrestuar në tetor të vitit 1998. Ai tha se dy të burgosur serbë ishin të ndaluar në dhomën afër dhomës së tij. Ai e përshkroi se si ai kishte dëgjuar britmat gjatë kohës kur ata rriheshin.

Kolegji i Ankesave nuk është e bindur se është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se **F.L.**, pavarësisht postit të tij të lartë si drejtor i policisë ushtarake në shtab dhe komandant i përgjithshëm i policisë ushtarake, e kishte aftësinë materiale për të vepruar ose që ai e dinte ose kishte arsye të dinte se vartësit e tij kishin kryer krime, dhe se ai nuk i kishte parandaluar ato krime apo nuk i kishte ndëshkuar autorët e krimit. Analiza e kujdesshme të gjitha provave nuk mund të çojë Kolegjin e Apelit të vërtetojë se **F.L.** madje kishte disa informata të përgjithshme në posedim të vet, që do të vinin atë në dijeni për akteve e mundshme të paligjshme nga vartësit

e tij, gjë që nga ana tjetër do të ishin e mjaftueshme për të provuar se ai “kishte arsye të dinte.” Ndonëse ai ishte parë në Kleçkë mjaft shpesh, nuk ka prova se ai kishte informacion të përgjithshëm në lidhje me keqtrajtimin e të burgosurve kur ai ishte në komandë, si dhe numri dhe datat e rrahjeve mbeten të papërcaktuara. Kolegji i Apelit vjen në përfundim se nuk ka rrethana të mjaftueshme për të vërtetuar se **F.L.** ka pasur arsye të forta për të ditur.

(5) N.S. (i akuzuar si komandant në Aktakuzë).

Pika 1 e aktakuzës pretendon për përgjegjësi eprore të të akuzuarit **N.S.** si komandant i UÇK-së dhe/ose pjesëtarë i UÇK-së që mbante funksionin e përgjegjesisë në kuadër të qendrës së paraburgimit në Kleçkë, në krimin e dhunimit të integritetit trupor dhe shëndetit të një numri të papërcaktuar të civilëve serbë dhe shqiptarë dhe ushtarakëve serbë, të ndaluar në qendrën e paraburgimit në Kleçkë duke i mbajtur ata në kushte çnjerëzore.

Gjykata e shkallës së parë ka gjetur se aktakuza për pikat 1 nuk arrin të mbështesë dhe të paraqesë faktet materiale për ekzistencën e marrëdhënies epror-vartës, dhe se i akuzuari e dinte ose kishte arsye të dinte se vepra penale do të kryhej, ose ishte kryer, dhe se i akuzuari nuk mori masat e nevojshme dhe të arsyeshme për të parandaluar veprën penale apo për të ndëshkuar kryerësin e tyre. Trupi gjykues i është referuar jurisprudencës ekzistuese duke marrë parasysh se kur i akuzuari është ngarkuar me të dy përgjegjësitë, përgjegjësinë e lartë penale dhe pjesëmarrjen aktive (përgjegjësinë personale), Aktakuza duhet t’i ndajë këto akte në mënyrë të qartë sepse faktet e njëjtat nuk mund t’i shkaktojnë në njëjtën kohë dy lloje të përgjegjesisë.⁹⁵

Gjykata Supreme e Kosovës në aktvendimin e saj të datës 20 nëntor 2012 nuk nxori asnjë përcaktim mbi këtë çështje, por në vend të kësaj vendosi ta ... *lë çështjen e hapur ose jo, Aktakuza veçanërisht i ka akuzuar të pandehurit ... për kryerjen e Krimeve të Luftës nën përgjegjësinë komanduese.*⁹⁶ Nga ana e saj, Prokuroria pohoi referencën të pandehurve të caktuar që mbajnë funksionet e autoritetit ishte thjesht për të nxjerrë në pah rolin e tyre përkatës, gjë që duhet të konsiderohet nga gjykata si një faktor rëndues kur caktohet ndonjë dënim.

Gjykata e Apelit vëren se kjo nuk mund të provohet përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri **N.S.** kishte një pozitë të lartë. **S.D.** ka dhënë dëshmi se ai e dinte pseudonimin “**F.**”, por jo emrin e tij të vërtetë. Ai shpesh e kishte parë atë në Kleçkë. Edhe **U.K.** e kishte parë atë në Kleçkë. Ai dëshmoi se në prill të vitit 1999 “**F.**” i mori përsipër katër oficerët serbë të sjellë në Kleçkë.

⁹⁵ TPNR, *Prokurori kundër Joseph Kanyabashi*, Vendimi i Dhomës së Gjykimit mbi propozimin paraprak të mbrojtjes për mangësitë në formën e Aktakuzës, 31 maj 2000, paragrafët 5.8-5.11.

⁹⁶ Gjykata Supreme e Kosovës, Aktvendimi, 20 nëntor 2012, f. 33.

Megjithatë, nuk ka dëshmi që do të mund të sillte prova se i pandehuri kishte një pozicion që ishte përtej ose mbi atë të një ushtari të thjeshtë. Kështu që, Kolegji erdhi në përfundim se i pandehuri nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi eprore.

F. KONKLUZION.

Gjykata e Apelit e vë në dukje këtë konkluzion si më poshtë: nga provat e paraqitura dhe të vlerësuara në mënyrë të tërësishme, pas asnjë dyshim të arsyeshëm është vërtetuar se krimet e luftës kanë ndodhur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë. Në veçanti janë kryer *Krime lufte kundër popullatës civile*, të ndëshkueshme sipas neneve 22, 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, aktualisht të ndëshkueshme sipas neneve 31, 152 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në kundërshtim me nenin e Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe neneve 4, 5 (1) të Protokollit Shtesë II dhe *Krime lufte kundër të burgosurve të luftës*, sipas neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, aktualisht të ndëshkueshme sipas neneve 31, 152 të KPRK-së, në kundërshtim me nenin e Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe neneve 4, 5 (1) të Protokollit Shtesë II. Megjithëse kushtet e qendrës së paraburgimit në Kleçkë *per se* nuk kishin arritur deri te trajtimi mizor, Kolegji vëren se veçanërisht rrahjet e të burgosurve kishin arritur përmasë shqetësuese, gjë që po ashtu mund të konsiderohet si sistematike në lidhje me të burgosur të caktuar.

Gjykata e Apelit thekson qartë se, të ngjashme me gjetjet e gjykatës së shkallës së parë, dëshmitari bashkëpunues **A.Z.** nuk ishte dëshmitar plotësisht i besueshëm dhe që meritonte besim, deklaratat dhe dëshmia e tij nuk mund të jetë baza e vetme për dënimin e cilitdo prej të pandehurve. Kundërthëniet, zbrazësitë në kujtesë, shumë versione të ndryshme të së njëjtës ngjarje apo ngjarjeve - këta faktorë vërtetojnë se **A.Z.** nuk mund të konsiderohet si burim i besueshëm provash. Edhe nëse në disa pika mund të konsiderohet se ai e ka thënë të vërtetën, faktorët e mësipërm të arsyetuar nga Kolegji Apelit e rrënojnë kredibilitetin e tij. Kolegji dëshiron të vë fuqimisht në dukje se provat e paraqitura nuk ka qenë mjaft të forta që të pandehurit të dënohen dhe për këtë arsye vendimi duhet të jetë në favor të të pandehurve, sipas parimit të përgjithshëm juridik *in dubio pro reo*. Vendimi është në përputhje me jurisprudencën ndërkombëtare, kur të pandehurit lirohen nga akuzat për shkak të mungesës së provave.⁹⁷

⁹⁷ TPNJ, *Prokurori kundër Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Aktgjykimi, 29 nëntor 2012; TPNJ, *Prokurori kundër Ljube Boškosi dhe Johan Tarčulovski*, Aktgjykimi i Apelit, 19 maj 2010; TPNJ, *Prokurori kundër Ante Gotovina dhe të tjerëve*, Aktgjykimi, 15 prill 2011; TPNR, *Prokurori kundër Ignace Bagilishema*, Aktgjykimi i Apelit, 3 korrik 2002; TPNR, *Prokurori kundër Protais Zigiranyirazo*, Aktgjykimi i Apelit, 16 nëntor 2009.

Në përmbyllje, Kolegji e gjen ankesën e Prokurorit Special si të pranueshme, por e refuzon atë si të pabazuar, e vërteton Aktgjykimin e Kundërshtuar për lirimin nga akuzat e të gjithë (dhjetë) të pandehurve. Andaj, u vendos si në dispozitiv.

Aktgjykimi i arsyetuar me shkrim i përfunduar më 29 prill 2016.

Gjyqtar kryesues

Piotr Bojarczuk
Gjyqtar i EULEX-it

Anëtar i Kolegjit

Roman Raab
Gjyqtar i EULEX-it

Anëtar i Kolegjit

Vahid Halili
Gjyqtar i Gjykatë së Apelit të Kosovës

Procesmbajtës

Dr. Bernd Franke
Zyrtar ligjor i EULEX-it

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR 266/14
26.01.2016